



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 8 SHKURT 2019**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 8. FEBRUARA 2019. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2019**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës

Dnevni red

1. Parlamentarna debata o slučaju seksualnog uznemiravanja i silovanja, nezakonitog abortusa maloletnice i institucionalnoj odgovornosti Vlade Kosova

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër i Arsimit,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të 40 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në sallë aktualisht janë 46 deputetë.

Procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimin seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës

Të nderuar deputetë,

40 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimin seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës.

Në emër të propozuesit, zonja Fatmire Kollçaku, deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Urdhëroni zonja Kollçaku!

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Ndoshta sot dikush edhe mund të thotë: pse jeni ngutur ta ftoni seancën përderisa rasti është nën hetime dhe ta presim fjalën e drejtësisë.

Po pikërisht se aty dështoi, pikërisht se rasti në fjalë dështoi mu në hallkën më të ndjeshme, aty ku është dashur të iniciohet procesi i hetuesisë dhe pastaj u mbyll nga prokuroria dhe gjyqësori, duhet ta rikthejmë këtë çështje këtu në Kuvend të Republikës së Kosovës dhe të flasim ne të zgjedhurit e popullit.

Pra, unë fillimisht kërkoj të pajtohem për një gjë së bashku të gjithë që rasti në fjalë, të cilit i referohemi, në fakt, ngjarja të cilës i referohemi ka të bëjë me një fëmijë dhe për këtë kërkoj konsensus, sepse rasti në fjalë, kur ka filluar, apo të mos them skllavërimi i të miturës kur ka filluar ajo ka qenë vetëm 16-vjeçare, në fakt, po sa kishte filluar ta vijojë klasën e 10-të të shkollës së mesme.

Prandaj, nëse ne nuk e arrijmë pajtueshmërinë si shoqëri që bëhet fjalë për fëmijë me të vërtetë, atëherë edhe ky debat do ta humbte kuptimin, edhe pse abuzimi dhe keqpërdorimi seksual i kujtdo qoftë nënkupton krim, mirëpo krimi është më i rëndë kur bëhet fjalë për fëmijë.

Çka ka ndodhur këtu, shkelja e Konventës për abuzim dhe keqpërdorim seksual, shkelja e nenit 18 kur abuzuesit janë ata që kanë një pozicion të njohur që gëzon besim, autoritet dhe ndikim mbi fëmijët, duke përfshirë këtu edhe marrëdhënien brenda vetë familjes.

Pra, abuzuesit ishin pikërisht ata të cilët do të duhet të ishin autoritet, tek të cilët fëmija duhet të kishte besim dhe abuzimi filloi aty ku më së pakti pritej, në shkollë.

Abuzimi filloi në shkollë dhe vazhdoi, në momentin kur e mitura mori guximin dhe e denoncoi rastin aty ku diti, shkoi e u drejtua në polici, pra pikërisht aty ku duhej të ishte besimi më i madh i vajzës, ajo hasi në, vërtet krimi u përsërit, një institucion jo që ta mbulojë krimin e institucionit tjetër, por tani më u involvua në krim dhe vazhdoi abuzimi dhe keqpërdorimi seksual mbi të miturën.

Po, kur ndodhi abuzimi i tretë apo, të themi ndërprerja e shtatzënësisë, vajza tashmë ndoshta edhe nuk ishte e mitur, sepse në bazë të dhënave që i kemi, gjithnjë nga mediat, ajo ndoshta edhe më nuk është e mitur, sepse ndoshta kishte mbushur moshën 18-vjeçare, por bazuar në të dhënat nga Inspektorati shëndetësor ndërprerja e shtatzënësisë është kryer në një institucion privat, i cili nuk disponon licencë, ku nuk kishte kushte për të kryerjen e abortit, sepse në një institucion për të kryer ndërprerja e shtatzënësisë ai duhet t'i ketë të gjitha kushtet që t'i trajtojë të njëjtën kohë, të ofrojë shërbim edhe të trajtimit të komplikime të mundshme të abortit që, mes tjerash nënkupton edhe nevojën për gjak dhe shumë mundësi të tjera.

Prandaj, këtu kemi shkelje në të tri nivelet.

Pra, ne jemi detyruar që sot ta ftojme këtë seancë, të shqetësuar, sepse nuk kishim edhe përgjigje adekuate institucionale.

Të tre ministrat që janë përgjegjës, po mendoj që vartësit e tyre janë përfshirë këtu, është dashur një urgjencë të ftohet mbledhja e Qeverisë dhe të dalin me qëndrime rreth ngjarjes, të mos harrojmë, ky nuk është rast i izoluar.

Këtu bëhet fjalë vetëm për një vajzë, e cila mori guximin dhe përkundër një fenomeni që deri tani nuk është regjistruar në Kosovë, fenomeni i skllavërisë në aspektin e shfrytëzimit seksual, sepse këtu kemi një kohëzgjatje dyvjeçare të abuzimit me një të mitur dhe ky është një fenomen që për herë të parë po ndodh në Kosovë dhe po denoncohet.

Prandaj, duhet shtruar pyetja: a jemi të gjithë të barabartë para ligjit, a ka barazi para ligjit? Ju e dini fare mirë që kur u denoncuar rastet për disa fëmijë të pushtetarëve për posedim armësh, për posedim drogash, ndodhi që zyrtari i cili në një farë forme plasoi informatën u suspendua, jo për këtë shkak, por u gjend arsyeja pse ai u suspendua!

Pra, fëmijët e pushtetarëve sot janë të mbrojtur, po këtu bëhet fjalë pikërisht për një vajzë që vjen nga një familje e varfër, e pambrojtur, e papërkrahje, të cilës me siguri nuk i janë ofruar të gjitha mundësitë, qoftë edhe në shkollë që të njoftohet me krejt atë çfarë mund ta pretë në jetë, e në veçanti t'i ndodhë ajo çfarë i ka ndodhur aty ku më së paku pritet fillimisht në shkollë.

Pra, u shkel Konventa kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual.

Ne të gjithë këtu sot duhet të shikojmë cila është detyra jonë si ligjvënës. Ne nuk jemi prokurorë, nuk jemi hetues, nuk jemi gjyqtarë, po ne kemi obligim që të ndërhyjmë në legjislacion, fillimisht të zbatohen, edhe Kushtetuta, e cila në frymën e vet i ka përqaftuar të gjitha këto konventa, Konventën për të drejtat e njeriut, Konventën për të drejtat e fëmijëve.

Pra, ne sot e kemi theksin, sepse akti është aq i rëndë pikërisht pse bëhet fjalë për fëmijë.

Dhe konventa pikërisht përcakton një sërë masash që palët, që çdo shtet që do t'i përqafojë këto parime, duhet t'i ndërmarrin për t'i përmbushur qëllimet e vendosura në të.

Në radhë të parë duhet të merren masa e domosdoshme ligjore apo të llojit për të parandaluar të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe abuzimi seksual të fëmijëve dhe për të mbrojtur fëmijët. Secila palë duhet të merr masa të domosdoshme legjislative dhe masa të tjera për të inkurajuar rritjen e njohurive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve midis personave që kanë kontakte të rregullta me fëmijët në arsim, në shëndetësi, mbrojtje sociale, në sektorin gjyqësor dhe zbatimit të ligjit dhe në fusha që lidhen me sportin, kulturën dhe pikat e argëtimit.

Masa të tjera parandaluese, përfshirë informimin e fëmijëve gjatë arsimit fillor dhe të mesëm për rreziqet e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, si dhe për mjete për të mbrojtur vetveten.

Kryerjen e fushatave informuese dhe sensibilizuese drejtuar publikut, përfshirjen e fëmijëve në përputhje me kapacitetin e tyre zhvillimor në zhvillimin dhe implementimin e politikave, programeve dhe iniciativave të tjera shtetërore në lidhje me luftën kundër shfrytëzimit seksual ose abuzimit seksual të fëmijëve. Nxitjen e mediave të japin informacionin e duhur në lidhje me të gjitha aspektet e abuzimi seksual të fëmijëve, e të tjera.

Në bazë të konventës, secila palë duhet të krijoj programe efektive sociale dhe të ngrejë struktura shumë disiplinore për të dhënë mbështetjen e domosdoshme për viktimat. Të afërmit e tyre dhe për ndonjë person që përgjigjet për përkujdesjen e tyre.

Të gjitha shtetet duhet të marrin masat e domosdoshme legislative ose masa të tjera për të asistuar viktimat për një afat të shkurtër dhe të gjatë për shërimin e tyre fizik dhe psiko-social. Duke marrë parasysh pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet të fëmijët.

Nga ana tjetër, konventa parashikon edhe programe dhe masa të veçanta të ndërhyrjes që duhet të ndërmerren me persona, të cilët procedojnë penalisht apo janë dënuar për kryerjen e veprave penale që lidhen me shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve me qëllim parandalimi dhe minimizimin e rrezikut të përsëritjes së veprave të tilla në të ardhmen.

Pjesë e detyrimeve të marra përsipër nga shtetet që kanë treguar vullnet për këtë konventë janë edhe ato që për marrjen e masave legislative për kriminalizimin e formave të abuzimit seksual me fëmijët, parashikimit me Ligjin penal, material të veprave penale që lidhen me prostitucionin e fëmijëve, veprave penale që lidhen me ponografin e fëmijëve, veprave penale që lidhen me tundimin e fëmijëve për qëllime seksuale, parashikimin si vepra penale të tentativës, ndihmës apo shtytjes për të kryer ndonjëherë nga veprat e mësipërme penale.

Konventa në fjalë përcakton edhe masat e nevojshme që duhet të merren nga shtetet, masa legislative në legjislacionin procedural penal apo masa të tjera për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale që lidhen me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve.

Kjo konventë parashikon një mekanizëm të posaçëm që do të merret me monitorimin e zbatimit të konventës në fjalë.

Pra, edhe ne si Kosovë kemi miratuar shumë ligje këtu, edhe ne si Kuvend i Kosovës, si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës na mbetet fillimisht t'i monitorojmë ligjet të cilat zbatuar këtu.

Sa për rezoluta, ne sot mund ta procedojmë një dokument këtu, për të cilin edhe ndoshta edhe do të pajtohemi, por a jemi marrë si Kuvend ndonjëherë me zbatimin e rezolutave të miratuar deri tani, a e kemi thirrur një seancë dhe të shikojmë çfarë është zbatuar, qoftë edhe një rekomandim nga këto rezoluta.

Prandaj, nëse ne të gjithë nuk jemi të vullnetshëm siç e thashë që të luftojmë fillimisht për të drejtat e fëmijëve, që në këtë rast shkelje flagrante të drejtave të fëmijëve.

Dhe nën dy, që të pajtohemi të tentojmë që të gjithë qytetarët të luftojnë, të angazhohemi për barazi para ligjit, të mos bëjmë përjashtime për fëmijët e pushtetarëve, duke lënë anash ata fëmijë që nuk kanë fat që të kenë dikë sot në pozicion vendimmarrës, aty ku një zyrtar, siç është ky polici në fjalë apo rreshteri do të frikësohej që kur do t'i ishte drejtuar kjo vajza dhe do të rrëfehej aty, do të frikësohej ta bënte, të kryente veprën e abuzimit dhe keqpërdorimit seksual, sepse do të kishte frikë që kjo vajzë do ta denoncojë diku tjetër.

Po, duke e parë që kjo vajzë nuk ka mbështetje, nuk e ka krahun e fortë, siç e themi ne, atëherë abuzimi ka vazhduar, ka filluar në shkollë, ka vazhduar në polici dhe ka përfunduar, fatkeqësisht ne të gjithë duhet të angazhohemi bazuar në këtë konventë, bazuar në krejt atë frymën e Kushtetutës të cilën e kemi dhe nuk po e respektojmë, t'ia sigurojmë çdo viktime ndihmën e duhur, duke fillua nga psikologë dhe pedagogë, duke i fuqizuar punëtorët socialë, të cilët padrejtësisht i kemi diskriminuar me pagat, duke e fuqizuar Inspektoratin shëndetësor, të cilin padrejtësisht e kemi diskriminuar me paga dhe me status, duke i fuqizuar të gjithë mekanizmat monitorues dhe duke ia kthyer shkollës dinjitetin dhe duke i ftuar gjithë profesorët, që fillimisht të jenë pedagogë dhe pasta ligjërues të lëndëve të cilat i kanë dhe duke e inkurajuar çdo viktimitë aktuale që të dalë publikisht, sepse stigma duhet luftohet fillimisht këtu, fillimisht nga ne dhe atëherë ne do të inkurajomë të gjitha ato vajza, të cilat sot ndodhen në të njëjtën situatë, po nuk kanë guxim të dalin publikisht, sepse siç e dini, pas një kohe zhvendosja e fajit kalon te viktima dhe kjo tendencë ka filluar, duke thënë jo tani ajo e ka moshën etj.

Prandaj, të adresojmë fajin dhe në fund të dalim me rekomandime, rekomandimet tona janë të përfshirë në këtë konventë.

Besoj që së bashku me propozuesin tjetër dhe gjithë juve, të cilët pres që do të bashkohemi në rekomandime dhe t'i hartojmë së bashku, që pastaj të jemi të fuqishëm në mbrojtje të atyre rekomandimeve si dhe përfshirjen në legjislacion të krejt kësaj çfarë u fol. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lirije Kajtazi. Mirë është në emër të grupeve të më tregoni nga pak, që ta di.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Si bashkiniciues të kësaj seanca dëshirojmë të themi se rasti në fjalë ka qenë si shkak për të trajtuar funksionimin e shtetit ligjor në Kosovë si dhe një sinjal alarmi se këtu ka dështuar një sistem i tillë, për të cilin duhet të gjithë së bashku, pa dallime partiake, që t'i adresojmë problemet për të mos u përsëritur më.

Në një shoqëri demokratike është kryesore respektimi i të drejtave të njeriut, kjo është esenca e shkëputjes nga sistemet totalitare, shtypëse e diskriminuese, në të cilat veç pretendimi për të qenë i lirë njerëzve u ka kushtuar shtrenjtë me heqje lirie, mohim arsimimi, punësimi e deri edhe me jetën.

E Kosova jonë që i përjetoi të gjitha këto diskriminime, për 11 vjet shet nuk i garanton ende të gjitha këto mundësi.

Rasti i ky për të cilin po debatojmë sot, pak na flet se jemi larguar nga mentaliteti totalitar dhe diskriminues.

Me vetë faktin se ky rast është një dështim zinxhiror institucional, është shumë shqetësuese dhe nxjerrë në pah të metat e funksionimit të sistemit shtetëror e demokratik në vend.

Kjo liri e privuar është evidente edhe në raportet monitoruese të brendshme e të jashtme dhe pak ditë më parë doli edhe raporti i “Freedom house”, ku Kosovën e cilëson si një vend gjysmë të lirë.

Në Kosovë për të drejtat e njeriut është folur kryesisht kur ka pasur shkelje, raste skandaloze, më rëndë ato të përfunduara me fatalitet, por pak është kultivuar si formë e sjelljes.

Disa herë kemi ngritur çështje, të cilat kryesisht janë adresuar në ngacmimet që u bëhen grave dhe motrave tona dhe asnjëherë nuk janë marrë përfundime, të cilat do ta siguronin një garanci dhe një siguri më të mirë për to.

Përkundrazi të gjitha statistikat flasin për një dhunë në rritje, edhe gjatë monitorimit të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje është parë se në krejt këtë hallkë të institucioneve të sigurisë kemi shkëputje dhe adresim jo të mjaftueshëm të kësaj çështjeje.

Ne kemi një Kushtetutë që i mbron të drejtat dhe liritë themelore, arsimimin, familjen, dinjitetin, integritetin personal, barazinë para ligjit, garancinë për punë, për profesion, mbrojtje shëndetësore dhe shumë çështje të tjera, duke shtuar kësaj edhe shumë instrumente dhe marrëveshje ndërkombëtare, të cilat shumë më gjerësisht i përmendi edhe zonja Kollçaku. Të gjitha këto do të ishin një obligim më i madh për ne, kështu flet Kushtetuta, po çfarë flet realiteti.

Janë themeluar shumë e shumë mekanizma qendrorë, lokalë, qeveritarë, joqeveritarë, humanë, johumanë dhe të gjitha thuajse flasin njësoj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës shqyrton raportet të institucioneve të pavarura e të ministrive, por jo mjaftueshëm ndalet në çështje që identifikojnë dhe i adresojnë ato raporte, pa i përkthyer ato në detyra dhe në obligime ligjore.

Raporti i Avokatit të Popullit, i cili flet se një qytet për të realizuar një të drejtë në gjykata tona duhet të presë deri në 15 vjet, ju lutem, të nderuar, 15 vjet është një jetë e terë për njerëzit dhe mesatarisht me një kryerje të këtyre lëndëve në 8.5 vjet.

Ky Kuvend shqyrton e miraton edhe raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga aspekti teknik e jo përmbajtjesor pa parë se çka rrëfen dhe çka adreson në esencë ai.

Gjithashtu ky Kuvend shqyrton raportin e Këshillit të Pavarur të Mediave pa parë se çka rrëfen dhe çka në fakt prezantojnë mediat tona para fëmijëve dhe qytetarëve tanë, e shumë e shumë raportime të agjencive të ndryshme të pavarura dhe të varura.

Ky Kuvend i lejon institucionet e pavarura që të bëhen vegël e politikës, e të mos flasim për Qeverinë, e cila është e mbushur me sekserë dhe pazarxhinj politikë, e drejtësia përplot me padrejtësi.

Kanë mbytur kurajën qytetare për të raportuar atë në institucione që janë të thirrura për ta mbrojtur atë.

Po i referohem një studimi të nxjerrë nga Qendra për Studime Gjinore për ngacmimin seksual në vendin e punës dhe e keni parasysh që në vendet e punës të punësuarit janë të moshës madhore mbi 18 vjet dhe nëse në këto vende janë këto statistika, çka atëherë abuzimet me kategori të mitura dhe fëmijët, të cilët ndoshta nuk e kanë edhe vetëdijen e mjaftueshme të raportimit dhe të mbrojtjes edhe bien pre frikësimit edhe më shumë.

Natyrisht aty, siç thashë, janë moshat madhore dhe 35,6% e tyre mendojnë se dukuria e ngacmimit seksual është e pranishme në institucionet publike dhe pyetja tjetër, se a më shumë ndihni siguri në institucione publike apo private, ka 80% të deklarohen se prapë në institucione publike është një siguri më e shprehur, ndërsa në private është diskriminimi edhe më i theksuar, çka do të thotë, ne shumë pak e aspak kemi monitoruar edhe sektorin privat në këtë rast, i cili flet edhe për çështje edhe më alarmante që ndoshta shumica edhe i trajtojnë punëtorin edhe si skllav të tyre.

Prej tyre vetëm 12,8% deklarojnë se do t'u drejtoheshin institucioneve të ankesave dhe vetëm 8,5% policisë, kjo fletë për pabesueshmëri të qytetarëve në institucione.

40.6% nuk e lajmërojnë fare, edhe kjo është sinjal i pasigurisë, e pasigurinë e shkakton edhe papunësia, edhe varfëria, të cilin e kemi lënë këtë popull.

E pasiguri në punë shkaktojnë edhe pagat e ulëta, të cilat shpërfaqin pabarazi edhe siç e bëmë ne në Ligjin për pagat, të cilin besoj se i nxjerr në pah gjithë këto pabarazi që i përmendëm.

Nga shqyrtimi i ankesave të nëpunësve civilë në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës shihet se nëpunësit civilë nuk rekrutohen gjithnjë sipas procedurave ligjore dhe avancimi nuk bëhet gjithëherë sipas meritave dhe procedurave.

Njësoj ndodh edhe me vlerësimin e performansës, i cili nuk është aspak meritator.

Këto janë të gjeturat që flasin për një situatë, e cila na reflekton burimin e rasteve si ky i sotmi që po debatojmë.

Nuk po ndalemi si Lidhje Demokratike e Kosovës në këtë rast, e thashë që në fillim, po ndalimi në shumë raste të cilat nuk kanë ardhur në veshin tonë, në shumë raste të cilat janë mbytur edhe në këtë zinxhirin e papërgjegjësisë institucionale.

Të nderuar deputetë,

Të drejtat e njeriut përcaktojnë ligje e rregulla që garantojnë siguri, ato përcaktojnë norma që çdo njeriu të sigurohet një standard normal i jetës.

Është gabuar rëndë në shumë sisteme, është gabuar rëndë në sistemin arsimor kur i kemi parë të panevojshëm pedagogët në shkolla, është e pafalshme edhe mungesa e psikologëve, të cilët do të adresonin këtë problem në institucionin ku edhe po ndodhin këto abuzime.

Po ashtu, edhe Policia e Kosovës me shumë çështje të tjera, të cilat i ka heshtur edhe ose i ka mbytur që në ankesë.

Shfaqja e këtyre ngjarjeve në shoqërinë kosovare flet për të metat institucionale. Prandaj, kësaj here, të nderuar, ne nuk dëshirojmë që vetëm dy partitë iniciuese të merren me këtë, por besoj prej përfaqësuesit të secilit subjekt do të nxjerrim rekomandimet e përbashkëta, në mënyrë që të kërkojmë përgjegjësi.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar për fjalën e dhënë!

Ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar të këtij vendi,

Ne pas vendimit për të mbajtur një seancë të jashtëzakonshme, që është shumë e ndjeshme dhe shumë e prekshme, për ngjarjen që ka ndodhur, kishim një takim në grupin parlamentar dhe unë mendoja që në emër të grupit duhej të fliste dikush nga gratë tona, mirëpo doajenja e këtij Parlamenti, humanistja dhe atdhetarja e shquar, doktoresha Flora Brovina më tha që ju burrat tash duhet të dilni dhe të mbronni të drejtat e vajzave dhe të grave. Për këtë arsye dhe e mora fjalën që të flas në emër të grupit parlamentar.

Pa diskutim që është një ngjarje shumë e rëndë dhe është një situatë edhe më e rëndë, patjetër që duhet të shprehim indignatën tonë të thellë për ngjarjen që lidhet me rastin e abuzimit seksual ndaj një nxënëseje të mitur në Drenas. Ngjarje fatkeqe që vërtet ka shkaktuar hidhërim dhe tronditje të madhe në opinionin e gjithmbarshëm të vendit tonë. Me këtë rast, patjetër që duhet të shprehim keqardhje të thellë për vajzën dhe familjen e saj, për të gjitha ato dhimbje, vuajtje, shpërdorim, mashtrim, kërcënim, keqpërdorim nëpër të cilat ka kaluar e mitura dhe familja e saj. Në çdo rast është e papranueshme dhe e dënoshme ashpër, me ashpërsinë më të madhe këtë akt të shëmtuar kriminal.

Patjetër që duhet të kërkojmë dhe duhet t'u bëjmë thirrje të gjitha autoriteteve përgjegjëse, ligjzbatuese që të ndër marrin të gjitha veprimet e domosdoshme dhe të duhura në kuadër të kompetencave të tyre me qëllim të hetimit dhe trajtimit të këtij rasti me profesionalizimin më të lartë, me ndërgjegjen më të lartë, me humanizmin më të lartë, në mënyrë që drejtësia të zbardhë rastin në tërësi. Rast, i cili do të duhej të jetë shembull për të gjithë ata që mendojnë dhe kanë në mendje që t'i keqpërdorin të miturat ose këdo qoftë tjetër. Dhe, në fund, në bazë fakteve, argumenteve, të cilat do të sigurohen, organet përkatëse vërtet duhet t'u shqiptojnë dënimet në kuadër të ligjeve të gjithë atyre që kanë qenë të përfshirë ose ata që e kanë fshehur rastin.

Më duhet të përmend edhe faktin e mirënjohur, reagimin që është tash realisht gjithnjë në rritje, të gjithë shoqërisë sonë, pavarësisht moshës, pavarësisht gjinisë, profesionit dhe angazhimet të cilat i kanë, në ngritjen e zërit kundër kësaj ngjarje të shëmtuar, si dhe të gjithë bashkarish dhe me vendosmërinë më të lartë të angazhohemi dhe të përkushtohemi për eliminimin e plotë të këtyre veprimeve dhe fenomeneve shqetësuese. Shumë është me rëndësi që të gjitha institucionet, familja dhe e gjithë shoqëria, të angazhohen dhe të punojnë në preventivë, në parandalim të rasteve të tilla. Shfaqja e kësaj ngjarjeje tronditëse nuk duhet të lejohet assesi të përdoret dhe të keqpërdoret në çfarëdo mënyre dhe për çfarëdo qoftë. Domosdo ne duhet të fokusohemi te rastet e tilla dhe në kuadër të kësaj, si deputetë të këtij Kuvendi, si të zgjedhur të qytetarëve tanë, që na e kanë falur besimin të gjithë bashkërisht të kemi vetëm një qëllim dhe një qëndrim: të fokusohemi në raste të tilla me qëllim që institucionet përkatëse, që janë të thirrura,

që e kanë domosdoshmëri dhe obligim të jenë shumë aktive në preventimin e këtyre rasteve. Përveç kërkesave të tjera, ne kemi pasur dhe kemi shqyrtuar në lexim të parë Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, kërkoj që ky projektligj të silltet sa më shpejt në leximin e dytë dhe është një nga mundësitë, një nga format, një nga mënyrat që janë obligim i këtij Parlamenti të parandalojë rastet e tilla. Të gjitha organet përkatëse, edhe Oda e Avokatëve të Mjekëve, edhe të gjithë të tjerët kanë marrë masat përkatëse, edhe Inspektorati Shëndetësor. Unë e kam një informacion dhe një raport të Inspektoratit Shëndetësor, i cili e ka inspektuar ordinancën private në vitin e kaluar. Do të duhej që ato raporte, të cilat janë nxjerrë vërtet të trajtohen me seriozitetin më të madh dhe të mos kërkojmë diçka që realisht nuk është tash.

Organet ligjzbatuese dhe posaçërisht, ministrat që janë përkatës dhe që përfaqësojnë linjat që janë të kyçura ose personat, të cilët janë të kyçur në këto keqpërdorime, të jenë shumë konkretë jo vetëm në dënimin e këtij rasti, jo vetëm në hapjen e mundësive për t'i hetuar dhe për ta hetuar këtë rast deri në fund, por njëkohësisht t'i angazhojmë të gjitha mekanizmat që janë të bollshëm dhe janë të mjaftueshëm, të funksionalizohen në këtë drejtim. Unë besoj dhe jam i sigurt që në rrethana të tilla nuk do duhej në asnjë situatë të dalim jashtë asaj që është kompetencë dhe mundësi jona, nuk do duhej që ne të paragjykojmë, që ne të linçojmë dhe nuk do duhej që në asnjë mënyrë ne ta përdorim këtë rast për qëllimet, të cilat i kemi të gjithë, po që nuk do të duhej këtë rast dhe në këtë situatë të na shërbejnë për t'i promovuar këto. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Vajza dhe gra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Rrëfimi i nxënësës së abuzuar shumëfish tregon shtrirjen e krimit të organizuar institucional, sepse ngjarja përfshin të paktën tre abuzues: mësimdhënësin, policin dhe gjinekologun. Kjo i kapërcen të gjithë kufijtë e rastësisë dhe nga kjo foltore u bëj thirrje të gjithë atyre që duan ta relativizojnë këtë ngjarje, le të ndalojnë së bëri një gjë të tillë, sepse janë tri profesione, janë tri institucione.

Pra, ky nuk është rast i izoluar. Fatkeqësisht institucionet e Republikës së Kosovës janë plot abuzues dhe këtë e them me zë të hapur, sepse ne, sidomos ne gratë deputete në vazhdimësi dëgjojmë skandale të tilla. Pra, në institucione ka njerëz pa pikë ndjeshmërie për jetën, dinjitetin, mirëqenien e vajzave dhe grave. Si mund të hasë në një arsimtar, në një polic, në një mjek të gjithë dhunues, sepse të tillët ekzistojnë, të tillët respektohen nga shoqëria dhe, a e dini pse? Sepse janë burra, janë burra me autoritet! Shtrohet pyetja se pse mund të arrinin te këto vepra? Përmes shfrytëzimit të autoritetit, pra. Ata, pra kanë shfrytëzuar një vajzë, jo vetëm të re në moshë, por edhe të pafuqishme në kuptim ekonomik të fjalës. Pra, një vajzë që vjen nga një

familje me gjendje jo të mirë ekonomike, një vajzë të varfër. Në këto rrethana është lehtë të triumfojë kultura seksiste. Dhe, cila është më tragjika e gjithë kësaj historie: është se ka kushedi sa e sa raste të tilla, shumicën prej të cilave nuk e kemi kuptuar asnjëherë dhe nuk do t'i kuptojmë asnjëherë, sepse nuk do të flasim asnjëherë publikisht. Nuk do të shkojnë asnjëherë në polici dhe prokurori, mbase është edhe më e sigurt të mos shkojnë atje dhe kjo është gabim, por kjo ndodh për shkak të këtyre rasteve, për shkak se kur shkon në polici për të raportuar një dhunim ose një ngacmim seksual, ti dhunohesh seksualisht nga polici, a ka më keq! Çka duhet të ndodhë në këtë shoqëri që ne të zgjohemi, çka duhet të ndodhë në këtë shoqëri tutje?

Por, fakti që histori të tilla nuk shfaqen në televizione, nuk do të thotë që nuk ndodhin dhe kjo na obligon ta adresojmë përditë çështje gjinore, për të gjitha gratë dhe për të gjithat vajzat, dhe për secilën që dhunohen në forma të ndryshme. Ne nuk duhet të presim lajme me titull: "Abuzohet e mitura", "Keqtrajtohet seksualisht gruaja rome", "Vritet kaq vjeçarja", "Sulmohet kaq vjeçarja", rrëfimi i vajzave nga Gjakova, Prishtina, Fushë-Kosova, Drenasi, Peja, Skenderaj. Rasti i abuzimit me 16-vjeçaren është shpërfaqje e dështimit të organeve të drejtësisë dhe një varg institucionesh të tjera, si ajo e arsimit, policisë dhe shëndetësisë. Dhe, ne sot këtu i kemi dy ministra, ne kërkuam që të jetë edhe kryeministri në këtë seancë, le të na tregojnë se prej mandatit të tyre çka kanë bërë që t'i mbrojnë fëmijët, t'i mbrojnë të miturit, vajzat dhe gratë. Çka kanë bërë? Asnjë veprim! Madje edhe një amendament që e pati propozuar deputetja Nagavci për psikologë nëpër shkolla, e pedagogë, është refuzuar nga ky Kuvend. Ja, pra, ky është Kuvendi i Republikës së Kosovës, kjo është Qeveria me ministrat që s'bëjnë asgjë në këtë drejtim.

Ministria e Arsimit është shndërruar në çerdhe të militantëve partiakë, asgjë nuk është bërë në këtë drejtim dhe, ministër, edhe ju i Arsimit dhe ju i Punëve të Brendshme, edhe ai i shëndetësisë që sot nuk është këtu, a do duhej t'ju brente ndërjegjja? A do duhej që të paktën menjëherë që keni dëgjuar për lajmin, të mbani një konferencë të jashtëzakonshme, apo vetëm me reagime dhe atë të vonshme në rrjetet sociale. Kjo është e papërgjegjshme, a e njihni ju dorëheqjen? A e njihni dorëheqjen morale? Ka ndodhur një rast jashtëzakonisht i rëndë.

Ministri i Punëve të Brendshme tha që e ka menduar dorëheqjen, por mos mendo, bëje dorëheqjen, s'ke nevojë të mendosh se ka ndodhur një rast jashtëzakonisht i rëndë. Ne ende po ashtu nuk u njoftuam se pse prokurori i rastit i ka mbyllur hetimet kundrejt mësuesit ose nuk u njoftuam se para se t' i mbyllë hetimet, a ka kryer ndonjë ekzaminim mjekësor, ose ndonjë ekzaminim të telefonit, apo mesazheve në rrjetet sociale, a ka bërë diçka prokuroi i rastit kur e ka mbyllur lëndën për ngacmimin seksual të mësuesit. A e ka marrë në pyetje të dyshuarin ose ndonjë dëshmitar? Apo vetëm e ka mbyllur rastin, sepse vajza s'paska ofruar prova. Tjetra, sistemi ynë arsimor përveç që na lë të keqarsimuar, shkollat tona janë bërë vende krimi. Akuzat për ngacmim të nxënësve në shkolla po rriten, e sa e sa kanë kaluar e po kalojnë në heshtje. Profesorët marrin dënime minimale me suspendim disajavor, ose siç ishte rasti i fundit në

Gjakovë, atyre vetëm u ndërrohen vendet e punës ose rasti i fundit në Fushë-Kosovë që sapo vija në këtë seancë e pashë që për ngacmim seksual është liruar në procedurë të rregullt. Kjo është inkurajim për abuzuesit e keqpërdoruesit, kjo i inkurajon. Prandaj, institucionet e drejtësisë do të duhej të ishin vigjilente.

Ngacmimet e abuzimet seksuale nuk po marrin dënime, e kësisoj po legjitimohen, po normalizohen. Mund të flasim, ta zëmë, tri ditë, pas tri ditësh kjo prapë harrohet nëse s'ka veprime konkrete për t'i ndalur këta abuzues. Unë nuk e di, i paskam edhe tre minuta dhe po mundohem që përveç nënkrytares tonë, zonjës Kollçaku, t'i përmend edhe disa çështje që mendoj që duhet të dalin si rekomandime. Vetëm po ju tregoj, vetëm dy vjetët e fundit janë 123 raste të ngacmimeve, keqtrajttimeve, vetëm ato që i dinë, që janë të raportuar në Polici. Merreni me mend për ato që s'i dimë fare, për të cilat fola më herët. Në këto rrethana konsideroj që ne gratë deputete, nëse jo për diçka tjetër, duhet të bëhemi bashkë për këtë. Le të aktivizohemi në organizatat për të drejtat e grave, le të mos ndalemi derisa ta sjellim një kulturë të barabartë dhe jodiskriminuese, derisa një kulturë feministe të triumfojë.

Unë sot nga kjo foltore e Kuvendit u bëj thirrje të gjitha vajzave dhe grave, le të raportojnë te ne rastet e ngacmimeve seksuale, le t'i raportojnë te ne. 38 apo 39 gra deputete sa jemi. Ne do të jemi bashkë me ato derisa ta marrin dënimin e merituar përdhunuesit dhe kriminelët. Dhe, mbrëmë u njoftova me një rast, po ashtu skandaloz dhe po ashtu, më trishtoi, sikurse edhe ky që ka ndodhur. Në 2002 po ashtu në Drenas ka ndodhur një rast i dhunimit seksual. Dhe, i dyshuari, po i referohem kësisoj, ndonëse faktet janë të mjaftueshme për të qenë i akuzuar dhe i dënuar, është lënë i lirë, njëri ka ikur si ndihmës i të akuzuarit kryesor, ka ikur nga Kosova dhe tjetri endet lirshëm. Është rasti i zonjës Kimete Kastrati, të ndjerës, për shkak se pas dhunimit ajo ka pirë substanca, e ka helmuar veten dhe nuk jeton më. Por, le që ajo nuk jeton më për shkak të dhunimit seksual, po as kryesi nuk është para drejtësisë. Gjykata Supreme tri herë e ka sjellë në rigjykim rastin, dy apo tri herë, sepse nuk i kam informacionet të sakta, dy ose tri herë Gjykata Supreme e ka kthyer në rigjykim rastin dhe, në dhjetor kanë qenë seancat për këtë rast, në dhjetorin që lamë pas dhe anulohen seancat, dështon seanca. Institucionet e drejtësisë duhet të jenë në krye të detyrës dhe t'u dalin në ndihmë vajzave dhe grave, gjithë shoqërisë, por sidomos vajzave dhe grave.

Unë mendoj që duhet të bëhen edhe disa rekomandime, përveç psikologëve, pedagogë në shkolla, ndarje e fondeve nga Qeveria për rehabilitimin e personave, viktimat e dhunimeve, abuzimeve, edukimi seksual nëpër shkolla, vetingun në polici është diçka urgjent, përveç në prokurori e gjykata, vetingu në polici është urgjent dhe po ashtu, rishikim i Ligjit për ndërprerje të shtatzënisë. Aktualisht, secila ordinancë e kryen shtatzëninë.

KRYETARI: Faleminderit! Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar Partia Socialdemokrate.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ministra që po merrni pjesë në këtë seancë,

Natyrisht që sot besoj, sikur edhe shumica prej jush, edhe unë e shoh shumë të vështirë që të flas për vajzën nga Drenasi, sepse nganjëherë më duket hipokrizi që sa herë që të mblidhemi e diskutojmë për dhunimin këtu, jemi tashmë shumë vonë.

Është e qartë që për vajzën nga Drenasi tashmë jemi shumë vonë. Në këtë drejtim kemi dështuar, pra i kemi dështuar vajzat dhe gratë tona. Nuk ndërtoam shtet që i mbron, por ndërtoam shtet që i dhunon, sepse në këtë rast i kemi tri instanca të autoritetit: mësuesit, polici dhe mjeku, të cilët në sinkron e si zinxhirë keqpërdorën pozitën zyrtare e autoritetin që ia vesh profesioni e sistemi për t'u angazhuar në përdhunim sistematik ndaj një të miture, duke e përjashtuar tërësisht subjektivitetin e saj njerëzor e të drejtat e saja qytetare. Por, këta kanë pasur edhe një autoritet tjetër, e ai është autoriteti shoqëror, e autoriteti shoqëror i këtyre është të qenit burrë. Këta e kanë përdorur këtë autoritet që ia vesh shoqëria. Vajza nga Drenasi vinte nga një familje e varfër, pra ishte vajzë e varfër. Të dyja këto, statusi shoqëror i saj, edhe gjinia e saj, i kemi bërë ne si shoqëri të lëndueshme, pra të dhunueshme. Dhe, këta tre, mjeku, mësuesi dhe polici, pikërisht këtë e bënë, pa ngurrim. Po përtej sjelljes së tyre kriminale ose të fajtorëve në këtë rast, duhet të pyesim veten a ka strukturë shoqërore të pushtetit, të cilat e mundësojnë dhe e kushtëzojnë një dhunim të tillë. Pra, a nuk i trajtojmë ne me përçmim e sikur barrë, të paditur e të dobët, të padëshiruar të varfrit dhe a nuk i trajtojmë gratë sikur asgjë më shumë se sa objekt për përdorim tonin, herë vetjak e herë grupor.

Subjekt i seancës së sotme nuk është as i ndryshëm dhe as i ndarë nga diskutimi mbi rendin patriarkal që është i përbrendësuar në institucione e profesione të të gjitha llojeve. Këtë mentalitet me bazë nga historia ne e kemi rrënuar, por nuk e kemi rrënuar, më falni, por e kemi thelluar aq shumë sa që është bërë pjesë e sjelljes dhe praktikave institucionale e ligjore. Po thuhet që këto raste tregojnë për zhbërje të vlerave shoqërore dhe normave morale. Unë megjithatë kam një bindje tjetër. Problemi nuk qëndron te zhbërja e normave, por pikërisht tek fakti që këto vlera e norma nuk janë zhbërë, ato janë thelluar e sofistikuar. Kur flasim për të kaluarën dhe tregojmë për histori e moral, i përshkruajmë ato si parajsë të humbur, ndërsa të tashmen e kritikojmë në emër të disa vlerave që kinse po zhbëhen dhe se e tashmja është tregues i një korrupsioni moral mbarëshoqëror. Rasti që na ka mbledhur sot konfirmon që shtypja në baza gjinore vazhdon, por në të njëjtën kohë na detyron që lufton për barazi gjinore ta ngremë në një nivel tjetër.

Ka rregullore e ligje, siç janë edhe normat tona shoqërore, të cilat nuk bien në radar dhe nuk cilësohen si seksiste, këto janë më të rrezikshme, sepse shpesh në emër të barazisë gjinore na përvidhet shtypja gjinore, gjithmonë duke përligjur veten në emër të ligjit, shkencës, mjekësisë,

edukimit, ekonomisë, siç është rasti me punën e papaguar të grave amvise dhe gratë e papunësuar, pastaj të estetikës, të artit e kulturës, duke e shtrënguar rolet gjinore në nënshtrimin e vjetër. Por, me infrastrukturë të re.

Pra, në një anë, duhet ndërtuar politika rigoroze për ndërhyrjen në secilën shkallë dhe në secilin profesion, duke integruar brenda secilës politikë thjerrëzën gjinore dhe, në anën tjetër, duhet ta diskutojmë seriozisht dhe gjerësisht, me seanca e debate, në tubime, takime e protesta, po thjerrëzën gjinore dhe domosdonë e barazisë gjinore. Marrëdhënia seksuale me të mitur është përdhunim dhe për këtë natyrisht që nuk mund të ketë diskutim. Rrëfimi i vajzës, e cila kishte filluar të përdhunohej, keqtrajtohej dhe abuzohej, nisi në moshë të mitur dhe vazhdoi deri më sot. Ky rast duhet t'i tejkalojë përmasat e një rrëfimi lokal, sepse nëse nuk kemi ndërmarrje mbarëshoqërore për rastin në fjalë, kjo dhunë ndaj saj vetëm sa do të rritet. Tash, jo nga tri autoritetet e pushtetit: mjeku, mësuesi e polici, por nga shteti, shoqëria e rrethi familjar. Këtu kemi të bëjmë me dhunë gjinore, në formën e saj më të dukshme, e çka bëjmë atëherë kur nuk është kaq brutale paraqitja e këtij krimi. Rasti në fjalë duhet të jetë alarm për të gjitha rastet e tjera, të cilat kanë ndodhur, janë duke ndodhur dhe kanë për të ndodhur nëse ndërmarrja jonë do të kufizohet në reagime e emocione të momentit. Edhe reagimi, edhe emocionin janë dritëshkurtër, nëse nuk ndërhyhet me hapa konkretë në secilën fushë dhe profesion. Me rastin e fundit të vajzës nga Drenasi duhet ta vendosim diskutimin te shëndeti, edukimi dhe siguria e secilit qytetar. Të tria këto u goditën përmes rastit në fjalë, por i cili nuk është as i veçantë, e as përjashtues për rastet e tjera.

Pra, diskursi që u prodhua nga vrasjet e grave dhe fëmijëve, e tash së fundi nga rasti i abuzimit të trefishtë me vajzën nga Drenasi, tregojnë që ende nuk kemi adresuar këtë çështje siç duhet. Përderisa veprojnë në një shoqëri, ku mbizotëron hierarkia gjinore, dhuna është në etjen e secilit dhe secilës, në formë të ndryshme, sepse nuk mund të ketë liri e as barazi gjinore, nëse njëra prej gjinive i mbivendoset tjetrës. Në anën tjetër nuk mund të ketë drejtësi për viktimën përderisa e trajtojmë me një gjuhë moralizuese e patronizuese atë dhe kjo vlen sikur për mbrojtësit, ashtu edhe për ata që i sulmojnë ngjarje të tilla. Ajo që kemi parë këto ditë në formën e reagimit shoqëror është inkurajuese, pra çka është e veçantë sot, çka ka qenë e veçantë dje dhe çka ka qenë e veçantë rreth këtij rasti, është reagimi shoqëror, i cili e ka përshëndetur dhe e inkurajon denoncimin e rasteve të tilla që ndodhin e mund të ndodhin, e janë duke ndodhur edhe derisa ne jemi duke folur. Prandaj, një reagim i tillë shoqëror duhet domosdoshmërisht të reflektohet me reagimin e duhur institucional dhe kjo seancë, mes tjerash, e ka dhe këtë qëllim: ta prodhojë një fund një rezolutë propozimesh, masash konkrete, të cilat domosdoshmërisht duhet të merren parasysh nga autoritetet, veçanërisht nga ekzekutivi, në mënyrë që sadopak ta sanojmë gjendjen dhe t'i krijojmë disa prej masave parandaluese të krimeve të tilla.

Mirëpo, përveç kësaj, përveç inkurajimit të denoncimit, ky reagim shoqëror duhet të përdoret domosdoshmërisht edhe për ta parandaluar damkosjen e viktimave, sepse edhe ky është problem

jashtëzakonisht i madh në shoqërinë tonë. Gratë dhe vajzat, viktimat të përdhunimit seksual, damkosen nga shoqëria sikur ato të ishin fajtoret e jo të qenit viktimat. Unë pajtohem me disa prej propozimeve këtu që u dhanë për masat që duhen ndërmarrë. Natyrisht që duhet t'u kushtojmë kujdes të veçantë masave rehabilituese e socializuese për viktimat. Pra, duhet të fuqizohen dhe të mirëfinancohen strehimoret, të cilat ekzistojnë në Kosovë dhe të shtohet numri i tyre, se natyrisht që nuk janë të mjaftueshme, në mënyrë që viktimat e përdhunimit dhe të dhunës në familje ta kenë mbrojtjen e duhur institucionale. Dhe, në anën tjetër, domosdoshmërisht, përveç kësaj dhe krahas kësaj, institucionet e Republikës së Kosovës duhet t'i ndërmarrin masat, në mënyrë që të krijojmë mekanizma të tillë që e lehtësojnë dhe e ndihmojnë denoncimin, e veçanërisht në qasjen e këshillave juridike dhe ndihmës juridike për viktimat, por në anën tjetër, edhe mekanizma të tillë, të cilat parandalojnë rastet e tilla veçanërisht të abuzimit dhe keqtrajtimit të pozitës zyrtare dhe përdorimit e keqpërdorimit të kësaj pozitës zyrtare në raste të tilla të krimeve të përdhunimit ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, siç e kemi me këtë rastin e Drenasit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot ballafaqohemi me një rast që është në opinionin publik, e që normalisht çdonjëri prej nesh e dënon si akt të shëmtuar dhe kërkojmë që drejtësia të veprojë ashtu si duhet, në bazë të ligjeve në fuqi.

Para së gjithash, ne shumica këtu jemi prindër dhe pavarësisht nga gjinia duhet ta ndiejmë njësoj në ndërgjegjen dhe vetëdijen tonë dhe nuk duhet bërë dallime në këtë drejtim. Por, si deputetë ne kemi obligim të japim ide për zgjidhje konkrete që mundësojnë që të mos ndodhin më veprime të tilla në shoqërinë tonë. Ne duhet të kërkojmë nga institucionet edukative-arsimore të shtohet kujdesi dhe përgjegjësia, e kjo veçmas vlen edhe për komisionet parlamentare, të cilat duhet të bëjnë një monitorim më të madh të zbatimit të ligjeve dhe, po ashtu, të angazhimit të drejtpërdrejtë në këtë segment, në mënyrë që në institucionet tona të ketë një angazhim permanent profesional, e që nuk ka devijime të tilla.

Po ashtu, ne kemi obligim që nëpërmjet komisioneve përsëri të monitorojmë ato çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e rendit dhe të ligjit, të kërkohet një përgjegjësi më e lartë dhe të gjithë ata kriminelë që bëjnë veprime të tilla të dënohen me dënimet maksimale, që janë me ligjet në fuqi, por që konsideroj se nëse këto ligje nuk janë në përputhje me veprimet që po ndodhin në shoqërinë tonë, atëherë duhet të jemi edhe më rigorozë që t'i ndryshojmë e plotësojmë këto ligje, në mënyrë që të kemi funksionim si duhet të institucioneve tona. Njëkohësisht, inkurajojmë të gjitha ato gra a vajza, të cilat mund të jenë të cenuara dhe mund të jenë pre e ngacmimeve apo

veprimeve që prekin në moralin e tyre, të lajmërojnë institucionet përkatëse dhe drejtësia të vihet në vend.

Ne mund të mbajmë fjalime të gjata sa të doni, por nuk e arrijmë qëllimin tonë nëse nuk i bëjmë veprimet adekuate që na takojnë neve si deputetë. Këto që i përmenda besoj se mund të jenë një shtytje edhe për përmirësimin e ligjeve, edhe për kërkesë më të madhe të funksionimit të institucioneve tona, por edhe të ndërgjegjësimit të qytetarëve, në mënyrë që kurrgjë të mos fshihet në këtë shoqëri nëse është negative, përkundrazi të gjithë të inkurajojmë që të funksionojë shoqëria jonë ashtu si duhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Halimaj, të lutem, kërkoj falje se...

Kërkoj falje, po më mirë është t'i kem me shkrim...

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo që ndodhi në Drenas është një lëkundje e etikës profesionale në punë, lëkundje e shoqërisë dhe e shtyllave të shtetit.

Ky fjalim është tejet personal në disa momente, por e kam parë të arsyeshme të diskutoj në këtë mënyrë, për shkak se ne të gjithë këtu kemi nevojë të shohim këtë rast sikur të ishte yni për të dhënë maksimumin që secili prej nesh këtë vend ta ndërtojë ashtu siç ne dëshirojmë t'i shohim fëmijët tanë në të. Me keqardhje dhe shumë dhembje sot e mora fjalën për këtë rast kaq tronditës e çnjerëzor, një krim ky zinxhiror, ku viktimë u bë një fëmijë. Hallka e parë e këtij krimi është shkolla, që duhet të jetë shtëpi e dijes, e edukimit e emancipimit, por jo! Për fatin e saj mizor u bë shtëpi e torturës, shantazhit dhe përdhunimit. Me shpresë se do t'i jepte fund mizorisë, kërkoi ndihmë në shtëpinë e dytë, hallka e dytë, që duhet të jetë shtëpi e mbrojtjes, e ndihmës, e sigurisë. Jo që nuk ia dha dënimin meritor krimin të denoncuar, por në vend të mbrojtjes, e vazhdoi dhunimin duke keqpërdorur uniformën mbrojtëse të shoqërisë sonë.

Duke u munduar që të fshehin gjurmët e dy krimeve, hallka e tretë mbylli sytë ndaj shenjtërisë së profesionit dhe përfundoi zhvillimin e një krijese të re, duke rrezikuar jetën e një vajze kaq të re, kaq fatkeqe. Që ta kemi parasysh, ndërprerja e një shtatzënie është krim, e sidomos kur për këtë ndërprerje nuk janë të njoftuar prindërit e saj, meqë ajo ishte nën kujdesin e tyre. Ky rast tronditës ka shkelur Konventën e të drejtave të fëmijëve, respektivisht nenin 34, ku shteti merr përsipër të mbrojë fëmijën nga çdo formë e shfrytëzimit dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim shteti në mënyrë të veçantë merr të gjitha masat e duhura për të mos lejuar që fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale, që fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme.

Kenza, vajza ime që ka mbushur pesë vjet, si shumë fëmijë kishte frikë nga alarmi i policisë, e që ky alarm e bëri pastaj të kishte frikë edhe nga uniformat policore, kur ishte e vogël. Më është dashur një kohë goxha e gjatë që ta bind atë se policët janë mbrojtësit tanë, se ata janë të përkushtuar për sigurinë tonë dhe sa herë që kemi nevojë, ata janë aty për të na ndihmuar neve, në çfarëdo rrethane e momenti, se ata ekzistojnë vetëm për ne. Dhe, tanimë ajo është bindur për veprat e mira të tyre dhe vërtet ata i sheh si heronj. Sa herë që i sheh, i vjen një buzëqeshje gëzimi dhe dora e saj e vogël ngritët për t'i përshëndetur mbrojtësit e saj. Ajo sapo takon dajën e saj polic nuk harron ta falënderojë çka ata bëjnë çdo ditë për ne, e shpesh i shpreh dashurinë që ka ndaj tyre. Ajo aq shumë i do. Imagjini që nesër këtë ndjenjë sigurie e dashurie që kam mbjellë tek ajo për policët, njëri nga ata ta shfrytëzojë. Mendojeni se sa lehtë do t'i besonte e do të mund të bëhej një viktimë e radhës.

E Jana, si 1,5 vjeçe që është, ka filluar të ketë ndjenjën e njëjtë të frikës sikurse motra e saj më e madhe. Është mjerim që sot unë fëmijës tim të mos i them se ti je e mbrojtur nga ata, e siguruar dhe e lirë për të gjetur ndihmën e duhur në çfarëdo rrethane. Si mund t'i drejtohem vajzës së vogël, sikurse të madhes? Kush më garanton se unë nuk po gaboj duke ia mbjellë të njëjtën siguri? Unë jam e bindur se nuk janë të gjithë abuzues të këtillë, nuk janë të gjithë të njëjtë, por a nuk mjafton ky rast kaq mizor që të na frikësojë se nesër mund të jetë një viktimë tjetër e njëjtë?

Sot le të bëhemi prindër të vajzës së njomë. Të kërkojmë drejtësi sikur për fëmijën tonë. Ndoshta do të ishte më mirë të flasim me rezerva, për shkak të procesit të hetimeve dhe mendimit përfundimtar të gjykatës, por pavarësisht kësaj, mësuesi, polici, mjeku ia dhunuan moshën, ia dhunuan papjekurinë, ia dhunuan fëmijërinë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumica nga ju jeni edhe vetë prindër dhe besoj se edhe fëmijët tuaj, ashtu si Kenza kur kthehet nga çerdhja, përveçse më tregojnë se çfarë kanë mësuar gjatë ditës, ajo ulet dhe më flet me shumë dashuri e shumë respekt për edukatoren e saj dhe për të ajo është e shenjtë. Fjala e saj është ligj. Jam e sigurt se ndjenja të tilla do të ketë edhe ndaj mësueses apo mësuesit kur të hyjë në klasë të parë. Po sikur një mësues, siç është ky, të shfrytëzojë padjallëzinë e saj prej fëmije, po sikur kjo ndjenjë dashurie të vazhdojë te Kenza edhe më tej!? Sa lehtë do ta kishte një mësues i tillë ta mashtronte e të manipulonte me të! Jo, nuk duhet të lejojmë që abuzues të tillë as të shkelin në oborrin e shkollës sonë, e jo më të kapin ditarin. E kemi detyrim njerëzor e shtetëror, që fëmijëve të vendit tonë, të Kosovës sonë, t'u krijojmë institucione të mirëfillta, ku asnjë e drejtë të mos u cenohet.

Nuk duhet të lejojmë që kriminelë të tillë të jenë mësues të së ardhmes. Duke dhunuar fëmijët, ata dhunojnë të tashmen e të ardhmen e vendit tonë.

T'i kthehemi pak punës sonë në Kuvend. S'ka pak ditë që kaloi në lexim të dytë Projektligji për buxhet. Siç e dini, aty kërkova njëzet norma shtesë për komunën e Prizrenit pikërisht për edukatorë, psikologë e pedagogë. Jo se me këto norma do të mbuloheshin të gjitha shkollat, por të paktën një psikolog do ta kishin dy-tri shkolla. Dhe, çka bëtë ju, kolegë deputetë? Nuk e votuat. Pra, a s'e kemi edhe ne një pjesë faji, sado i vogël të jetë, të kësaj gjendjeje të sistemit arsimor?

Jo veç Prizreni, por në tërë Kosovën e kemi këtë gjendje, ani pse kohëve të fundit ka lëvizje pozitive.

Të nderuar deputetë, mosha e vajzave të mia ende nuk e di kush është Zoti, në cilën formë ekziston ai. KENZA, pak më e rritur se JANA, e sheh mjekun si një Zot. Zoti i saj është mjeku i saj. Kështu me këtë besim ajo do të rritet, ani pse më vonë do ta kuptojë rolin e mjekut dhe Zotin, por ajo kurrë nuk do të ndryshojë besimin për ta. Ajo do t'i shohë ata si shpëtimtarë, ajo do ta rendisë mjekun e saj, ashtu siç bëjmë edhe ne shpesh, menjëherë pas Zotit. E si mund t'i them unë që nesër një mjek merr rolin e Zotit me kompetencë të plotë dhe bën një vepër që i përket vetëm Zotit, pa u konsultuar me palët që duhet të përfshihen në atë rast. A mendoni se unë duhet t'ia heq këtë besim asaj? A mendoni se unë duhet t'i them që të ketë kujdes edhe nga mjekët?

Të nderuar prindër, bëhuni vija e parë mbrojtëse. Mos heshtni ndaj asnjë padrejtësie që u bëhet fëmijëve tuaj. Heshtja juaj ndihmon në vazhdimin e padrejtësisë së tij. Trajtojeni me sa më shumë dashuri e besim, qetësi e kuptueshmëri fëmijën tuaj, jeni dëgjues e vëzhgues, mbrojeni të drejtën e fëmijës suaj. Mos neglizhoni asnjë situatë, asnjë gjendje emocionale të fëmijëve tuaj, luftoni bashkë me ta deri në fund. Gjithçka për ta jeni ju. Nëse ne si prindër nuk merremi me ta, kujt po i lëmë në dorë fëmijën tonë!?

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Bashkërisht duhet t'i identifikojmë dhe t'i vëmë para drejtësisë abuzuesit e tillë.

Kërkoj nga ju, deputetë, që në harmonizimin e rekomandimeve për rezolutën në fund të këtij debati të merrni si pikë heqjen e licencës së mësimdhënësit të gjithë mësimdhënësve kur kanë raste të tilla, të gjithë mjekëve t'u hiqet licenca e punës gjithashtu dhe të gjithë policët, që përfshihen në skandale të tilla, të mos kenë të drejtë kurrë të ushtrojnë atë profesion. Pastaj, në bazë të këtyre rekomandimeve, ministritë përkatëse të marrin vendime urgjente. Këto lloj vendimesh do të parandalonin raste të tilla kudo, sepse mendoj se ky ishte një rast që u hodh dritë në të, por mund të ketë raste të tjera, për të cilat nuk kanë guxim të lajmërohen pikërisht nga mosdënimi i tyre.

KRYETARI: Faleminderit! Para se ta kaloj fjalën tek 6+si, dëshiroj, besoj se edhe në emrin tuaj, t'i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e protestës sot që ka qenë në Drenas dhe t'i inkurajojmë të

gjithë njerëzit, nxënësit, punonjësit e të gjitha kategoritë e shoqërisë që të jenë më të zëshëm ndaj çdo dukurie të tillë, që e dëmton imazhin pikërisht të atyre institucioneve, siç është ai i mësuesit, arsimtarit, profesorit, policit dhe mjekut, të cilët po bëjnë një punë të jashtëzakonshme dhe i falënderojmë për punën e tyre që janë duke e bërë. Distancohem nga njerëzit e këqij.

Tani, zonja nënkryetare, po, fjala për ju. Në emër të 6+, zonja Myfera Serbica-Shinik.

MÛFERA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryetar!

Sayın Bakanlar, Milletvekilleri

Bugün Kosova Meclisinde tecavüz, cinsel taciz ve reşit olmadığı halde kanunsuz kürtaj yapma konusunda Kosova Hükümetinin sorumlulukları tartışılıyor. Bu hafta içerisinde medyalarda alınan haberlere göre, patlak veren yukarıda adı geçen bu konu dünyaca kanayan bir yara maalesef. Tabii ki bu konu Kosova gibi yeni bir ülkede daha da ürkütücü oluyor. Bu ve buna benzer olayların olagelmesi, aile eğitimi, dini eğitimi yasaların Avrupa uyumlu olmasına rağmen, yasaların yürürlüğe geçmemesinden kaynaklanmaktadır. En son duyulan bu olayla ilgili Kosova İçişleri Bakanlığı, Kosova Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanlığı ve Sağlık Bakanlığının aktif olması gerektiğine inanmaktayız.

Olayı, yasalara uygun bir şekilde mahkemenin karar alacağına eminiz. Bu ve bu gibi olaylarda mahkeme sisteminin çalışacağına ve kanunen gerekli cezaların verileceğine kesin gözüyle bakmaktayız. Tecavüze, cinsel tacize uğrayabilecek her kız çocuğu bir potansiyel karşısında olabilir. Bundandır annelerin başta olmak üzere, ailelerin konuyla ilgili kız ve erkek çocuklarını ayrı ayrı açılardan bilgilendirmeleri ve bilinçlendirmeleri gerekmektedir. Bunun yanı sıra, konuyla ilgili ilk okul ikinci kademe derslerinde reşit olmayan öğrencilere en azından seçmeli ders yerine, zorunlu sağlık birimlerine geçilmesi gerekmektedir. Okullarda psikolog ve pedagogların olmasını bas bas bağıarak istiyoruz. Bu da Eğitim Bakanımızın dikkatine oluyor. Yaşanan bu olay gibi kendi çekingenlik ve olayın duyulmasından çekinen tecavüze uğramış taciz edilmiş kızların sessiz kalmaları olay sayısının gerçek olmadığını ortaya çıkarmaktadır. Bu kızların psikolojisinin biyolojik, fiziki, ruh sıkıntıları yaratan ve bu gibi olayları yaratanları esefle kınıyoruz. Hakim karşısında en yüzek ceza alacaklarına inanıyoruz.

6+ Parlamenter gurubu olarak Kosova Ceza Yasalarına göre cezalandırılacağına inanarak, şiddetle kınar ve tekrarlanmamasını temenni ederiz. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Unë e kam traditë, pa grup jua jap çdoherë fjalën. Mimoza Kusari Lila, edhe ndonjë ditë, se ndoshta del ndonjë grup, s'dihet... Jo ne të gjithë që jemi, pa paragjykim, zonja deputete, fjala për ju.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit për fjalën, kryetar!

S'ka nevojë të parashikosh të ardhmen politike. Jemi këtu për një temë të ndjeshme, shumë serioze dhe të domosdoshme për trajtim të mirëfilltë si deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Mendoj se sot të gjithë, para se të vijmë në seancë, është dashur ta pyesim veten a e kemi seriozisht trajtimin e kësaj teme, a dëshirojmë vërtet të merren masat që parandalojnë shfrytëzimin, trafikimin, trajtimin e vajzave dhe grave si objekt, apo jemi këtu për ta bërë edhe një “tik” në rutinë e diskutimeve, si shumë të tjera që i kemi bërë. Nëse jemi këtu për ta marrë seriozisht, atëherë e kemi një rast ideal në kuptimin negativ për t'u trajtuar krejt problematika e funksionimit të sistemit të shtetit të Kosovës. Sot për këtë temë nuk duhet të jemi pozitivë-opozitivë. Sot për këtë temë duhet të jemi një e gjithë shoqëria kosovare, nëse e kuptojmë dhe jemi në pikën që duhet të themi se përveç ndryshimeve legjislative institucionale, duhet të fillojmë të diskutojmë edhe për normat shoqërore hapur. Kulturat dhe shoqëritë në Ballkan janë abuzive përgjithësisht ndaj vajzave dhe grave. Në vendet sikur kjo jona, ose sikur Kosova me një të kaluar traumatike, ky abuzim duket se shprehet në mënyrën ende më të egër, shpërfaqet në formën që forca dhe ushtrimi i forcës mbi to bëhet, ose shumëzohet në njëfarë mënyre më tepër se sa në vendet e tjera.

Në bërthamë të vet ky rast i tash 18-vjeçares nga Drenasi, me fillimin e abuzimit kur ka qenë 16, e tregon edhe mungesën, ose mekanizmin mbështetës për familjen. Vajza ka deklaruar qartë dhe saktë, për ç'gjë edhe është gjykuar dhe kryqëzuar, e pashë në rrjetet sociale dhe pardje, kur është prezantuar ky rast që i ka treguar nënës. Nëna s'ka pasur mekanizëm për ndihmë. Nuk e dimë raportin e nënës me babanë në familje, nuk e dimë a ka abuzim tjetër fizik në familje, por e saktë se nuk është askush në shkollë që mund t'i ndihmojë një vajze nëse i afrohet një arsimtar, i cili është i moshës madhore, i martuar dhe njeri familjar dhe i cili e shfrytëzon superioritetin e tij mbi të. Rasti bëhet ende më i rëndë, kur vajza konsideron ose mendon që është lidhur emocionalisht me arsimtarin dhe në momentin kur ai i thotë që s'kanë të ardhme, ajo i drejtohet policisë. E aty shpërfaqet në mënyrën më brutale mungesa e funksionimit të sistemit tonë.

Tash është një polic hetues që e ka keqpërdorur vajzën. Sot lexoj që ky polic hetues nuk e ka dorëzuar telefonin. Sot e lexojmë se provat që janë mbledhur në shtëpinë e policit hetues nga kolegët e tij nuk është telefoni i policit. Më falni, nëse e kemi një sistem, në të cilin është deklaruar se polici dhe arsimtari, natyrisht se është komunë e vogël, njihen dhe polici në mesin e shantazheve ose kërcënimeve që ia ka bërë vajzës i ka kërkuar ta tërheqë padinë, pyeti më duket Albulena, pse s'ka treguar prokurori pse e ka mbyllur? E ka mbyllur sepse e kanë detyruar vajzën të shkojë ta tërheqë dhe të dalë vajza të gënjejë e të thotë “jo, s'më ka abuzuar më herët arsimtari...” E tash, nuk dorëzohet telefoni! Po, tash nuk është më problemi i policit hetues. Tash është problemi i sistemit dhe kolegëve të tij.

Kolegë deputetë,

Ne jemi pjesë e kësaj kulture dhe të gjithë e dimë se ky rast, të gjithë këta muaj të abuzimit të policit ndaj vajzës nuk ka mundur të jetë i izoluar prej kolegëve të tij. Ne mund ta dimë se ai ato fotografi e atë rast e ka të ndarë me kolegët e vet. Prandaj, gjithashtu insistoj që për një komunë të vogël siç është Drenasi, ky rast të mos trajtohet në Drenas. Ky rast dhe hetuesia e këtij rasti nuk mund të mbetet me policinë e Drenasit, prej kolegëve të cilët e kanë ditur dhe me siguri se nuk e kanë denoncuar. Nuk mund të mbetet në Prokurorinë e Drenasit, ky rast duhet të shkojë prej prokurorisë ose prej një stacioni tjetër, të themi në Gjilan, a në Prizren, ku rrethanat në fakt për këtë rast nuk i prekin fare.

Ministri e ka përmendur dorëheqjen. Unë i them ministrit, para se të mendojë dorëheqjen, duhet menduar shkarkimi komplet i zinxhirit komandues të stacionit të Drenasit.

Kolegë të nderuar, a e mendojmë ne ndonjëherë përgjegjësinë morale, institucionale. Në rast se flasim për një krim të kësaj natyre, edhe nëse nuk ka ditur shefi i stacionit policor, që dyshoj, që të ndodhë diçka për tetë muaj e të mos e shohë që i mungon polici hetues në detyrë, që diçka s'është duke shkuar në rregull, e ndoshta edhe të tjerët që kanë pasur informata për këtë çështje. Në një hetim të thjeshtë të telefonave të policëve dhe kolegëve mund të zbulohet krejt rasti, prej momentit, edhe korrespondenca, edhe diskutimi i cili ka shkuar në këtë situatë të caktuar.

Tjetra, këtu sot ka pak ministra. Faleminderit për pjesëmarrjen e dy ministrave, po duket se po funksionojnë si institucione të shkëputura Qeveria dhe Parlamenti. E kuptojmë, thashë edhe një herë, që jeni pozitë-opozitë, ky rast nuk bën të na ndajë, ky rast duhet të na bashkojë. Këtu duhet të jetë ministri i Drejtësisë që ta tregojë komplet trajtimin e rastit në Prokurorinë e Drenasit, në këtë rast duhet të jetë ministri i Tregtisë dhe Industrisë. Çfarë bën një minorene në hotel, pa u regjistruar askund? Çfarë rregulla sot i ka Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për hotelet? Kush e bën kontrollin e hoteleve nëpër autostrada, që as nuk regjistrohet kush hyn dhe kush del? Cilat janë qasjet ndaj zbulimit të mirëfilltë të rrjetit të trafikimit dhe prostitucionit? Nëse jeni për të pasur prostitucion, atëherë legalizojeni dhe bëni kontrole të mirëfillta. Minoret keqpërdoren dhe shfrytëzohen në të gjitha rastet. Kjo është "Maja e Ajsbergut". Ky rast vetëm e ka shpërfaqur mungesën e zinxhirit institucional, kontrollit të mirëfilltë dhe keqpërdorimit të vajzave.

Rasti i mjekut, sot dëgjova prej kolegëve të mi deputetë, se mjeku qenka mjek, ose paska treguar profesionalizëm më herët. Nuk e njoh, veç po ju them diçka, dy nene të ligjit mbi ndërprerjen e shtatzënisë ose abortit janë shkelur me rastin e ekzekutimit të abortit te vajza. Edhe nëse mosha e saj është 18-vjeçare, Ligji mbi ndërprerjen e shtatzënisë, neni 5 tregon se në rastet kur vajzat janë 16 deri në 18-vjeçare, edhe 18-vjeçare, duhet minimum tri ditë, prej momentit të kërkesë për termin të abortit deri në momentin e ekzekutimit të abortit. Neni 11 e tregon gjithashtu që edhe në klinika, prej momentit kur paraqitet, kryhet kontrolli dhe ekziston dokumenti i mjekut specialist, tek pas dy ditësh merret, kryhet ose performohet nëse është 18-vjeçare aborti. Çka

është duke ndodhur me klinikat tona private, a janë bërë kasaphane? Termini i shtatzënisë në këtë formë dhe në këtë mënyrë e paraqet rrezikun më të madh të vajzave të kësaj moshe. Mungesa e edukimit seksual në shkolla e paraqet një problem, i cili nuk është më problem që ne duhet të fshihemi e të skuqemi, po është një çështje e cila secila vajzë e secili djalë duhet të dijë parandalimin e masave të shtatzënisë, sepse kur vjen te termini, paraqitet ose prezantohet rreziku edhe për shëndetin e vajzës. Prezantohet një problem tepër i madh për të ardhmen dhe për jetën e saj.

Për vajzën nga Drenasi sinqerisht unë shpresoj që do të ketë dikush një vizion ose një ide që ta marrë një organizatë e huaj, mundësisht, ta trajtojë si duhet. Kjo është e traumatizuar me krejt sistemin e Kosovës. Vajza sot do të ballafaqohet me gazetarë, do të ballafaqohet me kryqëzime të të gjitha formave që po i bëhet asaj dhe nënën së vet, e mbi të gjitha do të vazhdojë të jetojë në Drenas, aty ku ka filluar edhe abuzimi në rendin e parë. Shihet se ajo ka pasur probleme serioze edhe me vetëbesimin e saj kur ka deklaruar që unë kam menduar që do të martohem me arsimtarin, se kam pasur marrëdhënie me të. Ta trajtojmë këtë temë ashtu siç duhet trajtuar, t'ia heqim petkun të keqes. Po na ndodhin abuzime gjithandej. Abuzimet ndodhin edhe në institucionet fetare, abuzimet ndodhin edhe në kishë, edhe në xhami, edhe në teqe. E thotë Papa Françesku se janë mbajtur murgeshat si skllave seksi. Papa Benedikti e ka mbyllur në tërësi një mision për arsye të skllavërisë.

Pse nuk e thonë te ne. Te ne ka pasur raste ku janë marrë me prezantim ose me paragjykim të viktimës, po jo me diçka tjetër. Duhet treguar vajzave që nuk është në rregull të të prekë as hoxha, as shehu, as prifti. Edhe djemve të rinj. Nuk është në rregull të abuzohesh seksualisht dhe të mos flasësh me askënd. Nuk është në rregull dikush të të trajtojë si objekt. Vajzat trajtohen si objekt. Ne deputetet kemi reaguar për trajtim të deputeteve ku hyjnë në këtë sallë dhe si komentohet veshja e tyre. Nuk komentojnë gratë deputete për veshje të burrave. Komentojnë për gjuhën vulgare ndonjëherë. Nuk komentojnë ato gjëra të cilat nuk janë të pranueshme me normat tona. Hapini portalet, kolegë deputetë. Hapini portalet e Kosovës, po flas tash, në përjashtim të një ose dy. Lajmet e para pas lajmeve të mirëfillta të politikës, të themi kushtimisht, janë fotografitë lakuriq, gjysmëlakuriq të manikeneve e modeleve, janë storiet mbi incestet, janë storie të cilat janë të turpshme, për arsye se ushqehet imagjinata. Ne e kemi pasur para pak ditësh rastin e incestit në Gjilan. 13-vjeçarja ka lindur me djalin e hallës ose të dajës, 14-15 vjeçar. Ku është duke shkuar kjo shoqëri?

Ne jemi shoqëri shumë e vogël për të na ndodhur këto raste në këtë masë, në këtë përqindje, në këtë proporcion. Nëse e kemi seriozisht, t'i hyjmë në formë të mirëfilltë. Forma e mirëfilltë çka duhet bërë është hetimi, të kërkohet largimi i përgjegjësve nga stacioni policor në Drenas. Fushata e vetëdijesimit, po hyjmë në muajin mars. E kemi një muaj të tërë që duhet folur me vajzat, me djemtë, mbi edukimin seksual edhe formën se si duhet trajtohet. Protokoli i abortit të

ndryshohet, të kufizohet numri i klinikave që mund të kryejnë abortin, edhe të amendamentohet Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë.

KRYETARI: Faleminderit! Hykmete Bajrami, urdhëroni!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Edhe unë po i bashkohem thirrjes së parafolësës dhe po e them sinqerisht se si Lidhje Demokratike të Kosovës këtë seancë absolutisht nuk e kemi thirrur për të fituar poenë politikë. Rasti është tepër i ndjeshëm dhe si të tillë duhet ta trajtojmë. Më vjen keq që një fenomen të tillë, nuk e kemi trajtuar më herët, pa ndodhur rasti i Drenasit. Sepse si dukuri e tillë kjo është prezentë dhe po ndodh para syve tanë. Në secilën magjistrale të rrugëve të Republikës së Kosovës ne i kemi motelet, në çdo një kilometër dhe Ministria e Punëve të Brendshme asnjëherë nuk ka dalë të tregojë se a ka bastisur ndonjë apo jo. Në fakt, po ndodh prostitucion, po ndodh trafikim me qenie të gjalla. Pothuajse është legalizuar, sepse po ndodh para syve tanë, para syve të institucioneve. Rastet e tilla janë shumë prezentë dhe ne jemi dëshmitarë pse storie të tilla të abuzimeve, qoftë në shkollë, qoftë në institucione publike, qoftë në institucione private i dëgjojmë çdo ditë. Mirëpo për shkak të kulturës dhe mangësive që i kemi, hezitojmë t'i denoncojmë sepse, në fakt, mandej viktimat masakrohen publikisht dhe abuzuesit lirohen si të pafajshëm.

Të nderuar kolegë deputetë,

Një e mitur është dhunuar dhe është vrarë për së gjalli. Deri tash, u tha edhe më herët, tre persona janë në paraburgim dhe duhet të nxirren para drejtësisë plot përgjegjës të tjerë. Debati i sotëm assesi nuk e zëvendëson Gjykatën, as Prokurorinë, por na obligon secilin prej nesh që të propozojmë dhe të gjejmë zgjidhje që rastet e tilla të mos ndodhin më. Që rastet e ngjashme të denoncohen dhe të marrin dënimin e merituar dhe viktimat të mbrohen dhe të mos masakrohen publikisht. Ne duhet të kërkojmë përgjegjësi zinxhirore. Duhet të kërkojmë të dalin para drejtësisë secili person në hallkën e shtetit, qoftë prokuror, kryeprokuror, shef i policisë, mjek apo drejtor shkolle. Ndoshta duhet shikojmë mundësinë edhe të ndryshimit të Kodit Penal.

Ne pamë opinione dhe interpretime të ndryshme të Kodit Penal për vepra të tilla dhe t'ju them të drejtën, kur dëgjuam që dënimi maksimal për një vepër të tillë është 5 vjet, ishte tepër zhgënjyese. Ne duhet të shohim ta ndryshojmë Kodin Penal dhe të parashohim vendime maksimale për vepra të tilla kriminale, të cilat e shkatërrojnë jetën jo vetëm të viktimave, po edhe të familjarëve të tyre. Në këtë rast, jo vetëm te familjarët viktimë, por edhe të familjarëve të akuzuesve, sepse sot në gjendje aspak të mirë nuk gjenden as familja e policit e as familja e profesorit, të cilët gjithashtu i ka mbuluar turpi i prindërve të tyre. Dhunimi është vepër

kriminale edhe nëse kryhet ndaj ndonjë 18-20 apo 30-vjeçareje. Prandaj, debati duhet të orientohet te dënimi maksimal ndaj atyre që e kanë ndihmuar dhunimin.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Askush nuk mund të flasë për vajzën e dhunuar dhe të mos i shkojë mendja te fëmijët e vet. Te fëmijët tanë, te fëmija juaj, i cili po ashtu mund të jetë cak i një sulmi të tillë. Ne duhet t'i denoncojmë ata. Askush s' duhet të pësojë se po e lajmëron një vepër kaq të rëndë kriminale. Por, fatkeqësisht raste të tilla kanë ndodhur, ku ata që cilët kanë denoncuar, janë dënuar, ndërsa dhunuesit, kriminalët e të të korruptuarit janë liruar dhe janë promovuar, bile. Shteti duhet t'i fusë në mbrojtje secilin dëshmitar që zbardh raste të tilla. Dhe, ne sot si deputetë kemi për obligim që të dalim me rekomandime të tilla, që të ofrojmë mbrojtje maksimale edhe për viktimat, por edhe për dëshmitarët.

Pra, profesori, polici dhe mjeku nuk e kanë dhunuar vetëm një vajzë, ata e kanë dhunuar gjithë Kosovën, kanë dhunuar secilën familje shqiptare. Sot secili prej nesh, përveç me konstatime, duhet ofruar zgjidhje edhe për rastet e tjera si ai i 16-vjeçares, e ne të gjithë po e dimë që nuk është rast i izoluar. Zgjidhja është në duart tona, sepse neve na është besuar vendimmarrja edhe për raste të tilla. Ne si Kuvend i Kosovës, si institucioni më i lartë ligjvënës, duhet të kontrollojmë Qeverinë dhe performansën e saj, të institucioneve të saj. Ndërkohë, qytetarët me të vërtetë duhet të shohin kontributin e secilës parti politike dhe të secilit deputet në këtë sallë. Rasti i dhunimit unë kërkoj që të kalojë në kompetencë të Prokurorisë Speciale dhe të Krimeve të Rënda të Policisë së Kosovës. Duhet të shkohet deri në fund, duke i nxjerrë përgjegjësit para drejtësisë. Jo vetëm tre të dyshuarit, sa e kanë vvarë dhe e kanë dhunuar një të mitur.

Kërkoj nga Këshilli Prokurorial i Kosovës që me shpejtësi të nxjerrë para përgjegjësisë edhe penale prokuroren që e ka mbyllur rastin. Në momentin kur është mbyllur rasti, prokurorja është dashur, jo pas tërheqjes së deklaratave të të miturës, është dashur që ta zgjerojë bazën e hetimeve dhe jo ta mbyllë rastin, sepse është dashur shumë mirë ta dijë që ajo ndodhet në një shantazh tjetër dhe dikush po e detyron atë që ta tërheqë rastin. Duhet të nxirret para drejtësisë i gjithë zinxhiri komandues në policinë në Drenas dhe hallkat duhet të prekin edhe në qendër. Të kërkohet përgjegjësi nga drejtori i shkollës, pastaj përgjegjësi nga mjeku. Të gjithë mekanizmat e drejtësisë, policia, AKI-ja dhe institucionet e tjera duhet të merren me zbardhjen e këtyre rasteve.

Të nderuar kolegë deputetë,

Si deputete, përfaqësuese e qytetarëve dhe gjithashtu si nënë e dy vajzave ndjehem tepër e zhgënjyer që SBASHK-u edhe sot ende nuk ka dalë të distancohet prej një punëtori të arsimit. Ata ishin në gjendje të qëndrojnë tri javë në grevë dhe t'i lënë fëmijët pa mësim, mirëpo kur është fjala për raste të tilla, ata nuk i ndajnë pesë minuta, të dalin e të distancohen. Gjithashtu është dashur të reagojnë edhe partnerët e koalicionit, të cilët që tre muaj janë shtyrë se kush kujt po i rrit pagat. Ne duhet të kërkojmë përgjegjësi prej institucioneve edhe arsimore, edhe policisë,

sepse buxheti mbushet edhe me paratë e viktimës nga Drenasi, të cilët edhe pse nuk kishin asnjë të punësuar, për secilën blerje paguajnë tatim mbi vlerën e shtuar dhe mbushin buxhetin e Republikës së Kosovës, për të paguar të gjitha privilegjet në të gjitha institucionet publike. Faleminderit.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufëra Shinik.)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj, urdhëroni.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, e nderuara kryesuese e seancës!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Vërtet turp e trishtim për këtë realitet të dhimbshëm në vendin tonë. Ngjarja e abuzimit seksual me të miturën në Drenas ka tronditur gjithë opinionin e gjerë. Po as imagjinata nuk e akcepton një krim të tillë. Një krim i tillë mund të duket spontan, por pas ngjarjeve të tilla mund të shihen krime seksuale të mëparshme ose edhe premisa për krime të ardhshme. Kur një krim rezulton nga institucionet shtetërore, përkatësisht nga shtyllat kryesore të shtetit, siç është arsimi, pra nga edukimi që ne presim emancipim të shoqërisë dhe më tepër thellohet nga siguria, ku ne nga siguria presim një jetë më të mirë, më të sigurt dhe më të lirë me të drejta të barabarta dhe përfundon në shëndetësi, ku ne të gjithë presim një të ardhme më të mirë.

Këto raste, të cilat ndodhin, unë i quaj raste makabre, ku keqpërdoret detyra zyrtare e shkelje e ligjit dhe, mbi të gjitha shkelen normat morale e njerëzore. Besoj në institucionet kompetente do ta marrin me shumë përkushtim dhe detyrën e tyre do ta kryejnë me përgjegjësi të plotë. Të gjithë fajtorët e përfshirë në këtë akt makabër zinxhiror, duhet ta marrin dënimin e merituar. Apeloj, duke pasur parasysh që një mentalitet konservativ, një arsimim jociësor, një pozitë jo të barabartë të gruas dhe femrës në familje, kushtet ekonomike dhe sociale, të cilat janë në vendin tonë ndikojnë në një komunikim jo të drejtë dhe të mirëfilltë brenda familjes, që MASHT të marrë urgjentisht masa për të angazhuar bashkëpunëtorët profesionalë, si pedagogun, psikologun dhe sociologun në secilën shkollë. Po ashtu propozoj që të ketë vizita sistematike vjetore për punëtorët e çdo lëmi, ku hyjnë ekzaminimet fizike, psikike dhe ato emocionale. Po ashtu të bëhet edhe vlerësimi i performansës të secilit punëtor që punon në institucionet e Republikës së Kosovës. Andaj, besoj shumë në institucionet kompetente dhe besoj që këta njerëz monstrum që kanë bërë një akt të tillë dhe të tjerët që kanë bërë edhe më herët, të marrin dënimet e merituar nga institucionet kompetente. Faleminderit.

KRYESUESJA: Faleminderit deputete! Fjalën e ka deputetja Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Ky rast tejet tragjik ka sjellë në pah shumë probleme që kanë institucionet shtetërore, duke u nisur nga arsimi, policia dhe shëndetësia. Reagimi i opinionit publik ka qenë i njëzëshëm që të merren masa dhe të demaskohet ky sistem. Vajza e re është vrarë nga institucionet e arsimit, të policisë dhe shëndetësisë. Ky rast është vetëm një i shfaqur në publik. Përndryshe, çdo ditë në çdo kënd të Kosovës ne hasim abuzime dhe shkelje të dinjitetit të njeriut, qoftë në emër të funksionit, të meritave të lirisë, të vendit të punës, kudo, por një zgjidhje e institucionit e përfshirë si ky rast është shumë për t'u shqetësuar.

Institucionet janë formuar për t'i mbrojtur qytetarët, e jo për t'i keqpërdorur ata. Na vjen keq se institucionet tona janë kthyer në institucione të krimeve. Vendi ynë i ka plagët e hapura nga përdhunimet, të cilat i ka bërë armiku dhe lajme të tilla për ne janë shumë të rënda. Si mund t'i stimulojmë personat të marrin guxim e t'i paraqesin rastet kur institucionet tona nuk kanë siguri. Kush e ka dekoruar këtë polic? A duhet të japë përgjegjësi edhe ai që e ka dekoruar, hiç më larg se para një jave? Shtrohet pyetja: kush e ktheu në punë profesorin? Kush i merr këto vendime? A duhet të japë përgjegjësi ai gjykatës që e ka shpallur të pafajshëm këtë profesor? E mitura është deklaruar se e ka tërhequr rastin nga Prokuroria. A duhet të japë llogari dikush si ka mundësi që një prokuror të tërheqë denoncimin, duke e ditur se deklarata është dhënë nga një e mitur. Si është e mundur që mjeku të pranojë të bëjë abortin e një të miture e të mos japë përgjegjësi? Zinxhiri i krimeve institucionale vazhdon. Nuk jep përgjegjësi askush, sepse sistemi është i krijuar i tillë. Vendi ynë nga ky sistem po bëhet i pashpresë. Bile, shumë i frikshëm. Shkëlzen profesori, komandanti Veseli dhe Fehmi doktori kriminelë janë pasqyrë e kulturës që kultivojnë e manifestojnë për 20 vjet me radhë.

Dhe, kur u bë hataja e kur rasti ndodhi, turpi në sipërfaqe, atëherë kinse u surprizuan. Bëhen sikur po i ndëshkojnë, por a mund të ndëshkohet gjithë kjo prapështi, gjithë ky imoralitet e padrejtësi. Gjithë ajo injorancë e mbjellë, e sponsorizuar për këto dy dekada me radhë. Duke e partetizuar skajshmërisht sistemin shtetëror, shkollën, policinë, gjykatat., shëndetësinë, duke e vënë shtetin në shërbim të apetiteve të veta elektorale, duke e parë individin dhe familjen jo si qenie njerëzore, por si numër e votë, udhëheqësit e shtetit të Kosovës kanë shkatërruar çdo vlerë, çdo moral dhe çdo normalitet. Jemi shndërruar në një vend ku lartësohen idiotët, ku jepen diplomat fiktive, ku gradohen maniakët dhe ku shpërblehen dhunuesit. Është po kjo idiotësi e pushtetit që po e shkatërron shoqërinë tonë duke e shkatërruar bërthamën e saj që është familja. Familjet shqiptare të Kosovës u varfëruan skajshmërisht, duke u privuar nga e drejta për të punuar e për të krijuar mirëqenie në vendin e vet. Shumë familje shqiptare, të traumatizuara gjatë luftës, në vend se pas luftës t'u jepet përkrahje nga strukturat shtetërore, atyre u mbyllet çdo hapësirë për të parë atë dritën aq shumë të dashur të fund të tunelit.

Pyetje për secilin prej nesh: pse sot janë kaq të pasur idiotët, e të kundërtën, janë aq të varfër intelektualët? Sot nuk është përgjegjësia vetëm e mësuesit maniak, por në një shoqëri normale më së paku do të ndodhte urgjentisht dorëheqja e ministrit të Arsimit. Sot nuk është e mjaftueshme vetëm dënimi i komandantit Vesel, po dorëheqja e Veselëve të pushtetit. Nuk mjafton ndëshkimi i një doktori kriminel, pa ikur nga pushteti ata që po abortojnë çdo ditë shpresat e popullit. Është për të ardhur keq se si një kryetar i Partisë Demokratike dje i detyron mjekët në Prizren për të dëgjuar vizionin e tij, një vizion të cilin ai e ka paraqitur. Është fyerje e poshtërim për intelektualët kur i detyron të dëgjosh pallavrat e tij. Prandaj, edhe intelektualët sot po ikin nga shteti, të cilin e keni katandisur si mos më keq.

Që të mos ju rrinë më para gatitu injorancës dhe vizionit tuaj, ata mjaft ju pritën dy dekada. Nuk kanë më kohë t'ju presin asnjë minutë më shumë. Është koha të lëshoni rrugë. Mjaft shkaktuat kaos në këtë vend, mjaft i krijuat tortura këtij populli. Popullit i ka ardhur laku në fyt, e thika i ka depërtuar deri në asht. Është urgjente të largohet kjo Qeveri. Qytetarët duan të shikojnë botën e lirë, e ju shkoni ku të doni! Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Frashër Krasniqi. Regjia, të lutem, fjalën deputetit.

FRASHËR KRASNIQI: Të nderuar deputetë!

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Rastin e fundit të vajzës së përdhunuar nuk mund ta trajtojmë si rast të veçantë dhe të izoluar dhe të shkëputur nga pozita që grave u është lënë në shoqërinë tonë. Rastet e tilla nuk mund të parandalohen vetëm përmes efikasitetit policor, pa një ndërhyrje thelbësore në shtet dhe shoqëri, për zhdukjen e pabarazisë gjinore dhe për diskriminimin e grave. Për ta kuptuar se si mentaliteti shoqëror patriarkal është ai që prodhon raste të tilla, unë sot do të merrem vetëm me raportet gjinore në gjuhën, të cilën e përdorim, sepse në fund të fundit gjuha shpreh raportet e pushtetit në mes të dy gjinive. I forti e bën gjuhën për vete, duke e nënshtruar tjetrin. Ju e dini të gjithë që kur duam t'i them dikujt që është shumë i fortë, ne i themi “je burrë”. Njësoj kur duam t'i themi dikujt që është shumë i dobët, i themi “mos u sill si çikë”. Kur duam t'i themi dikujt që t'i e mban fjalën, i themi “ti je burrë i fjalës”, “ti e mban fjalën si burrat”, ndërsa kur dikush flet pa lidhje, edhe kryeparlamentari ynë i thotë “po flet si grua e keqe”. Kur një burrë kujdeset për fëmijët, i thonë “je bërë si grua”, a kur një grua ia lë burrit në kujdes fëmijët, konsiderohet që është e pandjeshme dhe është nënë e keqe. Kur një burrë abuzon, kjo quhet shkathtësi, a kur gruaja abuzohet, asaj i thonë që “ti s'ke moral, ti e ke lypur vetë, për këtë të kanë abuzuar”.

Edhe ato pak raste kur ne detyrohemi t'ia pranojmë një gruaje suksesin, a e dini se si e bëjmë këtë. E bëjmë duke i thënë “burrneshë”, sepse në thelb të këtij mentaliteti vetë sukcesi, forca, dija, guximi, sundimi janë të pashkëputshme nga fjala “burrë”. Prandaj, i vetmi shpjegim që

kemi për një grua të guximshme, të dijshme e të suksesshme, është që ajo e ka përvetësuar aftësinë e të qenit burrë, pra është bërë ‘burrneshë’.

Në rastin e fundi në Drenas, te viktimi i gjeni elementët kryesorë të pafuqisë, është vajzë dhe është e mitur. Në anën tjetër, i kemi format kryesore të pushtetit: mësuesi, polici, mjeku, njëri pas tjetrit. Dhunuesit janë burra me pushtet, viktimi është një vajzë e re që nuk ka asnjë mbrojtje ligjore dhe, për më tepër, e ka krejt moralin e shoqërisë mbi kokë. Dhuna shtetërore në këtë rast shfaqet e nyjzuar me mendësinë patriarkale. Morali apo normat shoqërore mbi seksin te ne janë të ndërtuara keq, mbi të lejueshmen dhe të palejueshmen. Morali publik mbi të papranueshmen që shpesh merr formën e skandalit, fatkeqësisht rrëmihet pikërisht nga praktikat e nëndheshme të cilave u mbyllet syri. Denoncimet nuk ndodhin shpesh dhe, edhe kur ndodhin nuk adresohen, sepse instancat ligjzbatuese janë përtpëse, por edhe përdoruese abuzive të këtij morali. Ajo, pra, që është e ndaluar publikisht, pikërisht për shkak që bëhet rrallë publike, shndërrohet në praktikë të shpeshtë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Rasti i një të miture, një vajze në Drenas na ka shqetësuar të gjithëve. Ky rast, i cili ishte lajmëruar për herë të parë në vitin 2016, pra ka mbetur i izoluar tre vjet. Pra, për tre vjet dhunë, abuzim me një vajzë, pa marrë parasysh nga vjen dhe ku jeton ajo. Ky rast, pra, doli në pah pas tre vjetësh funksionimi apo mosfunksionimi të hallkave, të cilat ish dashur që këtë rast ta ndriçonin qysh në fillim.

Pyetja ime është se një rast sikurse ka ndodhur në Drenas, kur dhe si mund ta lajmërojë një vajzë apo kushdo qoftë, se mund të jetë një djalë? Pra, në momentin që lajmërohet një e mitur, meqë në atë kohë, sa u tha, ka qenë rreth 16-vjeçare në 2016-ën, me kë ka qenë, si është lajmëruar, a ka qenë me prindërit, a ka qenë me punëtor social, a ka qenë me kujdestar?

Pra, nëse rasti është lajmëruar, si ka funksionuar, a është regjistruar si rast dhe pse është heshtur për kaq kohë? Pra, u deshën tre vjet për të dalë një rast në këtë kohë kur neve, si Komision për të Drejtat e Njeriut, kohë më parë, dy ditë më parë e kishim Komisionin Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës nga agresori serb.

Sigurisht që ishim shumë të shqetësuar për rastet e pakta që janë lajmëruar dhe që është ushtruar pra një dhunë seksuale në rreth 20 mijë viktimi të luftës së fundit në Kosovë nga pushtuesi serb.

Ishte një shqetësim, i cili vazhdon të mbetet shqetësim edhe sot e kësaj dite, dhe thërrasim vazhdimisht që t’i inkurajojmë të gjitha ato që kanë përjetuar dhunë që të lajmërohen.

Tani kemi një rast, i cili u lajmëruar, në fakt doli në pah, thashë pas tre vjetësh lajmërimi në institucione. Po, në vendin ku do të duhej të merrte dije, u abuzua me të, në shkollë. Në vendin ku do të duhej të ndihej e sigurt, u abuzua me të. Dhe, së fundmi, rasti te mjeku, pra, një abort i jashtëligjshëm.

Çfarë po bëjmë ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës? Pra, këto raste duhet të na bëjnë bashkë, sepse kurdo që kanë ndodhur dhe kurdo që mund të ndodhin edhe sot, kanë ndodhur edhe dje, edhe në institucione, janë lajmëruar edhe për abuzime nga abuzues të ndryshim në institucione, qoftë shkollore, publike apo private, po t'i inkurajojmë që të paraqiten, por ku të paraqiten dhe sa janë të sigurta që do të merren seriozisht.

Edhe një herë, çfarë kërkojmë ne, ose cili do të jetë përfundimi ynë, është që institucionet e drejtësisë të veprojnë shpejt, me efikasitet dhe jo me neglizhencë.

E dyta, të kërkojmë që të kemi pedagogë dhe psikologë në çdo shkollë. Sa do që numri i tyre është rritur në këtë qeverisje, mirëpo ne së bashku duhet të kërkojmë që gjithkund të kemi pedagogë dhe psikologë në shkolla, ngase rasti ka mundur të trajtohej edhe në shkollë. Edhe pse nuk e di nëse ka pasur pedagogë në shkollën në Drenas.

Megjithatë, ky rast duhet që të na bëjë bashkë edhe një herë dhe të thërrasim dhe të kërkojmë zbatim dhe vetëm zbatim të ligjeve në fuqi. Forcim të mekanizmave shtetërorë, sa do që të gjitha institucionet janë bërë bashkë sot, nga kryeministri për të thirrur edhe një herë në përgjegjësinë e secilit. Pra, llogaridhënia fatkeqësisht ka munguar dhe po mungon.

Duhet të dihet secili që ka përgjegjësinë të japë llogari për punën e vet.

Prandaj, ky debat i fundit, uroj që të jetë dhe të thërrasë në ndërgjegjen e secilit, por njëkohësisht të veprohet dhe të kërkohet se cilat ligje, veçse konkretisht sot të kërkojmë dhe të veprojmë, të punojmë ne si deputetë, se cilat ligje do t'i kërkonim në plotësim-ndryshim që do të rregullonim diçka.

Të mos mbetet vetëm një debat i thirrur sa për, të mos them tërheqje të vëmendjes ndoshta nga shumë tema të mëdha, por le t'i thërrasim edhe një herë ndërgjegjes që t'i motivojmë që të lajmërojnë për çfarëdo ngacmimi, kudo qoftë.

Dhe, këtë ta bëjnë jo vetëm të miturat, por cilado femër, por edhe mashkull, se mund të kemi edhe abuzime me gjininë tjetër. Pra, të lajmërojnë këto raste tek institucionet dhe i thërras që t'i thërrasin përgjegjësisë, sepse në numrat siç na është thënë në një organizatë dje gjatë monitorimit të Ligjit për Barazi Gjinore, që numrat të cilët janë për t'u lajmëruar rastet, nuk po funksionojnë si duhet.

Pra, mund të mos jenë funksional në një kohë kur njeriu ka nevojë, ose një vajzë ose kushdo që ka nevojë ta lajmërojë një rast.

Pra, të forcohen mekanizmat dhe të dalim me hapa konkretë se cilat ligje dhe cilat nene konkrete do të duhej t'i ndryshonim, në mënyrë që të kemi forcim të mekanizmave në Kosovë.

Edhe një herë, le të na shërbejnë rastet e tilla që t'i thërrasim ndërgjegjes secili që t'i motivojmë këto raste që të paraqiten, por njëkohësisht edhe të mos i gjykojmë si një vajzë apo si një familje, por edhe një herë, pra, veprim dhe të ligjeve në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Duda Balje, urdhëroni!

DUDA BALJE: Zahvaljujem podpredniće!

Poštovani poslanici,

Poštovani ministre,

Ja samo mogu da podvučem sve ove što su moje kolege ovo rekli do sada i nadam se da će svi oni koje su do sada radi ovako zločine platiti za ono što su radili. Nažalost moram da konstatujemo da se takvi slučajevi dešavali da možda danas ili juče, imamo slučajevu koji se i danas dešavaju.

Da imamo slučajevu koji se vjerovatno dešavati ali sada smo bez obzira što je sistem zakazao do sada, sada smo možda u nekom momentu kada trebamo da stavimo tačko na sve ovo, da svi oni koji su radili ovo zločine da budu pravedno kažnjeni i da se ovakve zločine sve manja dešavaju.

Po prvo, sada ovaj pročitali na društveno mrežama da je policajac prihvatio ovaj, priznao krivicu, i naravno da je priznao i naravno da je uradio taj zločin, i naravno da će platiti za to što uradio.

Pitanje kako će on žive ti dalje s tim, ali pitanje kako će devojčica od 16 godina, koja sad već ima 18, nastaviti da živi s tim.

Hoću da kažem, gledali smo takođe sad na mrežama i proteste koje se su održali u Drenasu, ne mi smo bili da podržimo mlade djevojke, juče na protestu, da danas nemamo seansu vjerovatno bih danas bili na protestu i gledali smo kako se gerli sa policajcima, to je bio jedan vrlo emotivni momenat, i ja prepun toga hoću da kažem da bez obzira što jedan policajac uradio onu što uradio. Kosovska policija je vrlo značena za nas, za našu državu i ja hoću da vjerujem i vjerujem da u Kosovsku policiju postoji ljudi koji zaslužuju ta mesti i postoji ljudi koji bih dan danas dali život za obu dračavu, a ne za nekog pojedince ali za neko maloljetnicu.

Znači znam da prolaze koje teške momente isto se to radi i za profesore, učitelje, apsolutno sam sigurno da jedan od profesora koji je radio ovakav zločin ne znači da svi krivi i ovom momentu i

u ovim danima oni polazi kroz neke teške kritike i medije i mi svismo dali kritike na njihov račun, ali sam apsolutno sigurna da veoma veliki broj, veoma, veoma veliki broj njih osudio ovoj zločin koje si desio.

Naravno ne mogu da napomenimo i ginekologa koje ovaj uradio to što uradio bez obzira na Hipokratovo zakletvu i sve ona zašta je bio zadužen da poštuje jedno ljudsko telu, odnosno ljudske telu jedne male devojčice. Mislim sam da se to je apsolutno kriminal i ovoj vrste zločina u stvari samo su nam dokazali da zločin u suštini pored onog seksualno, može da bude i institucionalan.

Slažem se svim kolegama za preporuke koje trebamo da donesimo, možda ona prvo što dolazi ispred nas jeste zakonu o zaštiti de teta koga smo ovaj glasili u prvom čitanju, sada je kod nasto stolu da se on doradi i sve ono, ja znam on će de prođi kroz Komisiji za Ljudska Prava i apsolutno sam se sigurno da svi članovi te Komisije zajedno sa mnom ćemo raditi sve da to bude nekako prvi korak u kome možemo da zaštitimo ovaj maloljetnu decu, bez obzira na pol, dali muške ali ženska.

To će se dosjeti upravo ovog meseca, apsolutno sam sigurno, naravno i sve kolege dati svoje doprinos da taj zakon bude neka prva karika u celom onom plan koje imamo da zaštitimo decu od danas po nadalje.

Obraćam se svim onima koji su radili ovaj zločin u ovom momentu i koji će raditi ovoj zločini, koji misle da rado ovakav zločin nadalje, juče smo spomenuli da tu, javnulo se na nam od juče veoma veliki broj slučaje, javilo se jedna devojčice iz romske zajednice koja isto pretrpale vrlo sličan zločin. Devojčice iz Peć, Bošnjakinja koje takođe u strane profesora ili ti danas aktualnog ljekara prošla kroz isti ovakav zločin.

Svi su ovu slućeni koje se nalaze ovoj u sudu i apsolutno hoću da vjerujem da sudski sistem Kosova može da se izbori sa ovom, daće pokazati daj zakon najvažnija, da neće prosuđivati ponićemo i da će apsolutno pokazati šta će kriminalci koje se vršilo ovakav zločin od danas pa nadalje i način koje će biti kažnjeni. Hvala vam puno!

KRYESUESJA: Fjalën e ka deputeti Imet Rrahmani, urdhëroni!

IMET RRAHMANI: Faleminderit e nderuar kryesuese!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ngjarja e fundit që ndodhi është një pasqyrim i rrethanave të krijuara në vendin tonë dhe shpërfaqje e krizës së madhe morale të shoqërisë.

Këto ngjarje edhe një herë treguan se ne assesi nuk po arrijmë të krijojmë sistem të sigurt dhe të besueshëm për të gjithë. Kemi dështuar në ndërtimin e një sistemi shtetëror, i cili do të ishte i barabartë dhe i cili do të ofronte mbrojtje dhe siguri për qytetarët.

Institucionet po tregohen të brishta. Veprimet në shikim të parë duken të rrepta, por në esencë janë sipërfaqësore dhe tejet selektive në raport me rrethanat dhe veprat e caktuara për individë dhe grupe të caktuara.

Edhe pse nuk është rastësi, ngjarja e fundit duke e shpërfaqur krimin që ndërlidh tri institucione; arsimin, policinë dhe shëndetësinë, tregon se faji i të gjithëve, pa dallim, por kupolën e ka te sistemi i drejtësisë. E drejtësia që për mua nuk është vetëm prokuroria dhe gjyqësia, ka dështuar edhe në nivele të tjera.

Padrejtësia ka zanafillën te qasja ndaj të padrejtës, ndaj keqpërdorimit, mosveprimit dhe miratimit në heshtje të abuzimit me të mirat dhe mundësitë që ofron jeta dhe të jetuarit në liri.

Për mua është e kuptueshme se gjithmonë në shoqëri ka mundësi të paraqiten veprime të jashtëligjshme, sikurse ka ndodhur në shkollë. Por, nuk është hiç e kuptueshme si pati mundësi, rastësisht, vepra e jashtëligjshme të mos denoncohet dhe luftohet nga të tjerët, pasuesit në hetuesi dhe në prokurori.

Për mua, zonja dhe zotërinj, kjo nuk është rastësi. Kjo është shpërfaqja e qasjes sonë ndaj ligjit. Kjo situatë është shpërfaqja e qasjes sonë me vite karshi nevojës së ndërtimit të institucioneve kredibile dhe të besueshme.

Kjo situatë është pasqyrim i dorëzimit të të mirëve karshi të këqijve.

Ata që dje vepruan keq, ata që dje nuk u denoncuan dhe nuk u parandaluan për ta bërë krimin, ata që dje ndihmuan të parin nuk janë të vetëm, ka shumë. Sikur të mos ishin shumë, s'ka mundësi që nga rastësia të ishte lidhje zinxhimore.

Edhe pse janë shumë, unë jam i bindur se prapë këta shkelës të ligjeve paraqesin pakicë absolute në mesin e mësuesve të ndershëm dhe me integritet. Paraqesin pakicë absolute në mesin e policëve shumë profesionalë dhe me autoritet. Gjithashtu, paraqesin pakicë në mesin e mjekëve, humanistë dhe vetëmohues.

Por, unë kam dilema se në cilat nivele është sistemi arsimor. A është komplet i dorëzuar? Ku është SBASHK-u? Si do të trajtohet kjo ngjarje brenda dhe cili do të jetë reflektimi?

Institucionet arsimore, bashkë me SBASHK-un, i cili di të bëjë shpesh greva vetëm për paga dhe mirëqenie materiale, bashkë me Qeverinë, me nxënës e prind duhet të protestojnë dhe të zotohen për përkushtim më të madh ndaj fëmijëve dhe për ruajtjen a autoritetit të mësuesit.

Dukuritë abuzive janë të formave të ndryshme, ndërkaq kjo e fundit është kulmi.

Unë kam dilema sesi do të adresohen këto çështje brenda vetë policisë dhe brenda vet shëndetësisë. Ideja është si të parandalohen dhe si të denoncohen me kohë punët e këqija.

E di që ata që po na dëgjojnë, edhe mund të shtrojnë pyetjen; e ku t'i denoncojmë? Kanë të drejtë kur heshtin, sepse ka humbur besimi në institucionet e drejtësisë, institucionet që do të duhej ta ndalnin, të akuzonin dhe ta dënonin krimin.

I kemi rastet e ditura. Shumë kohë më parë u vodh Dhoma e dëshmia. U zunë në flagrancë familjarë të personaliteteve me përgjegjësi të larta institucionale dhe asnjë veprim nuk u ndërmor ndaj tyre.

Asgjësohen provat materiale ende pa u hapur procesi gjyqësor. Ka regjione, po e përsëris, jo komuna, po regjione, që për 15 vjet kurrë Inspektorati Shëndetësor dhe Farmaceutik nuk ka bërë inspektime. Prandaj, ka edhe ordianca të palicencuara, sepse kur nuk guxon ta ndëshkosh njërin, duhet bërë tolerim te tjetri.

Dizajnohen procese gjyqësore ashtu që kurrë të mos u vijë fund. Ashtu që kurrë të mos ndëshkohen ata që bërë krimin. Për shembull, rasti 'stenda'. As nuk dënohen ata që vërtet e meritojnë, e ka shumë të tillë, dhe as nuk lirohen ata të tjerët që aty kanë hyrë padrejtësisht dhe janë të pafajshëm.

Kjo bëhet që ata të fajshmit që kanë lidhje të mos dënohen dhe ata të pafajshmit të shantazhohen në çfarëdo kohe kur dikujt i duhet.

Kapen nga menaxhmenti në institucionet shëndetësore përgjegjësit e njësive duke abuzuar me barna, denoncohen dhe i kthen Inspektorati i Punës, i kthen gjykata. Bile ka raste kur me vendim të gjykatës institucionet shëndetësore detyrohen t'ia kthejnë barnat atij që ka abuzuar me to brenda institucionit shëndetësor.

Kemi me dhjetëra raste të proceseve ndaj zyrtarëve të lartë shtetërorë që kanë përfunduar me kthim në punë dhe pagesa retroaktive. Nga krejt kjo, dua të ritheksoj se fajtorë jemi të gjithë për situatën ku jemi, por mbi të gjitha kemi dështuar në ngritjen e sistemit efikas dhe të besueshëm të drejtësisë.

Kemi dështuar në luftimin e së keqes brenda institucioneve ku veprojmë dhe punojmë. Nuk është kuptuar me kohë se dëmi do të jetë shumë më i madh kur janë mbushur institucionet me militantë partiakë, familjarë e bashkëpunëtorë të dikurshëm, pa kompetencë profesionale dhe intelektuale, sesa sikur të kishim humbur ndonjë votë, ndonjë përkrahje a ndonjë mik.

Që të mos e zgjas më shumë, dua ta mbyll me apelin që prokuroria dhe gjykatat t'i arsyetojnë pagat dhe ta kthejnë besimin te qytetari. Pa kthimin e besimit, se e keqja nëse denoncohet dhe paraqitet do ta marrë dënimin e merituar, nuk ka dalje nga vorbull i vetëshkatërrimit.

Uroj që ky debat i shkaktuar nga kjo ngjarje shumë tragjike dhe e dhembshme të mos përfundojë në momentin e votimit të një rezolute, po kjo shoqëri ta marrë seriozisht këtë problematikë, e cila fatkeqësisht na ndodhi pas një fatkeqësie. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj, urdhëroni!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetare!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të filloj diskutimin tim, dua t'i them Drita Millakut se paranojat e saj në raport me kryetarin e Kuvendit janë jashtë çdo realiteti në të cilin po jetojmë.

Vlerat atdhetare, kombëtare të kryetarit të Kuvendit, zotit Kadri Veseli, janë larg nga vlerat e gjithfarë njeriu që abuzon me fjalën e lirë në këtë Kuvend. Se kush do të lëshojë rrugë, e vendos qytetari i këtij vendi dhe jo ti, zonjë e nderuar.

Është ai sovrani popull që u ka treguar vendin juve. Vështirë e keni të vini në pushtet, sepse që të vihet në pushtet, duhet të bëhet punë e jo demagogji, insinuata e akuza pa kurrfarë baze.

Millakët, të më falin Millakët e ndërgjegjshëm e me vlera, se po flas për Millakët e UDB-së, të cilët në vitin 1981 kanë dhunuar e dënuar bashkë me pushtuesit qytetarët e këtij vendi, dhe ende sot e kësaj dite nuk kanë dhënë përgjegjësi për bëmat e veta në një kohë shumë kritike në të cilin ndodheshim si popull.

As ky Kuvend, ende sot e kësaj dite, nuk ka folur, nuk ka debatuar dhe nuk ka marrë ndonjë vendim në raport me këto krime të cilat janë bërë në vitin 1981. Prandaj, i thërras ndërgjegjes së pastër të këtij Kuvendi që t'i hapim të gjitha çështjet të cilat kanë ndodhur në një periudhë kohore.

Zonjë e nderuar,

Askush nuk i ka detyruar mjekët që ta dëgjojnë kryetarin e Kuvendit, sepse kryetari i Kuvendit ka dalë krenar para profesionistëve shëndetësorë, ngase jo vetëm në këtë vit, por që nga momenti kur është bërë kryetar i Kuvendit ka punuar me seriozitetin më të madh që profesionistët shëndetësorë të shpërblehen për punën dhe mundin të cilin e bëjnë. Të shpërblehen për profesionalizimin të cilin e kanë.

Jam e lumtur që ka arritur ta realizojë projektin e tij për shëndetësi.

Të nderuar deputetë,

Rasti të cilin sot po e diskutojmë është i rëndë. Duhet të bëhet shumë punë nga ana e institucioneve përgjegjëse që rastet e tilla të jenë të izoluara dhe të mos ndodhin në vendin tonë.

Dhuna seksuale është problem serioz që atakon njerëz nga e gjithë bota, si pasojë e shumë faktorëve, e sidomos atyre ekonomikë e socialë, por në rastin konkret që ka ndodhur në Drenas, problemi është edhe më i thellë, sepse është dhunuar një e mitur, një adoleshente nga dy persona kyçë institucionalë, mësuesi dhe polici, të cilët kanë rolin e edukimit dhe të mbrojtjes së fëmijëve.

Realisht kjo është një problematikë shqetësuese, e patolerueshme dhe duhet të ketë një reagim të shpejtë institucional që e dëmtuara të ketë rehabilitim dhe mbrojtje, kurse për palët që e kanë kryer këtë vepër makabre të dënohen dhe vërtet të dënohen ashtu siç e meritojnë, e jo rasti të përfundojë me marrëveshje mes palëve që të duhet ta ndajnë drejtësinë.

Përndryshe, rastet e tilla i vënë në panik shumë familje, të cilat i kanë fëmijët në shkollë, kurse humbja e besimit në mësuesin dhe policin shkakton shqetësim, pasiguri, frikë.

Të nderuar deputetë,

Drejtësia është vënë si prioritet i Qeverisë dhe i programit të saj qeverisës. Janë bërë hapa pozitivë që prioritetet që kanë të bëjnë me sigurinë të materializohen përmes buxhetit.

Është investuar në prokurorë e gjykatës me bindjen se përkushtimi i tyre në mbrojtje të ligjit e fuqizon shtetin tonë. Por, asnjëherë nuk jemi marrë me performansën e këtyre prokurorëve e gjyqtarëve që mbajnë të fuqishëm ligjin në vendin tonë.

Tri shtyllat e shtetit; legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësia janë të ndërlidhura mes vete, por edhe ruajnë pavarësinë e tyre. Qasja e prokurorëve dhe vendimet e gjykatave janë vërtet shqetësuese.

Si ka mundësi që një prokuror ta mbyllë rastin e mësuesit që dhunon nxënësen? Kush duhet të japë përgjegjësi këtu? Kush mund ta qartësojë këtë çështje? Kjo është e rëndë dhe ia zë frymën demokracisë e shtetit ligjor.

Kush mund të na shpjegojë neve këtu se si u mbyll rasti i Donjeta Pajazitit nga Strellci i Deçanit, e cila u rrëmbye në derë të shtëpisë dhe u vra në mënyrën më të keqe nga një njeri, i cili sot gëzon lirinë.

E kam thënë edhe një herë në këtë Kuvend e po përsëris prapë; Donjetën e kam njohur. Ishte një vajzë me plot vlera. Ajo kishte një ëndërr që ta përfundonte shkollën e ta forconte ekonomikisht familjen. Pikërisht kur po jetësonte ëndrrën e saj, ajo u vra padrejtësisht. Ku është drejtësia në këtë rast? Hipokrizi, i akuzuari dënohet për armëmbajtje pa leje.

Të nderuar deputetë,

Sa më shpejt duhet të ngritët niveli i përgjegjësisë në të gjithë mekanizmat e shtetit. Institucionet, e sidomos ato që kanë të bëjnë me drejtësinë, duhet ta kenë përgjegjësinë e respektimit të ligjit, të rregullave etike e të mirësjelljes.

Mendoj që përgjegjshmëria duhet të fillojë nga ne deputetët në paraqitjet tona publike, por edhe në qasjen tonë ndaj problemeve me të cilat po përballen qytetarët tanë.

Ne duhet të jemi shembull për objektivitet në vendimmarrje krahas çështjeve nacionale si; dialogu, kufiri e të tjera, të cilat po bëhen kauza për interesa partiake e aspak për interesa të vendit. Pra, t'u qasemi me më seriozitet problemeve me të cilat përballen qytetarët tanë.

T'i qasemi më me seriozitet punës në vendimmarrjen ligjore si dhe t'i analizojmë veprimet e çdo institucioni publik, e në veçanti të atyre arsimore, shëndetësore, në sigurinë publike e në sistemin e drejtësisë.

Nuk duhet të lejojmë që keqbërësit, dhunuesit, hajnat, grabitësit e lidhur me individë të caktuar në gjyqësi të shqetësojnë e të rrezikojnë qytetarët tanë e ta kenë komoditetin e jetës në liri.

Nuk duhet të lejojmë që grupe të caktuara të interesit t'i pengojnë zyrtarët në kryerjen e detyrave të veta ligjore, nëpërmjet formave të ndryshme të presionit e deri në futjen e tyre në zinxhirin e veprimeve të paligjshme. Qytetarët tanë kanë pësuar shumë gjyqe të njëanshme e selektive në të kaluarën. Ky vend ka nevojë për drejtësi, për gjyqësi efektive dhe efikase që të dënojë veprimet që bien ndesh me ligjin, po edhe të ndikojë në parandalimin e dukurive negative.

Policia duhet të jetë e pakompromis në ndalimin e personave delikuentë dhe në sigurimin e fakteve për rastet e kundërligjshme, kur ka fakte gjyqësia duhet të veprojë, e jo t'i lirojë këta persona apo t'u shqiptojë dënime qesharake.

Një hajn që këto ditë është në burg për vjedhje, grabitje, në komunën e Deçanit, në Gjermani është dënuar 15 vjet për katër vepra hajni të verifikuara. Të shohim se sa po dënohet në gjykata tona për 20 vepra të verifikuara të hajnisë.

Të nderuar deputetë,
Nga të gjitha veprimet keqbërëse, me e rënda është abuzimi me fëmijë.

Në fund të diskutimit tim, po jap disa rekomandime:

Qeveria të krijojë mundësinë që çdo shkollë të ketë psikolog e të ekzistojë ndërlidhja prindër-mësues-psikolog-polici, për të ndaluar ngjarje të tilla.

Të edukohen adoleshentët që të mbrojnë veten nga rreziqe që u kanosen, kur rasti ndodh, nuk kanë më vlerë veprimet e bëra, ngase viktimat mund të njollosen nga ana e familjes, shokëve dhe rrethit më të gjerë.

Çdo person që kryen veprime të tilla, t'i vërtetohet fajësia për veprimin e bërë. Të mos lejohet që individët në fuqi ekonomike a politike të mbulojnë raste të tilla, siç është rasti që po diskutojmë dhe shumë raste të tjera.

Kur objekt hetimi janë të afërmit me gjyqësinë, dihet që nuk do të dënohen. Ne që po shkojmë drejt integritetit, duhet të ngremë përgjegjshmërinë, efikasitetin, por edhe guximin në raport me raste të natyrës së tillë.

T'u ndalohet punësimi në institucione publike në çfarëdo niveli atyre që abuzojnë me rininë.

Ministria e Punëve të Brendshme duhet t'i kryejë obligimet e veta ligjore në krijimin e politikave në përcaktimin e programeve trajnuese.

Bashkëpunimi i organizatave ndërkombëtare dhe vendore me policinë, në emër të trajnimeve të mos bëhet direkt, po nëpërmes Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Të rishikohet mundësia e ristrukturimit të policisë sipas modeleve të rajonit, që oficerët policorë të lëvizin në komuna të tjera dhe jo në komunën ku ata banojnë.

Prokuroria e shtetit të veprojë më me përgjegjshmëri dhe të përcjellë deri në fund rastet kur policia ngrit kallëzim penal dhe jo e kundërta.

Mosefikasiteti në gjyqësi krijon vështirësi, besa edhe konfuzion e rrezikshmëri në punën e oficerëve policorë.

Ne e kemi një rini të shëndoshë dhe nëse nuk i ruajmë të rinjtë tanë dhe nuk veprojmë në parandalimin e dukurive negative, nesër do të bartim përgjegjësi: mosveprimi institucional shkatërron shoqërinë.

Ne si Kuvend duhet të japim kontributin tonë në forcimin e ligjit bazuar në rrethanat që po jetojmë. Çdo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Arbër Rexhaj, nuk është prezent. Tani fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi, urdhëroni!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesuese!

Përshëndetje për të pranishmit,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në këtë rast, përveç rastit për të cilën është thirrur seanca e Kuvendit, konsideroj se duhet të debatojmë për dukurinë e ngacmimeve seksuale dhe të dhunës që po ndodhë në Kosovë viteve të fundit, sepse nëse diskutojmë vetëm për rastin e fundit, krijohet përshtypje se ky është një rast i izoluar dhe raste të tilla nuk kemi pasur në këtë vend, e kjo nuk është e vërtetë.

Në Kosovë, si çdo kund tjetër, ka individë të sëmurë e të pamoralshëm që ngacmojnë e dhunojnë, por në Kosovë, si askund tjetër, institucionet e shtetit janë indiferente ndaj rasteve të tilla.

Për t'i zvogëluar rastet e këtilla ne si Kuvend duhet të kërkojmë evidencë për rastet e ngacmimeve seksuale dhe dhunimeve që janë evidentuar ose raportuar në Polici, në institucione shëndetësore, në prokurori, në gjyqësi dhe pastaj të kërkojmë raporte nga të njëjtit se si kanë përfunduar këto raste, gjegjësisht sa nga këto raste kanë përfunduar me dënim të dhunuesve.

Unë personalisht jam dëshmitar i një rasti të dhunimi para nja 10 vjetëve në Gjilan, dhunimi ka ndodhur në shkollë, ditën dhe ka ndodhur nga dy punëtorë të arsimit, udhëheqës të shkollave. Për rastin ka pasur mbi 100 dëshmitarë okularë, kanë qenë të njoftuar policia, në spital unë personalisht i kam vizituar të dhunuarat, rasti ka shkuar në prokurori, edhe në gjykatë dhe gjykata, pas zvarritjeve të gjata, dhunuesit i ka shpallur të pafajshëm dhe të njëjtit janë kthyer në proces mësimor.

Raste të këtilla në Kosovë ka shumë, sepse vetë i kemi dëgjuar. Kemi plot raste kur, për shembull, prostitucioni që në Kosovës është i pakontrolluar, por edhe nuk është formalisht i legalizuar, legalizimi është bërë në heshtje. Atje ndonjëherë edhe shkojnë policia, në këto shtëpi publike, kapin shpesh edhe vajza të moshës jomadhore dhe në rastin më të mirë, nëse ato janë

shtetase të ndonjë shteti tjetër, i dëbojnë nga vendi, po më tepër nuk kam dëgjuar që ka ndodhur diçka dhe deri tash asnjëherë nuk kam dëgjuar që një dhunues, kushdo qoftë ai, është dënuar me burgim ashtu siç e meriton, përveç ndonjë suspendimi të përkohshëm për veprat që i ka bërë.

Prandaj, unë e di që dikush edhe do të më akuzojë se po ndërhyj në sferën e gjyqësisë, po unë mendoj se gjyqtarët, prokurorët dhe të gjithë ne jemi të pavarur vetëm aq sa nuk e cenojmë ligjin, vetëm aq sa punojmë në kuadër të ligjit dhe për të gjitha veprimet që janë jashtëligjore, edhe për mosveprimet tona duhet të përgjigjemi, pavarësisht se mund të fshihemi pas një farë pavarësie që shumë keqpërdoret.

Deri në kohën kur institucionet tona do të funksionojnë ashtu si duhet, bazuar në kompetencat e tyre, në përgjegjësitë e tyre, bazuar në atë për çka edhe paguhen, unë i ftoj qytetarët e Kosovës që për raste të këtilla të jenë aktivë dhe të reagojnë ashpër.

Ndonjëherë edhe nuk më habit rasti kur institucionet dështojnë, por shpesh më habitin familjarët, prindërit që, për shembull, një mësuesi dhunues, pasi ta kenë liruar gjykata, ata shkojnë edhe ia besojnë fëmijën e tyre, vajzat e tyre, të njëjtit, që t'i japin mundësi që këto vepra edhe të përsëriten.

Prandaj, mendoj që, meqë këtu e paskemi vetëm ministrin e Punëve të Brendshme, është detyrë urgjente e kësaj ministrie, bashkë me Ministrinë e Drejtësisë që të fillojë dhe t'i hulumtojë rastet dhe policët indiferentë, gjykatësit indiferentë dhe prokurorët indiferentë të nxirren para gjyqësisë për moskryerjen e detyrave të tyre, që ndikon edhe në rritjen e rasteve të këtilla, për të cilat ne sot jemi tubuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Faton Topalli, urdhëro!

FATON TOPALLI: Faleminderit!

E nderuara drejtuese e Kuvendit,

I nderuar ministër i Punëve të Brendshme,

Ju përgëzoj që jeni sot këtu me ne dhe, natyrisht që do të dëshiroja që sot të ishte edhe ministri i Arsimit, ministri i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Social, e kështu me radhë.

Është jashtëzakonisht mirë që Kuvendi i Republikës së Kosovës thirri këtë seancë të jashtëzakonshme për të trajtuar njërin prej abuzimeve më të rënda të bërë publike karshi një vajze të mitur, i cili preku, si rast, çdo qytetar të Republikës së Kosovës, mlllefosi çdo njeri dhe shtroi pyetjen për secilin prej nesh: çfarë bën për të parandaluar raste të tilla? Cilat janë përgjegjësitë e Ministrisë së Arsimit, cilat janë përgjegjësitë e Drejtorisë në nivelin komunal, cilat janë përgjegjësitë e drejtorit të shkollës dhe njësoj kështu, pastaj edhe në Polici, edhe në shëndetësi dhe në mirëqenien sociale.

Natyrishit që nga përgjegjësia e tij nuk përjashtohet as Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe kjo përgjegjësi vjen nga roli i tij si organ më i lartë ligjvënës, por edhe organ kontrollues mbi institucionet e Kosovës, filluar prej Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, e deri te Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

Është mirë që Kuvendi i Kosovës ka ngritur sot këtë çështje, është mirë që Kuvendi i Kosovës sot unanimisht po i thotë jo dhunës, jo abuzimit seksual, jo keqpërdorimit të fëmijëve, jo padrejtësive.

Por është shumë keq nëse ky Kuvend dhe kjo mbledhje sot kthehet në një arenë kritikash, akuzash dhe kundërakuzash, klithjesh dhe sharjesh, sepse kjo nuk i ndihmon aspak qëllimit për të cilën është thirrur kjo mbledhje.

I dëgjova me vëmendje diskutimeve e deputetëve dhe deputeteve për këtë rast dhe mendoj që të gjithë pajtohemi në vlerësimin e rastit të dhunës. Por sot u fol më pak për përgjegjësitë e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Është fakt që ne kemi miratuar një varg ligjesh e konventash ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Por, Kuvendi ka edhe rol monitorues.

Në këtë kuptim, karshi përgjegjësisë që mbajnë institucionet konkrete, nuk mbetet pa përgjegjësi as deputeti, as deputetja, as Kuvendi si tërësi. Për ne shtrohet pyetja çfarë kemi bërë ne si Kuvend për monitorimin e ligjeve që mbrojnë të drejtat e fëmijëve?

Sa jemi angazhuar si deputetë, si institucione, që të sigurojmë mjetet e nevojshme që çështja e të drejtave të fëmijëve, çështja e barazisë gjinore, të trajtohen më me dinjitet e më shumë përkushtim nga institucionet, të cilat janë të thirrura për ta bërë këtë çështje?

Që kjo situatë të ndryshojë, duhet bërë veprime konkrete ndërinstitucionale.

Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Punëve të Brendshme duhet të kenë një analizë të përbashkët për gjendjen ekzistuese dhe t'ia paraqesin Kuvendit, duke treguar që çfarë është bërë deti tani dhe çfarë planifikohet të bëhet në të ardhmen.

Të gjitha ministrat e përmendura duhet t'i sensibilizojnë të gjithë punonjësit nëpërmjet programeve konkrete sensibilizuese për të drejtat e fëmijëve dhe rreziqet e mundësisë të shkeljes së tyre.

Të gjitha ministrinë, secila në fushën e vet, duhet të kenë plane, pra, skenarë konkretë të veprimit në rastet e abuzimit, çfarëdo qofshin ato, seksuale, të dhunës fizike, të dhunës psikike apo çfarëdo qofshin ato.

Në vendet e zhvilluara, në vendet që kanë përvojë në këtë drejtim, gjithmonë kur paraqitet një rast i tillë informohet drejtori i shkollës, punëtori social, psikologu, policia, familja dhe të gjithë së bashku pastaj e trajtojnë rastin.

Karshi këtyre duhet të sigurohen mjete të nevojshme buxhetore për institucionet, mediat e organizatat qeveritare dhe joqeveritare për programet sensibilizuese për të drejtat e fëmijëve, për rreziqet e abuzimit me këto të drejta.

Ka disa vende, si për shembull, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur dikush kërkon punë në institucione, është e domosdoshme të mbahet një ligjëratë dy orësh apo dy orë e gjysmë për t'i sensibilizuar për të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe të drejtat e fëmijëve dhe rreziqet që dalin për të abuzuar fëmijët, gratë, e kështu me radhë.

Ajo që është shumë e dhimbshme në gjithë këtë histori është që na dështuan të gjitha institucionet e thirrura për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Dështoi shkolla, dështoi policia, dështoi mjekësia, dështuan institucionet për mbrojtjen e të drejtave sociale, pra qendrat sociale.

Kjo, të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë, nuk guxon të përsëritet, të gjithë ne, secili në mënyrën e tij, ka përgjegjësinë e vet për këto çfarë po ndodh te ne, me abuzimet e fëmijëve, me të drejtat e fëmijëve dhe me barazinë gjinore. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Drita Millaku, nëse ta ka përmendur emrin për replikë. Urdhëroni, dy minuta i keni!

DRITA MILLAKU: Faleminderit, nënkryetare!

Desha t'i përgjigjem zonjës Hadërgjonaj, kur nuk ju pëlqen një realitet i hidhur, të cilën e kemi thënë, ju i etiketoni njerëzit. Merru me rastin, zonja Hadërgjonaj, e mos u merr me individë, sepse për ata të cilët po flisni ju, janë njerëzit tuaj, të cilët i keni avancuar, e prandaj kështu e kemi këtë sistem qysh e kemi të drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Kundër-replikë zonja Safete Hadërgjonaj, urdhëroni!

SAFETE HADËRGJONAJ: E nderuara zonjë, që s'po dua ta përmend emrin, ty dhe të tjerët si ti i pengon veprimtaria atdhetare për liri dhe pavarësinë e këtij vendi dhe puna e njerëzve në fuqizimin e shtetit.

Zonja e nderuar ta pastrojë origjinën e familjes së vet, e pastaj të flasë për njerëzit e ndershëm të këtij vendi, për atdhetarët e këtij vendi.

Jepja dënimit e merituar udha-shëve të familjes tënde që kanë dhunua e dënuar popullin e Kosovës në kohët më të vështira të historisë së kombit tonë në vitet 1981. Kur t'i dënoni këta, ejani dhe flisni për çështje të tjera!

Një parti, e cila shkel për çdo ditë ligjin, nuk ka çka të flasë për ligjet e këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, urdhëroni, zonja Besa!

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jemi mbledhur të debatojmë vërtet për një pikë shumë të rëndësishme, jo si rast, por fatkeqësisht si dukuri në Republikën e Kosovës.

Nga njoftimet dhe raportimet publike, rastet e dhunimeve dhe abuzimeve seksuale të miturit dhe të vajzat e gratë brenda institucioneve të Kosovës nuk janë më të izoluara. Këto raste tashmë janë kthyer në fenomen. Mbrojtja, integriteti fizik dhe moral i të miturve, vajzave dhe grave është përgjegjësi ligjore, prej ministrive të linjës deri tek agjencitë ligjzbatuese që mbikëqyren nga Qeveria, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli Prokurorial, Këshilli Gjyqësor dhe Avokati i Popullit.

Rasti në komunën e Drenasit shpërfaq krizën morale të institucioneve tona dhe jo vetëm, por të shoqërisë në përgjithësi.

Rasti konkret le të na shërbejë sot, të nderuar kolegë, dhe të mos deklarohemi që jemi të befasuar, që jemi të traumatizuar, sepse këto raste nuk kanë filluar sot, por janë me vite të tëra dhe, natyrisht, unë dua të marr këtë rast konkret si shembull që sot ne të gjitha partitë politike në Kuvend të jemi të një mendimi dhe të veprojmë drejt për t'i luftuar këto dukuri që po instalohen tashmë në shoqërinë tonë.

Por fatkeqësisht, për ta bërë një gjë të tillë që e kemi ftuar sot këtë seancë, nuk është prezent kryetari i Kuvendit, e unë mendoj se nuk ka temë më të rëndësishme sot se kjo, jo si rast, por fatkeqësisht si dukuri.

Nuk e kemi ministrin e linjës të Shëndetësisë këtu, e patëm të Arsimit, por u lodh, u mërzi, doli, nuk e kemi ministrin e Drejtësisë këtu, sepse ne duhet të jemi sot të gjithë bashkë këtu, jo sa për

të diskutuar, sa për të debatuar, sa për të thënë diçka, por vërtet për të marrë përgjegjësitë, të cilat na takojnë dhe situata të ndryshojë, sepse është shumë e rëndë në nivel vendi.

Rasti konkret na ka dhënë të kuptojmë se si funksionojnë zinxhiri ose hallkat e zinxhirit të institucione të Republikës së Kosovës, sepse fati në fatkeqësinë e rastit na ka shpërfaqur familjen, na ka shpërfaqur shkollën, na ka shpërfaqur sigurinë, policinë, prokurorinë, na ka shpërfaqur mjekun, na ka shpërfaqur hotelet, na ka shpërfaqur jetën në tërësi. Dhe, kjo na jap të kuptojmë shumë dhe na fton ndërgjegjen tonë, ku jemi ne, çfarë po bëjmë?

Shtyllat kryesore të shtetit, pra, është e vërtetë që ne jemi të gjithë të vetëdijshëm dhe e dimë se në shkollat tona ka arsimtarë, mësues të llojit monstrum, ka edhe pedofilë, ka edhe kriminelë, ka arsimtarë me probleme mendore dhe, fatkeqësisht Sindikata, sidomos këto ditë, e arsimit nuk e gjeti forcën, e për një muaj na i kanë lënë fëmijët brenda për t'ua rritur pagat, ndërsa sot, dje, ende nuk e gjetën forcën e të dalin e të deklarohen që ta dënojnë një rast të tillë. Ku është ndërgjegjja e Sindikatës së Arsimit? Ku është përgjegjësia e Ministrisë së Arsimit? Nuk ka!

Kalojmë te policia. Shtylla e sigurisë, ku ne të gjithë presim që fëmijët tonë, ne, të jemi të sigurt me policinë tonë, ose nuk duhet ta kemi ndërmend sot që t'i kryqëzojmë as arsimtarët, as policinë, as mjekët, shëndetësinë, sepse fatbardhësisht në shkollat tona kemi mësues shumë të ndërgjegjshëm, shumë të ndershëm, po kemi edhe ata të cilët i përmenda, kemi policë shumë të ndërgjegjshëm, shumë të sjellshëm, kemi policë që sakrifikojnë edhe jetën, kemi pasur rastin e Istogut, dha jetën në mbrojtje të qytetarëve dhe institucioneve, qoftë financiare, qoftë shtetërore, qoftë private të vendit, por kemi kolegë të atij polici, i cili bashkëpunon me kriminelin, kemi policë që bashkëpunojnë me kriminelët, që janë vetë kriminelë, kemi rastet konkrete, pra, thyerje të Dhomave të Dëshmive në Prishtinë e në Pejë dhe këto janë modele, të cilat i jep struktura, hierarkia e Ministrisë së Punëve të Brendshme, edhe pa dhënë përgjegjësi asnjëherë.

Ne duhet ta bëjmë diferencimin, sepse, po e them, është një krizë në shoqërinë tonë dhe duhet ta ndajmë shapin prej sheqerit. Nuk mund të jetë përballë një polici të ndershëm një polic kriminel, edhe kush do ta marrë përgjegjësinë për ta bërë këtë ndarje, dihet, pra, janë përgjegjësitë e përcaktuara me ligj.

Kemi mjekë, mjekë të cilët vërtet janë vetëmohues, të ndërgjegjshëm, të aftë profesionalisht, por edhe mjekë kriminelë, kemi mjekë hajna, kemi mjekë të cilët nuk e meritojnë të jenë aty dhe duhet bërë diferencimin. Kush duhet bërë këtë? Duhet bërë ministria, sepse nuk guxojmë t'i bëjmë bashkë mjekun e mirë me atë mjekun i cili nuk e meriton të jetë aty.

Po më kujtohet, mbrëmë në mediat tona një mjek, që nuk po më kujtohet emri, nga Ferizaj, i cili kishte punësuar një asistente me aftësi të kufizuara dhe ishte për lakmi, tregonte një mjek human, një mjek me ndërgjegje. Ndërsa, ne kemi mjekë, të cilët bëjnë veprime çfarë i kemi dhe për të

cilat po diskutojmë sot. E këto vërtet duhet ndarë një herë mirë shapin nga sheqeri, kush duhet ta bëjë këtë, pra përgjegjësia.

Ne nuk kemi nevojë të flasim me emra konkretë të rastit, po ne duhet të kërkojmë përgjegjësi dhe përgjegjësia s'është askund. S'është, sepse ne nuk jemi të mësuar të kemi dorëheqje si akte morale, nuk vjen në shprehje! Ne ende nuk marrim, për shembull, në zinxhirin e hierarkisë përgjegjësi prej poshtë, po as lart, në këtë rast, sepse nuk është rast ky, kjo është dukuri, fatkeqësisht.

Po kjo vajzë e mitur le të jetë kurban, le të jetë shembull që vërtet i ka lidhur të gjitha hallkat e institucionet të Republikës së Kosovës dhe vetë moralin e shoqërisë sonë dhe hajde të debatojmë çka duhet të bëjmë? A tolerohen më këto gjëra, sepse ne e dimë se çka po ndodh, secili prej nesh, por përgjegjësia nuk është askund.

Konkretisht, legjislacionin duhet ta shikojmë ne si deputetë, ajo përgjegjësia që është, e që fatkeqësisht ose fatbardhësisht nuk është që na mungojnë ligjet, ligjet nuk respektohen. Ndërsa, në raport me Policinë unë konsideroj se duhet shumë shpejt ta bëjmë ligjin për policinë dhe me ligj të caktojmë shumë gjëra për veprimin ose për policët.

Dua ta theksoj edhe këtë, për shembull, te ne hallkat ku vërtet duhet të funksionojnë, jo të na ndodhin këto gjëra që na ndodhin, po të jenë më efektive në punë prokurorët, doktorët, profesorët, të cilët i bëjnë nga dy punë. Ne kemi lëndë të tëra të grumbulluara nëpër gjykatat tona, ndërsa prokurorët tonë janë prokurorë dhe janë profesorë nëpër universitete të caktuara. Doktorët tanë që presin pacientët ata kanë një punë atje në QKUK, kushtimisht, një në universitet dhe një në ordinancë private. Nuk shkon më kjo. Profesorët njëkohësisht, ose politikanët që vërtet, ministri konkretisht që ka punë ditore dhe ai është profesor në një universitet të caktuar, nuk shkojnë më këto gjëra. Ne duhet të fillojmë nga vetvetja dhe duhet të jemi seriozë, duhet të përkushtohemi ndaj kësaj shoqërie, ndaj të rinjve tonë. Ta kemi parasysh këtë vajzë që i ka ndodhur kjo gjë, dhe ju kisha lutur secilin prej nesh këtu, edhe kolege edhe kolegë, mendojeni këtë vajzë si vajzën tuaj, sepse secilit prej nesh mund të na ndodhë një gjë e tillë, ku ne kemi marrë besimin e popullit, e kemi marrë përgjegjësia për t'i mbrojtur ata dhe heshtin për shkak se na vyejnë një grusht vota atje, këtu ose ku ta di unë. Ne kemi përgjegjësi të mëdha dhe duhet t'i thërrasim njerëzit para përgjegjësise.

Ministritë e linjës duhet ta marrin përgjegjësia, duhet të mësohen ta kenë aktin moral për dorëheqje. Nëse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Besa! Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zonja Shinik!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Do t'i bashkohem edhe unë diskutimit të kolegëve të mi, të cilët besoj shumë që ishin shumë konkretë sot në qasjen e tyre. E vlerësoj maturinë që e patën pjesa dërrmuese e diskutimeve dhe diskutuesve sot lidhur me temën shumë të ndjeshme. Natyrisht, siç shpreh keqardhjen për diskursin e rëndë dhe akuzues, dhe keqpërdorimin e një teme shumë të ndjeshme të shoqërisë tonë me debate të ulëta politike, në kalkulime, të cilat nuk do duhej që t'i kishte Kuvendi i Republikës së Kosovës sot.

Është për keqardhje që një temë kaq e rëndë e një tragjedie që i ka ndodhur një vajze të mitur tentohet të kthehet në diskutim politik, në akuza të rënda politike. Fundja, jemi bashkuar sot për të dhënë qëndrimet tona lidhur me krimin, i cili nuk ka parti politike dhe nuk i përket asnjë partie politike, por që duhet të kërkohet ndëshkim për atë që kanë kryer këtë krim nga të gjithë diskutuesit. Në fillim të fjalës dua të them që ndaj pothuajse të njëjtin qëndrim me fjalimin e jashtëzakonshëm të zonjës Kusari Lila, e cila e përmbloodhi mjaft mirë tragjedinë e vajzës së mitur në Drenas dhe u mundua që me qasjen e saj korrekte dhe konstruktive të ofrojë argumente konkrete si ne si shoqëri dhe si institucione të dalim nga ky hendek. E mbështes protestën e sotme në komunën e Drenasit, siç mbështes edhe reagimin qytetar që ka ndodhur në komunën e Prishtinës dhe, ku qytetarët e shumtë nga të gjitha trevat e Kosovës kanë dalë me parulla në duar për t'i thënë një herë e përgjithmonë jo përdhunimit dhe për ta marrë në mbrojtje një të mitur, e cila për disa vjet me radhë është skllavëruar në formën më të rëndë të mundshme.

Pa dyshim që ngjarja e Drenasit është njëra prej ngjarjeve më të rënda të Kosovës pas luftës, jo që nuk ka pasur edhe ngjarje të tjera, sepse unë jam e bindur që ka edhe raste të tjera, të cilat ende janë pa zë, por për shkak të asaj që një krim i rëndë ka ndodhur dhe në fakt është një zinxhir i tërë i institucioneve, të cilat janë të përfshira në këtë krim dhe të cilat, kërkojnë një hetim të mirëfilltë nga institucionet e Republikës së Kosovës. Prandaj, fjalimi im sot në Kuvend, më besoni, që qysh në ardhjen time në këtë seancë kam pasur dilemat e mia si nënë, si grua dhe si një vajzë se si t'i qasem diskutimit të sotëm në Kuvend, të mundohem që ta trajtoj pa emocione, por tragjedia e cila ka prekur të gjithë, natyrisht që nuk na mundëson që ne të mos kemi emocion ndaj ngjarjes dhe ndaj krimit që ka ndodhur në komunën e Drenasit.

Prandaj, besoj shumë që secili nga ne në këtë sallë sot ka qenë në siklet se si t'i qaset diskutimit të sotëm, por thelbi kryesor është që deputetët të flasin për zbatimin e ligjit që është hendeku kryesor që ka çuar deri tek kjo tragjedi dhe për të cilin ne si deputetë jemi të thirrur që të veprojmë. Natyrisht unë shpreh keqardhjen time të thellë për tragjedinë që ka ndodhur, për gjithë këtë histori zinxhirore të krimit dhe për gjendjen tejet të rëndë, në të cilën ka kaluar vajza e mitur e komunës së Drenasit dhe familjarët e saj, por edhe i gjithë opinioni i gjerë. Ajo që i ka ndodhur kësaj vajze në Drenas pa dyshim është sulm i drejtpërdrejtë ndaj të gjitha parimeve morale dhe

ligjore dhe, po ashtu është rast i rëndë i cili ndjell frikë për të gjithë moshatarët e saj dhe jo vetëm që të flasin hapur në rast se ata do të kenë ndonjë ngacmim dhe ndonjë rast të njëjtë për të folur hapur para shoqërisë dhe për të denoncuar krimet e tilla të mundshme. Kjo dramë është treguesi më i qartë për ngecjet zinxhirore të sistemit bazë të shtetndërtimit, prandaj protesta dje dhe protesta sot flet qartë për një reagim shoqëror për të mbështetur viktimën dhe për të ngritur edhe më tepër këtë ngjarje të rëndë në nivel institucional.

E thashë që në fillim që krimi i ndodhur në komunën e Drenasit nuk ka parti dhe duhet të luftohet nga të gjitha partitë politike, pozitë dhe opozitë, kudo dhe kurdo. Kurse, pretendentët për të përfshirë do të thotë këtë diskurs për ndonjë votë nga të tilla raste, atëherë vetëm sa e nxisin edhe më tepër krimin dhe, meqë jam diskutuesja e 15-të kërkoj nga kolegët e mi që të mos lëshohen në deklarata, akuza dhe kundërakuzat kur flitet për një ngjarje tejet të rëndë dhe të ndjeshme. Jam i bindur që raste të tilla ka edhe më shumë në shoqërinë tonë, prandaj besoj shumë se nga mbështetja e shoqërisë që i kanë dhënë rastit të të miturës në Drenas, do të marrin kurajë dhe zemër që edhe rastet e tilla t'i denoncojnë dhe të flasin më me zë, të mos heshtin, sepse kanë shkuar 2 ose më shumë vjet që e mitura e Drenasit është përballur me një rast të tillë. Nëse flasim për shtimin e rasteve të ngacmimeve ndaj të miturve, u shtrua këtu me të drejtë nga njëri prej kolegëve deputet, do të thotë vetëm dy vjetët e fundit janë shënuar 123 raste të ngacmimeve ndaj të miturve që njihen si raste të pedofilisë, është shqetësim real, është shqetësim i cili duhet të adresohet me shumë seriozitet nga institucionet e vendit dhe besoj shumë që ky rast vetëm sa do ta shtojë edhe më tepër vëmendjen që institucionet të marrin masa që të sjellin sa më parë në lexim të dytë ligjin që mbron fëmijët dhe të ketë masa dhe sanksione të ashpra në mënyrë që ne të privohemi nga këto raste tejet të rënda.

Dënim maksimal për këdo që është i përfshirë në këtë rast, kërkoj si deputete e këtij Parlamenti. Trajtim të mirëfilltë të viktimës, si dhe fushata vetëdijesimi që do të ndihmonin që raste të tilla të mos kemi më, si dhe të sillen po ashtu në lexim të dytë projektligji me masa konkrete. Po ashtu, inkurajoj të gjitha ato vajza dhe jo vetëm të gjithë ata djem, pjesëtarë të shoqërisë tonë, të cilët përballen me raste të tilla që drejtohen te institucionet dhe institucionet të jenë të vëmendshme që këto raste t'i trajtojnë me shumë seriozitet. Ky rast tejet i rëndë nuk do të duhej që të zbehë besimin tonë në arsim, në polici, si dhe në mjekësi dhe në institucionet e tjera. Fundja jemi ne qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët kemi qenë shumë krenarë me rastin e fundit të policit Demaj, i cili dha jetën e tij në detyrë, në komunën e Istogut duke i shërbyer vendit.

Besoj shumë që ka edhe shumë policë, mjekë dhe pedagogë të shkëlqyer, të cilët ne duhet t'i respektojmë dhe të mos ndodhin që raste të tilla ta zbehin besimin tonë në institucione të Republikës së Kosovës. Policia e Kosovës është njëri prej institucioneve që prin me besueshmërinë ndaj të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, prandaj edhe një herë po them që të jemi të vëmendshëm që përgjegjësinë të mos e bartim te të gjithë. Dhe, në fund fare, besoj shumë që është për keqardhje, janë për keqardhje zërat që ditëve të fundit janë munduar ta

arsyetojnë rastin e përdhunimit në Drenas, ka pasur shumë zëra veçanërisht në rrjetet sociale, të cilët janë zëra për keqardhje që mundohen që një tragjedi të tillë t'i gjejnë arsytim.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Arbër Rexhaj, urdhëroni!

ARBËR REXHAJ: Përshëndetje, të nderuar qytetarë!

Situata e rëndë traumatike e vajzës nga Drenasi sigurisht që na ka tronditur të gjithëve, ka shumë për të thënë e shumë për të punuar në këtë drejtim. Ngacmimet, kushtëzimet, shantazhet rëndom vijnë nga nivele të larta deri në institucione publike, por edhe nga punëdhënësit në sektorin privat.

Punësimi, avancimi, gradimi, vazhdimi i kontratës, udhëtimet jashtë vendit, mëditjet, keqpërdoren për abuzim dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare. Këto bëhen sepse në Kosovë ata që mbartin përgjegjësi nuk ia kanë frikën fare ligjit, sepse ligji funksionon ndryshe për qytetarin e varfër, gruan, qytetarin që jeton rëndomë në kushte të rënda dhe ndryshe për fëmijët e pushtetarëve dhe shtresës e cila mbart përgjegjësinë në sferën e institucioneve. Dhunimin e vajzës duhet ta shohim edhe në prizmin sistemor të përgjegjësisë institucionale, një mësues, një polic, një mjek i involvuar, por ajo çka më trondit pos kësaj, është edhe mungesa e llogaridhënies dhe e kontrollit. Për shembull, rasti i djalit të Shpend Maxhunit, Dhoma e Dëshmive janë dy nga shumë raste që tregojnë se futja e policëve në krim po tolerohet. Policia e Kosovës pritet ta transferojë dhe ta degradojë një zyrtar policor nga Drenasi, e cila po dyshohet që ka nxjerrë informata për dhunimin e nxënëses nga hetuesi Vesel Veseli. Njëjtë kështu ka ndodhur edhe degradimi i shumë policëve, të cilët në vend se të nderohen, ata degradohen se tregojnë për raste të shfrytëzimit, dhunimit, korrupsionit dhe krimit të organizuar. A nuk ndodhi kështu edhe me djalin e Shpend Maxhunit? Edhe në sektorin privat kemi plot raste, të cilat nuk dalin publik pos shfrytëzimeve dhe ngacmimeve seksuale, vajzat dhe gratë aty keqpërdoren edhe në rrafshin familjar e social. Aty gratë nuk guxojnë të mbesin shtatzënë, edhe kur mbesin detyrohen ta shtrëngojnë barkun për të mos u vërejtur. E njëjta ndodh edhe me punëtorët e bankave, të cilat nuk guxojnë të ushtrojnë të drejtën për të pasur fëmijë kur dëshirojnë, sepse ose degradohen në pozicione të punës, madje shumë prej tyre edhe mund të largohen.

E, nëse sëmuren, në qoftë se kjo sëmundje mund të jetë e rëndë, ato automatikisht largohen nga puna pa asnjë kompensim dhe këto ndodhin para hundëve tona. Në rrafshin institucional, në rastin e vajzës së mitur kur janë të ndërlidhur persona nga arsimit, policia dhe shëndetësia, është një alarm për shtetin. Ky shtet duhet ta arsimojë, ta edukojë qytetarin, ta mbrojë atë, por edhe ta shërojë. Kjo ndodh kur në shtetin tonë partitë politike kanë zaptuar sistemin publik, duke filluar nga drejtorët e krejt shkollave në Republikën e Kosovës, madje disa shumicën e mësimeve, policëve, oficerëve, drejtorëve të spitaleve, mjekëve, të cilët i kanë punësuar jo mbi bazë të kriterëve profesionale, por të kriterëve ose të themi më mirë kushtëzimeve partiake. Prandaj, na bredhin e ikin rrugëve ata të cilët kanë kryer studimet pas universitare, madje-madje edhe ato

doktorate. Rasti i vajzës në fjalë duhet të na hapë e t'ua hapë sytë institucioneve të vendit që të ketë mbikëqyrje më të madhe në sektorët publikë, të ndalen urgjentisht punësimet mbi baza partiake dhe t'u kthehen vlerave, të cilat duhet ta shtyjnë shtetin dhe institucionet tona përpara.

Natyrisht, të gjitha këto vijnë si rezultat i dobësisë së sistemit që është ndërtuar mbrapsht në sektorët publikë të shtetit. Përmes levave të mbrapshta të korrupsionit e krimit institucional brenda sektorit publik, punësimi korruptiv, partiak, klientel dhe nepotik, nuk mund të dilte shërbim profesional dhe përgjegjësi më e mirë. Pastaj vjen puna edhe te dhuna e përdhunimi, devijime morale e shoqërore. Nuk mund ta kuptoj megjithatë tërë këtë pezëm përmbi mësuesit, mantelbardhët dhe policët që është në masë të madhe. Përgjegjësia sigurisht që është individuale, ndërsa përgjegjësia publike u takon institucioneve të shtetit. Mësuesve, mjekëve dhe policëve tanë duhet t'u kthehet dinjiteti dhe kjo bëhet me standard profesional. Jo të gjithë mësuesit, policët dhe mjekët janë dhunues dhe përdhunues, por ama për t'ua kthyer nderin në detyrë e përgjegjësi, shteti duhet të marrë masa që nga këto institucione të mos keqpërdoren, abuzohen, dhunohen fëmijët e qytetarëve tanë. Pra, duhet ta 'çkapim' shtetin nga partitizimi i skajshëm, duhet të mposhtet ky mentalitet i mbrapshtë dhe ky sistem i kapur dhe korruptiv. Vetëm në këtë mënyrë e kthejmë dinjitetin tonë, edhe qytetar madje. Ndërsa, sigurisht që lufta për barazi gjinore është temë në vete, e cila duhet të vazhdojë me shumë gjasë fatkeqësisht, pra edhe për shumë kohë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka zonja Besa Baftiu, urdhëroni!

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dhuna seksuale është dhunë pa marrë parasysh nga kush shkaktohet, por të shkaktohet nga ata që kanë përgjegjësi institucionale, nga ata që janë të thirrur të të edukojnë, të të mbrojnë, të të shërojnë, kjo është më shumë se dhunë, kjo është më shumë se krim.

Institucioni ku duhej të edukohej është vendi ku fillon tragjedia e ngjarjes, ku për më shumë se një vit vajza e mitur është abuzuar seksualisht nga mësuesi i saj. Në kohën kur viktimja ka raportuar në polici, ka hasur në abuzuesin tjetër, policin, i cili po ashtu për një vit abuzon me viktимën deri në momentin kur ai donte t'i jepte fund abuzimit seksual me një krim tjetër, siç është aborti i detyruar, të cilin veprim e kryen në një ordinancë private. Mjeku, i cili ka kryer abortin arsyetohet se viktimja ishte mbi 18 vjeç dhe se është bërë konform ligjit mbi ndërprerjen e shtatzënisë, gjë që e lejon edhe Ligji mbi ndërprerjen e shtatzënisë që çdo grua mbi moshën 18-vjeçare të vendosë vetë për ndërprerjen e shtatzënisë.

Por, prapëseprapë kjo nuk e arsyeton faktin për një veprim të tillë, duke pasur parasysh se ordinanca ku ka ushtruar profesionin doktori, sipas të dhënave të Inspektoratit Shëndetësor nuk i ka plotësuar kushtet e parapara me ligj për të kryer abortin.

Të nderuar deputetë,

Nuk është vetëm kjo ordinancë ku kryhen aborte të jashtëligjshme. Ka dhjetëra ordinanca gjinekologjike që kryejnë aborte ilegale dhe nuk kemi të dhëna. Inspektorati Shëndetësor, i cili është i thirrur të bëjë monitorimin e këtyre ordinancave dhe spitaleve private nuk ka bërë ndonjë raport për numrin e aborteve dhe kushtet në të cilat kryhet aborti. Mirëpo, jo vetëm që nuk ka të dhëna nga institucionet private, nuk kemi të dhëna as nga institucionet shëndetësore publike, për të cilat është i obliguar me ligj çdo institucion që të paraqesë abortet apo të paraqesë numrin e aborteve pranë Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Rasti i vajzës nga Drenasi është vetëm një nga shumë rastet që është bërë tanimë publik, sepse ka raste të tjera, të cilat mbesin të heshtura, ashtu siç është pretenduar të mbetet i heshtur edhe ky rast, por falë mediave u shpërfaq në opinion dhe kemi edhe reagimin e qytetarëve përmes protestave, të cilat u bënë dje, po vazhdojnë edhe sot e që shpresoj dhe besoj që duhet të protestohet edhe në ditët në vijim në të gjitha qytetet për të sensibilizuar dhe për t'i përkrahur vajzat dhe gratë që t'i denoncojnë rastet, ndonëse mund të ndihen të pasigurta pas kësaj që ndodhi.

Ne i mbështesim rekomandimet që u dhanë më herët nga parafolësit, nga deputetët, por po ashtu kërkojmë që të jetësohen sa më shpejt kërkesat për mbështetjen e strehimoreve që strehojnë viktimat e dhunës në familje dhe dhunës seksuale. Në veçanti kërkojmë nga Ministria e Shëndetësisë përgjegjësi për shkeljen elementare të të drejtave elementare që po u bëhet grave, të drejtën mbi shëndetin e tyre dhe të drejtën mbi trupin e tyre, si dhe kërkojmë nga instancat shtetërore që të veprojnë me përgjegjësinë më të lartë institucionale që kryerësit e veprës të marrin dënimin e merituar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj. Urdhëroni!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot me të vërtetë është të ndjehesh i trishtueshëm, e të mos flenë të qetë asnjëri prej neve që jemi këtu si zë i popullit, pa marrë parasysh se cilit subjekt politik i takojmë.

Te ne ka çdo ditë raste kur vajzat dhe motrat tona ngacmohen në punë, në rrugë apo edhe në fakultete, por të ngacmohen e të abuzohen nga mësuesi në shkollë, kjo është më se e trishtueshme dhe të mos mund të mendojë njeriu se një qenie njerëzore, një person që ka rolin edukues, të jetë abuzues! Këtë të gjithë mund ta bëjnë, përveç jo një njeri. Edhe më trishtuese është kur një viktimë kërkon ndihmë, aty ku të gjithë ne do të kërkonim ndihmë, në rast se do të

ishim viktimë, e aty u gjend personi tjetër abuzues, një person tjetër jonjerëzor, por tani jo si edukues, por ajo e mendoj për hero, e asaj ju kthye në dhunues. Ajo e mendoj shpëtimtar, e ju kthye në vrasës, në vrasës të fëmijës së saj. I trishtuar nga rasti i 16-vjeçares, e cila u abuzua nga profesori, e u dhunua nga hetuesi, e krimin e kurorëzoi mjeku i papërgjegjshëm. Ky rast të bën të kesh frikë për vajzën apo motrën nga profesori, të bën të kesh frikë nëse vajza apo motra jote lajmëron rastin në polici, në këto dy institucione pa dyshim ka njerëz që punojnë me nder e që janë në numër shumë të madh, se sa i ngacmuesve dhe i abuzuesve. Andaj, profesori duhet ta lajmërojë kolegun e tij, e polici po ashtu duhet ta lajmërojë kolegun e tij të papërgjegjshëm. Të gjithë mësimdhënësit, vajzat tona, motrat tona nëpër shkolla shikoni si të jenë vajzat tuaja, sepse janë amaneti ynë e i prindërve për ju. E, policëve, ju lutem, mbroni viktimat, e mos i abuzoni e dhunoni ato!

Neve si përfaqësues të qytetarëve gjithmonë do të na keni në krah kur do t'i mbroni viktimat, por gjithmonë do të na keni kundër e do t'ju luftojmë deri në pikën e fundit për viktimën që ju e abuzoni. Këto dhe shumë arsye të tjera na tregojnë se duhet një proces vetingu në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Ky popull nuk meriton zyrtarë publikë, të cilët nuk kanë integritet moral dhe janë pjesë e institucioneve me të kaluar kriminale. Pasojat e mosndëshkimit mbi të gjitha e promovimit dhe e zgjedhjes së njerëzve, të cilët në forma të ndryshme janë pjesë e veprave kriminale, janë prodhues të këtyre pasojave në shoqëri, sepse kur kryerësit e krimeve të ndryshme janë pjesë aktive e institucioneve të Republikës së Kosovës, atëherë ngjarje të tilla shndërrohen në normë dhe bëhen pjesë e përditshmërisë fatkeqe në Kosovë.

Ju kujtohen rastet makabre, kriminale, të cilat akoma nuk kanë marrë përgjigje as nga Policia e Kosovës, as nga Prokuroria e Kosovës. Dhomat, vjedhja në Dhomat e Dëshmive në Prishtinë dhe në Pejë, ku sipas Inspektoratit Policor janë vjedhur më shumë se 200 dosje të krimeve të rënda, kryesisht vrasje në rajonin e Pejës dhe të Dukagjinit. Vjedhja e arit ishte vetëm një mbulesë edhe e drogës po ashtu. Aty ishin shkatërruar prona e dëshmi të armëve, të gëzhjojave, gjurmëve të ADN-së dhe prona të rëndësishme materiale. Cila është përgjigjja e Policisë së Kosovës? Cila është përgjigjja morale e Ministrisë së Punëve të Brendshme? Dhe, cila është përgjigjja e Qeverisë së Republikës së Kosovës?

Para syve të kësaj Qeverie pothuajse në çdo cep të vendit kanë mbirë qendrat e masazheve, motele dhe pika të muzikave të vallëzimit, por prapa tyre ka dhunë, keqpërdorim të femrave dhe shërbime të paligjshme seksuale. Andaj, në çka frymëzohen këta mësues të prishtë? Në çka frymëzohet një polic kriminel me dekoratë që dhunon fëmijë dhe një gjinekolog që s'ka etikë dhe zot i tij është paraja.

Duke qenë pjesë e kësaj seance, një qytetar i Republikës së Kosovës më dërgon një mesazh, ta quaj më shumë një prononcim të këshilltares së Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, zotit Kadri Veseli, e bërë më 1 maj 2018, po citoj: “Arbana Xharra: para disa muajve e kam

denoncuar një drejtor të një ndërmarrjeje publike në Kosovë për kërcënimin që u bën vajzave të reja duke i shantazhuar në këmbim të vendeve të punës. I kam të gjitha faktet, mesazhet, sms, të cilat i ka edhe Policia e Kosovës. Dhe, në fund, doli që policët të cilët po merren me rastin janë miq të këtij drejtori”. E mbyll citatin.

A e ka pyetur këshilltarin e vet kryetari i Kuvendit, se kush është ky drejtor i kësaj ndërmarrjeje publike? Cilit subjekt politik i takon? Kush qëndron prapa zgjedhjes së tij dhe kush e mbron këtë kërcënues dhe shantazhues të vajzave dhe të femrave e motrave tona në Republikën e Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti. Urdhëroni!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zonja nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar ministra, deputetë!

Sot ky më shumë se sa një debat i zakonshëm në Kuvendin e Kosovës vjen si reagim qytetar i të gjithë neve, më shumë se sa një reagim politik vjen si një reagim moral, si një reagim i zakonshëm i njerëzve që do të duhej të përfaqësonin shpejt dhe drejt shqetësimet e qytetarëve. Rasti i Drenasit është një rast i cili jo vetëm shqetësimin për një debat, po jam i sigurt dhe jo vetëm një rezolutë, ky rast do të ndikojë më shumë që të punohet më mirë nga të gjithë ne, t’u përgjigjemi detyrave tona kudo që jemi, cilitdo që na takojnë ato detyra dhe më shumë institucioneve të Kosovës.

Është mirë që ky debat është kryesisht në këto suaza dhe nuk doli më shumë se sa kaq, me ndonjë përjashtim, ndonjë debat për qerim hesapesh politike në mes nesh, edhe pse detyrat dhe përgjegjësitë tona të secilit janë të ditura. Ky rast ishte tragjik edhe për faktin se sot është një vajzë e pambrojtur, një familje e pambrojtur. Është një rast dhe shumë raste tjera, që ndoshta nuk kanë guximin të tregohen. Ky rast është tragjik, për shkak se shkakton një pasiguri në familjet tona, te fëmijët tanë. Sot është në pikëpyetje se sa janë të mbrojtura vajzat, fëmijët tanë...

Ky rast për më tepër është i rëndë sepse nxjerr në pah të metat e sistemit, të meta që duhet t’i themi, ato që u thanë këtu, pa dashur t’i ekzagjerojmë ato, një sistem në të cilin është investuar me vite të tëra nga të gjithë, edhe nga ata partnerë që janë munduar të sjellin modelet më të mira, por një sistem i cili po e shohim se i ka të metat e veta. Sot këtu i kemi vetëm dy ministra dhe u tha nga të gjithë, pajtohem se do të duhej të ishin më shumë, sepse është një përgjegjësi e një zinxhiri të tërë institucionesh. Më vjen keq, që mund të apostrofohen vetëm tri dikasterë. Ka të meta në sistem dhe ai sistem duhet të përmirësohet. Por, është për të ardhur keq po ashtu, që sot dhe me këtë rast sheshohen vetëm të metat. Zoti ministër i brendshëm para disa vitesh, kur nuk ka pasur përgjegjësi të plotë Qeveria jonë, ose ministria jonë, ka qenë UNMIK-u ai që ka pasur me këtë segment të sundimit të ligjit që ju e drejtoni, Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe

qarkullonte një listë me emra të lokaleve nëpër Prishtinë e nëpër Kosovë, ku “njerëzit e UNMIK-ut dhe ndërkombëtarë nuk duhet t’i frekuentojnë, sepse aty bëhen punë të këqija”.

Nuk besoj që sot ka, ose duhet të lejohet në përgjegjësinë tonë të kemi informacione të tilla dhe të mos ndërmerret diçka. Unë mendoj se kemi punuar shumë më shumë në atë drejtim dhe fatkeqësisht, segmenti gati më i mirë i sundimit të ligjit sot mbetet nën hijen e ngjarjeve që kanë ndodhur. Por, kjo nuk nënkupton që nuk duhet të merren masa më të drejtpërdrejta për të evituar të metat. Sot nuk ka një listë ndoshta që qarkullon nëpër Kosovë me lokale të tilla, por të gjithë e dimë që në qytete të caktuara ka të meta të tilla, ku lidhen me dobësitë e Policisë. Ka lokale ku thuhet për trafikimin dhe flitet, ne nuk po jetojmë në metropole e të mos e dimë se çfarë po ndodh dy-tri blloqe larg nesh, kur thuhet që ka bashkëpunim në trafikim, ose të involvuar edhe segmente të Policisë. Kemi pasur dhe raste të hapjes së dosjeve nga sistemi i drejtësisë për raste të tilla, ose me rastin e drogës, ose me rastin e fajdeve... janë çështje që duhet të merren seriozisht. Ose, kemi të dhëna të hapura, ose tregime nëpër Prishtinë për abuzimet në fushën e arsimit. Janë këto çështje që nuk duhet që neglizhohen.

Por më shumë se kaq, ky rast i hap dy çështje që duhet të na sjellin para përgjegjësisë. Sot u tha edhe u përmend edhe retorika jonë, se jemi në gjuhën tonë të përditshme flasim për pabarazinë, bëjmë dallimin në mes të të drejtave të burrave dhe të grave. Hajde le të merremi e të trajtojmë një çështje tjetër, ose të përmendim e të kujtojmë një kohë kur ne s’e kemi pasur shtetin tonë, sistemin tonë, kanë mbizotëruar vlerat më të mira të traditës, ku gruaja është trajtuar si e shenjtë në familjen tonë dhe u kemi përballuar edhe atyre tendencave për ta shkatërruar familjen tonë nga regjimet që kanë qenë okupatore e deri te ajo që sot ky rast e vë në hije punën e mirë të mijëra mësimdhënësve, atyre që bëjnë më të mirën e tyre për t’i edukuar fëmijët, lë në hije punën e shkëlqyeshme të shumë policëve, që sot bëjnë më të mirën e tyre, edhe profesionale, edhe patriotike, për ta kryer detyrën e mirë në përputhje me ligjin dhe nevojat që ka shoqëria jonë. Ky është një rast i cili duhet të na shqetësojë e të na bëjë të gjithëve që të reagojmë sa më shpejt. Rasti i tillë duhet të na vërë në dilemë, ose të na shtyjë të mendojmë të gjithë, së pari për fëmijët tanë, për familjet tona edhe më tutje. Unë mendoj që më shumë, siç e përmenda në fillim, më shumë se sa një reagim me një rezolutë, ky rast duhet të na bashkojë që t’i kryejmë detyrat tona, së pari ne si Kuvend të bëjmë ligje më të mira, të përmirësojmë ligjet aty ku ka defekte dhe për më tepër, të përmirësojmë një segment që ka qenë vërejtje e përsëritur edhe nga BE dhe nga institucionet tjera, që ne duhet të përmirësojmë segmentin e mbikëqyrjes së sundimit të ligjit.

Pra, sa më shumë Kuvendi duhet t’i sheshojë të metat dhe të monitorojë zbatimin e mirëfilltë të ligjit në këtë vend. Shpresoj se nuk do të përsëriten raste të tilla, nuk do të lejohet përsëritja e rasteve të tilla dhe duhet të bashkohemi të gjithë ata këtu, që dëshirojnë të inkurajojnë fëmijët tanë, gratë dhe vajzat, të tregojnë aty ku e kanë besimin e tyre, t’i lajmërojnë rastet e tilla dhe t’i ndalojnë e të mos lejojnë që të na ndodhin më raste të tilla. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi. Urdhëroni!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetare!

Sot ndoshta është dashur që burrat e këtij Kuvendi të tregohen në nivel të detyrës dhe të mos u lënë shumë kolegeve tona ndoshta vend për të na plotësuar në adresimin e këtij problemi. Por, sido që të jetë, prapë s'po ndahemi. Le të jemi në krye të detyrës, secili si deputet.

Bëhet fjalë për një rast të veçantë. Bëhet fjalë për një rast, për së paku një viktimë, po e theksoj, së paku një viktimë në një rast, të cilën tashmë opinioni mund të them kushtimisht, që e ka marrë në mbrojtje. Por, duhet ta dimë që ky rast është një pasqyrë ndoshta i një fenomeni që ka ndodhur që mund të ndodh edhe sot kur po flasim dhe që mund të ndodh edhe në të ardhmen. Pra, do të ishte mirë që ta trajtojmë këtë problem në përgjithësi e jo të izoluar vetëm në një rast të vetëm. Gjithsesi, ky rast është edhe një rast tjetër, që neve do të duhej të na ndërgjegjësonte edhe më shumë.

Por, shoqëria është aktivizuar në këtë rast të caktuar opinioni pra, i cili gjithashtu është dëshmitar edhe i shumë krimeve, abuzimeve dhe rasteve tjera të ngjashme, të përafërta, ose që kanë të bëjnë me natyrën e njëjtë. Pra, përderisa po flasim, përderisa tash organet e drejtësisë e kanë marrë këtë rast, a s'mendojmë pak edhe për ato krime që po ndodhin në kohën kur po flasim. Dhe, të jeni të sigurt që tash ka edhe raste tjera që janë duke ndodhur në forma të ndryshme, ku bëhet fjalë për abuzim ndaj femrës.

Do të duhej që institucionet të ishin të ndërgjegjshme dhe aktive në të gjitha rastet, edhe kur janë, edhe kur s'janë publike, por sidomos kur ato janë publike. Pak kohë më parë kemi pasur raste të ngjashme të abuzimit, ose të ngacmimit edhe me disa nxënëse në Gjakovë. Ato kanë qenë publike. Por, a duhet ne vetëm të presim kur ato të bëhen publike? Unë mendoj që jo, sepse abuzimet e tilla po ndodhin në kohën kur po flasim, qoftë te të punësuarat në sektorin privat, qoftë të punësuarit në sektorin publik, qoftë në ato vajza të cilat sot janë të detyruara të mbajnë punë, ose të mbajnë punë, në të kundërtën, për shkak të presionit të shefave, familjarëve e të tjerë... Pra, këto gjëra po ndodhin në çdo vend dhe përditë dhe kjo neve duhet të na shqetësojë po aq, sa na ka shqetësuar një rast i veçantë. Pra, le t'i vihemi në mbrojtje të gjitha atyre, të cilat së paku nuk i dimë deri më tash.

Por, po shoh pak a shumë që nga ana e pushtetit duket se ka dy grupe se si e kanë perceptuar thirrjen e kësaj seance. Një pjesë, me sa vërejtja, kanë dhënë të kuptohet se ndoshta edhe nuk është dashur të thërritet kjo seancë dhe besoj se juve ua kanë thënë këtë korridoreve të Kuvendit, por një pjesë tjetër, mendojmë se është mirë që është thirrur kjo seancë dhe le të mbetet opinioni i ngarkuar, ose i fokusuar, në një rast të veçantë, përderisa jashtë këtij rasti po ndodhin po ashtu, edhe raste të tjera shumë të rëndësishme, siç ka të bëjë me bisedimet në Bruksel.

Por, në gjithë këtë rrafsh ka disa përgjegjës. Pra, ka përgjegjës dhe janë tre përgjegjësit, tash le të dihen me emra, me të cilët po merret drejtësia dhe jo vetëm me ta. Nuk mund të më thotë askush, që një koleg i policit nuk e ka ditur për këtë dhe po aq përgjegjës është edhe ai koleg, i cili ndoshta ka dëgjuar mburrjen e kolegut të vet dhe nuk e ka denoncuar. Nuk mund të them, që edhe ndonjë koleg i mësuesit nuk e ka ditur një gjë të tillë, ose nuk mund të them që gjinekologu i cili ka bërë një krim të radhës, ka qenë vetëm në ordinancën e tij. Aty ka pasur edhe infermierë, edhe teknikë, edhe kolegë të tjerë. Prandaj, edhe ata kanë përgjegjësi. Përgjegjësia është kryerja e veprës, por përgjegjësi është edhe fshehja e veprës penale dhe ju e dini më mirë se unë një gjë të tillë.

Por, po i mbetet pak hakut të flas për diçka, që ndoshta nuk është e pritshme në këtë sallë. Veprën nuk e ka bërë Policia e Kosovës. Këtë vepër dhe këtë krim e ka bërë njëri nga ta. Prandaj, duhet të kemi kujdes se si e trajtojmë gjithë Policinë e Kosovës, sepse Policia e Kosovës duhet të shihet ndaras nga cilido kriminel i fshehur nën petkun dhe nën uniformën e policit. Këtë vepër nuk e kanë bërë të gjithë arsimtarët, mësuesit dhe mësueset, por e ka bërë njëri nga ata. Dhe ne duhet shumë mirë t'i ndajmë kur flasim, po ashtu vlen edhe për doktorët. Por, në anën tjetër edhe këtë vepër nuk e ka bërë familja Xhekaj, as familja Veseli, por e ka bërë njëri nga ata. Prandaj, ne duhet të kemi kujdes që të mos i trajtojmë të gjithë njëjtë, pra të mos i gjeneralizojmë gjërat, sepse në këtë rast në mënyrë kolaterale ka edhe viktima të tjera, të cilat mund t'i lëndojmë, duke përfshirë edhe familjarët që mund të jenë të mitur dhe të cilët mund të pësojnë nga kjo dhe gjithsesi deri më tash edhe kanë pësuar trauma.

Çfarë duhet të bëjmë pas kësaj? Ne se deputetë të Parlamentit të Kosovës duhet ta vazhdojmë detyrën tonë, duhet të vazhdojmë të jemi të fokusuar edhe në tema të tjera kaq e edhe më shumë se kaq të rëndësishme, por nga kjo foltore dhe nga ky Parlament ne duhet që t'i inkurajojmë të gjithë ata, ose ato viktima, që të kenë guximin t'i denoncojnë, që të kenë guximin e nevojshëm për t'i denoncuar kudo, qoftë në organet e drejtësisë që jo rrallëherë janë të kapura, qoftë edhe në opinion, kurse institucionet përgjegjëse në këtë rast Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë menjëherë pas kësaj seance, jo pas kësaj dite, do të duhej të jetë në veprim, që fajtorët të vihen para drejtësisë dhe të marrin dënimin e merituar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Naser Rugova. Urdhëroni, deputet!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Kjo seancë do të duhej të ishte më tepër alarm, edhe në aspektin moral, edhe psikosocial, po edhe socio-kulturor dhe denigrimin që po e përjeton shoqëria jonë në hallka të rëndësishme institucionale.

Kolegët deputetë të të gjitha grupeve parlamentare i dëgjova me vëmendje dhe prekën aspekte të rëndësishme se si duhet institucionet kompetente të shtetit tonë të sillen ndaj këtyre rasteve, që

vërtet janë më tepër se tragjike. A jemi në nivel të detyrës si institucione shtetërore, por edhe si të zgjedhur të popullit, pa marrë parasysh pozitë dhe opozitë, është një pyetje që ne duhet t'ia shtrojmë edhe vetes, edhe në vendet ku punojmë dhe veprojmë, por edhe për përgjegjësitë edhe politike edhe institucionale dhe a po zbatohet ligji dhe instrumentet shtetërore në këtë shtet, a po kryejnë punën e vet?

Një e mitur në një komunë të vogël të Kosovës, nga një provincë thjesht, pas shumë peripecive, abuzimeve, maltretimeve dhe traumave, edhe psikike, edhe emocionale po edhe shëndetësore, thjesht del në pah rastësisht. A duhet t'u besohet institucioneve të caktuara dhe qytetari i Kosovës e në veçanti rasti i të miturës në atë kohë, sepse tani është në moshën madhore, është një alarm serioz që prek ndërgjegjen e institucioneve kompetente.

Vajza e mitur është abuzuar nga mësimdhënësi i saj, ka denoncuar rastin në organin e akuzës, pastaj është detyruar që ta tërheq denoncimin. Po vallë, ajo prokurori komunale a është dashur ta vlerësojë, pse një e mitur në atë moshë, denoncon, do të thotë diçka e madhe e ka shtyrë që ta denoncojë atë rast për abuzim seksual në shkollë, në një institucione që duhet të dhurojë dije dhe edukim, dhe pastaj herën tjetër, pas një odisejade të tmerrshme psiko-emocionale që i është bërë asaj të miture, troket në një adresë të organit të rendit dhe sigurisë, që do të duhej të përkujdeseshin për sigurinë.

Paramendoni se në çfarë traumash ka kaluar ajo e mitur për atë periudhë kohore kur po diskutojmë dhe e keqja është, që përfaqësuesi i institucionit përgjegjës të sigurisë është zëvendës shëf i hetimeve në atë komunë. Dhe pastaj, hallka tjetër merr një trajektore tragjedi, që kjo nxënëse e shkollës së mesme detyrohet të bëjë abort jashtë vullnetit të saj. Një apel për institucionet kompetente dhe për komplet hallkën institucionale, qoftë të aspektit të sigurisë, të arsimit, shëndetësisë, po edhe të punës dhe mirëqenies sociale, që vërtet ky rast të jetë trokitje në ndërgjegjen tonë si politikë dhe si institucione, në radhë të parë, por edhe si prindër e mësimdhënës, sepse një pjesë e madhe këtu nga ne deputetët jemi të kyçur edhe në sistemin arsimor.

Zoti ministër i Punëve të Brendshme, do të ju inkurajoja që të merrni masa komplet atë hallkë të krimbur në stacionin e Policisë në Drenas t'i suspendoni. Tani, kur po them hallkë të krimbur, e kam fjalën për ata që mbase i kanë ndihmuar atij keqbërësi, sepse vërtet kemi policë të jashtëzakonshëm, vetëmohues, që edhe kanë rënë në krye të detyrës, jo më shumë se disa javë polici në Istog. Dhe, në protestën që u bë tani në Drenas, ka policë të pjekur që janë prindër e që me lot në sy kanë reaguar para protestuesve. Ajo uniformë është e shenjtë dhe me qindra vite e kemi pritur, por kriminelët dhe njerëzit me ndërgjegje të prishur, institucionet, shoqëria, publiku, mediet duhet t'i denoncojnë. Është gabim që t'i përgjithësojmë profesionin e shenjtë të mësuesit dhe atë të policit. Po edhe drejtori i shkollës, edhe departamenti komunal i arsimit atje, duhet t'i ndajmë edhe kompetencat, thjeshtë atë mësimdhënës që prokuroria e ka ditur se e ka abuzuar

seksualisht një të mitur, le t'ia ndërrojnë vendin e punës. Po duhet strikt t'i ndalohej, që kurrë ai mos ta prekë ditarin e një vatre diturie me dorë. Prandaj, ne duhet të reagojmë sot dhe pa akuza e kundërakuza, sepse kjo temë që po e trajtojmë është më tepër se morale, është më tepër se politike, është e dhembshme, sepse vret shpresën e shumë vajzave, të shumë motrave, të shumë nënave, vret edhe shpresën e rinisë dhe intelektualëve a të besojnë në këto institucione që me mund e sakrificë brezash i kemi ndërtuar.

Prandaj, ju inkurajoj që të merrni hapa, pa marrë parasysh a kanë lidhje diku lartë apo poshtë, këta njerëz të involvuar në këtë vepër makabre. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaku. Urdhëroni!

XHEVAHIRE IZMAKU: Përshëndetje, ministra të nderuar!

Përshëndetje kolegë, kolege!

Të nderuar qytetarë, veçanërisht nëna dhe vajza që jeni duke na përcjellë në këtë debat i cili ka gjëra shumë të përsëritura dhe është konsumuar deri diku.

Kam ardhur në seancë asnjëherë më shumë me dilemën se cili do të jetë adresimi im, sepse është një moment jashtëzakonisht i rëndë dhe mendoj edhe tani, se kisha pasur të drejtë, se ndoshta është dashur të kërkohet ose seancë e mbyllur, ose nëse ne dëshirojmë që me të vërtetë t'i zgjidhim problemet atëherë do të kishim pasur shumë mundësi që t'i adresojmë nëpër komisione, sepse po mendoj se hapin e fundit e kemi vendosur si hapin e parë. Pra të dalë një temë e cila është ende në shqyrtim, domethënë është duke u trajtuar prej organeve kompetente të dalë në publik. Mendoj se publiku pak po na sheh sikur po duam ta adresojmë te njëri-tjetri kritika më shumë, se sa që po duam të zgjidhim një problem, i cili jam e sigurt edhe kur ta mbyllim krejt debatin s'ka me u zgjidhë, pra as sonte, as nesër. Por, meqenëse jam këtu, atëherë po vazhdoj me fjalën time, me shpresën që të mos ketë një vrull të tillë dhe me shpresën që s'na ndodhin raste të tjera, po kanë me ndodh edhe raste të tjera, të mos vrapohet se kush më i pari po e ngre një iniciativë, po kemi alternativa të tjera për t'i trajtuar në mënyrë profesionale, të ftohen ministrat në raportim dhe agjencitë të cilat kanë kompetenca për t'i ftuar në komisione e më pastaj të shihet nëse ka hapësirë për debat.

Çfarë do të ndodhë pra pas kësaj seance? A do ta bëjmë më të lehtë? Jo. A do të zgjidhet ky problem? Nuk do të zgjidhet. Unë mendoj që jo sot, përveç se e shndërruam në një dramë politike një rast fatkeq të një vajze të mitur nga një person i akuzuar, që fatkeqësisht ishte një polic në detyrë. Njëherësh, besoj që pa vetëdijen tonë kemi kontribuar pak sot në lëkundjen e besimit ndaj një institucioni që na ka bërë aq krenar viteve të fundit, siç është Policia.

Edhe një herë po e theksoj, jam kundër idesë që rastet e tilla të vijnë me nguti në Kuvend për t'i diskutuar. Dhe, jam kundër idesë që të gjitha rastet që ndodhin, i përmendën kolegët e nderuar

shumë raste, edhe në sektorin privat, se ne kemi informacione se ka abuzime, ka shantazhe për pozicione të ndryshme, le të adresohen pra në vendin e duhur, te organet kompetente dhe i ftoj që mos ta humbim besimin te organet e policisë, sepse në polici kemi vajza dhe djem të shkëlqyeshëm. Pra, t'i dallojmë sepse sot po shihet që ata me të vërtet kanë arsye edhe të jenë të lënduar, edhe të prekur, sepse ka një revoltë qytetare që është e arsyeshme, mirëpo këtu pastaj ne nuk dimë t'i dallojmë. D.m.th. i akuzojmë në grup, komplet. Po ne dimë dhe të gjithë këtu jemi krenuar me hapat gjatë këtyre viteve që i ka bërë Policia e Kosovës, me zhvillimin e tyre. Edhe sot po duket sikur nganjëherë po i përgjithësojmë.

Ndiej keqardhje për vajzën e mitur, të keqpërdorur sigurisht, edhe si nënë edhe si grua, si qytetare e këtij vendi. Ndihem edhe më keq që ky abuzim ka ndodhur nga njerëz që normalisht që ishte dashur të mbrohet viktimja. Ndihem keq si nënë dhe si grua, duke e ditur edhe mentalitetin që ne dimë t'i keqpërdorim pastaj këto fatkeqësi edhe iu lëmë nam atyre familjeve duke u munduar t'ju ndihmojmë. Pra, kush s'e mori vesh, krejt bota e mori vesh. Nganjëherë një fjalë popullore thotë shumë mirë, bjer e sill vetes. Sa informacione edhe më të rënda ndodhin në shtetet e tjera, shkojnë e i mbulojnë, ne sot kur e shoh tash në portale. Edhe gazetatat franceze që kanë skandale njëqind herë më të mëdha, sot e përdorin rastin e Kosovës. Pra, po mendoj që kish qenë dashur të jemi racional se krejt në fund do të na faturohet neve si shtet, s'i faturohet veç një grupi politik, po si shtet të gjitha këto. Po ne, nëpër organizata ndërkombëtare jemi duke e çuar zërin shumë, me të drejtë për rastet e ndodhura të dhunimeve e të tjera. Po mendoj që pak e kemi pasur të ngutshme këtë seancë.

Kemi të bëjmë me shumë vetëdije e them, me një rast, jo një fenomen. Pra, mund të ketë disa raste, po kjo nuk është shndërruar në fenomen. Sepse derisa ndodh gjithë kjo tronditje popullore, po shihet pra që ne nuk jemi mësuar me këto, sepse prej fillimit, secili në familjen e vet e ushqen një ndjenjë të respektit, edhe të kujdesit, e ne kemi edhe të tilla raste fatkeqësisht. Edhe në familje ndoshta, edhe nënat të cilat nuk e kanë asnjë edukim, një arsimim bazë, e ndoshta këtu ne kemi më së shumti nevojë të fokusohemi, që të shohim nëpër vendet rurale, ku nuk ka një edukim bazë të nënave që t'i mësojnë, thjesht ka organizata të ndryshme, edhe e kemi Qeverinë edhe ministrinë përkatëse t'i edukojnë nënat e tyre sesi t'i edukojnë vajzat në moshën minorene. Sepse ne i pamë deklaratat e dhimbshme nëpër televizione. Unë i kuptoj dëshirën e medieve për të pasur sa më shumë shikueshmëri, por aq shumë është keqpërdorur në detaje biseda me nënën, në rastin në fjalë që nuk ka koment.

Pra, të gjithë ju mësuat, mjekë, policë që jeni duke na përcjellë, kuptona sepse revolta është qytetare, normale, sepse është një rast i ndjeshëm, po assesi mos mendoni se ne i përgjithësojmë këto raste. Pra është një individ që presim të gjykohet sipas veprës së bërë, por respekti edhe besimi në ju nuk ka humbur as nuk është lëkundur. Unë i ftoj të gjitha vajzat edhe gratë në vendin tonë, në raste të tilla që patjetër të adresohen te organet kompetente, sepse aty kemi njerëz

që janë të përgatitur profesionalisht t'i trajtojnë këto raste. Po ashtu, kujdesin mendoj që ne kemi nevojë si deputetë ta shtojmë te ligjshmëria, po e shohim që kemi mungesë.

D.m.th. mund t'i plotësojmë këto pjesë, sepse prej sot na dalin tash ide të reja se çka neve na mungon si ligjvënës. Çka nuk kemi plotësuar që mos të ndodhin në të ardhmen. Mirëpo, jo vetëm në polici, por çdo institucion publik, shkolla, çerdhe, vende ku mund të ketë më shumë mundësi për abuzime të tilla, unë i ftoj të gjithë ata qytetarë, ata persona publikë, zyrtarë publikë, që mos t'i neglizhojnë këto raste nëse kanë ndonjë informacion se mund të ketë predispozita në një nga këta zyrtarët që të bëjë vepra të tilla. Pra, më mirë është të bëhet një parandalim sesa të reagohet tash kur të ndodhë.

Po ashtu, edhe një herë e theksoj që ky rast mund edhe të tejkalojë në trauma te shumë të reja dhe të rinj, që nëse adresohet për një rast të tillë, atëherë mund të abuzohet, por besimi në policinë tonë assesi nuk guxon të humbë. Unë përshëndes shumë nga fjalimet e deputetëve sot në sallë, edhe besoj që në fund prej tyre do të nxjerrim diçka të mirë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shemsi Syla.

SHEMSI SYLA: E nderuar kryesuese!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dy dekada pas luftës, shoqëria jonë, ende pa arrirë t'i mbyllë plagët dhe lëndimet e shumta të shkaktuara nga lufta dhe periudha gjatë okupimit, po përballet me një fenomen që paradoksalisht na rikthen në gjenezë të problemit, atë të abuzimit dhe keqtrajtimit seksual ndaj të miturve dhe kategorisë më të pambrojtur të shoqërisë, vajzave dhe motrave tona në shkolla, në institucione të tjera, si në polici, prokurori, shëndetësi e të tjera. Ky problem ka marrë përmasa shqetësuese, sepse nga informata e para të dala publike në rastin e Drenasit del se faktori, sado që në aspektin e trajtimit juridik e penal mund të konsiderohet individual, ne si shoqëri nuk duhet ta trajtojmë si të tillë, sepse në fakt nuk është i tillë. Atë çka përjetuar vajza fatkeqe nga Drenasi është më tepër se një, dy apo më shumë vepra penale, kur dihet se në këtë rast janë të implikuar njerëz nga katër institucione të rëndësishme shtetërore.

Përgjegjësia penale e juridike e personave të implikuar në rastin as që ishte dashur të diskutohej sikur të kishim një sistem të besueshëm dhe kredibil, por fatkeqësia vjen nga fakti se kemi të bëjmë me një sistem të tërë, i cili përveç që është i politizuar, gjithnjë e më shumë po na jep shenja se i njëjti është edhe i kriminalizuar, dhe se krimi ka krijuar rrjedhë zinxhirore të veprimit në institucionet tona. Besimi i qytetarëve në këto institucione ka rënë përfundimisht, e lëre më vajzën fatkeqe dhe familjen e saj, të cilët nuk dinë më kah t'ia mbajnë. Kjo seancë e jashtëzakonshme e thirrur për këtë rast, pasi nuk mund të rregullojë këto defekte kaq të mëdha

institucionale, sepse vërtet janë skandaloze. Mirëpo, në të njëjtën kohë tregon gjendjen se ku kemi ardhur si shoqëri. Kemi ardhur në situatë ku i gjithë debati është shndërruar në shoqëri se kush po i rrit pagat dhe koeficientët më shumë në arsim, në shëndetësi, drejtësi e siguri dhe nuk po merren me atë se çka në thelb kemi ndërtuar, çka kemi shkatërruar. Kapja e sistemit dhe abuzimi me detyra shtetërore nuk është vetëm një frazë të cilën pozita dhe pushteti i parashtruan opozitës dhe zërit të pakënaqësisë qytetare. Fatkeqësisht, është fakt të cilin nuk e dëshirojmë as ne e as qytetarët. Përkundër fatkeqësisë së vajzës 16-vjeçare dhe familjes së saj, ne do të kishim dashur ta cilësojmë si rast të izoluar, por faktet tregojnë se gjërat e tilla kanë ndodhur dhe po ndodhin në vazhdimësi, duke degraduar gjithnjë e më shumë institucionet dhe besimin e qytetarëve në to. Implikimi i profesorit, policit, prokurorit dhe mjekut janë sinjale q tregojnë se këtu nuk bëhet fjalë për individin, por për një sistem të kalbur dhe të zhytur në krim.

Mbase në rastin e trajtimit individual, këta edhe mund të marrin dënimin e merituar, por ku po mbetet përgjegjësia institucionale. Deri më tani nuk kemi parë asnjë veprim, apo lëvizje jo vetëm ligjore, por as morale, që në vendet normale as që do të diskutohej. Është e pashpjegueshme që për rastin është ditur që nga viti 2016 dhe është heshtur, duke tentuar të mbulohet dhe të fshihet gjithçka e keqe që ka ndodhur. Ishte guximi qytetar i avokatit dhe medias që kanë bërë publike rastin, sepse me këtë sistem dhe njerëz të kriminalizuar në sistem as që do të kishin ditur se çfarë krimi bëhet dhe mbulohet, ashtu siç jemi të bindur se heshtet dhe mbulohen edhe sa e sa krime të tjera. Kjo heshtje është vrasare dhe e rëndon peshën e saj. Institucionet pa dyshim mbajnë përgjegjësinë kryesore për neglizhimin, mbulimin, shfajësimin e krimin të të gjitha llojeve, por kësaj radhe të krimin si ky seksual. Megjithatë edhe shoqëria nuk duhet ulur kokën. Një protestë nuk mjafton. Është thjesht një shkëndijë që shuhet brenda pak ditëve.

Të nderuar deputetë,

Mbi të gjitha burimi i këtij turpi të madh të Kosovës është vetë pushteti, edhe ai i gjithë pasluftës që ishte. Njerëzit në pozita, qoftë edhe mësues që udhëheq klasën, një polic që drejton hetimin, një zyrtar në krye të kompanisë, një ministër apo një deputet që përfaqëson popullin e shpërdorojnë rregullisht fuqinë shtetërore.

Sa favore seksuale kërkohen dhe ofrohen në këmbim të një vendi të punës, apo të pozitës më të mirë. Nëse nuk e pranojmë realitetin, nuk mund ta ndryshojmë gjendjen assesi. Dënimet nga krimet të të gjitha llojeve duhet të ashpërsohen dhe shteti duhet të krijojë dhe të hartojë strategji për këtë. Përndryshe, pakënaqësia qytetare po rritet, gjithnjë po rritet, ajo është para një shpërthimi. Prandaj i bëjmë thirrje Qeverisë dhe institucioneve relevante që të marrin masa ndaj këtyre dukurive negative të kësaj shthurje sistematike institucionale dhe dëmit që po i bëhet rinisë shqiptare. Në këto momente më të rënda dhe më delikate që po kalon vendi jonë, e që mund të ketë pasoja të pariparueshme në prag të një projekti shumë më ogurzi që po i përgatitet Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit deputet! Fjalën e ka deputeti Fisnik Ismajli, nuk është prezent. Dukagjin Gorani nuk është prezent. Tani shkojmë me rend. Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit e nderuara kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju deputete,

I nderuar ministër,

Nuk di a ka temë më të ndjeshme dhe më të rëndësishme sesa kjo sot dhe Qeveria absolutisht nuk janë këtu ministrat, as kryeministri dhe është temë jashtëzakonisht e ndjeshme dhe besoj që të gjithë e kanë pasur obligim moral të jenë sot këtu në vendet e tyre. Realisht të gjithë ne jemi të tronditur me rastin e abuzimit seksual të një vajze të re dhe më së shumti janë të prekur nënat, sepse secila nënë besoj që sot është para ekranit televiziv dhe e parandjen këtë skenë apo këtë tragjedi që i ka ndodhur kësaj familje. Realisht këtu prej shumë deputetëve dhe kolegëve të mi u thanë shumë çështje, po mundohem që më shkurt, që mos të përsëritem dhe po kaloj fillimisht te rekomandimet, ku besoj që njëra prej këtyre rekomandimeve që tani unë do t'i them sot do të merret parasysh. Unë mendoj që menjëherë duhet të ndahet një linjë buxhetore për punësimin e më shumë psikologëve dhe pedagogëve nëpër shkolla, sepse ka herë në këtë Kuvend në këtë foltore, e kam ngritur zërin unë bashkërisht me kolegët e mi që të shtohet numri i pedagogëve dhe psikologëve, sepse është më se i domosdoshëm të shtohet numri i pedagogëve dhe psikologëve nëpër shkolla, sepse të rinjtë dhe të rejtat tona e kanë më lehtë t'u drejtohen psikologëve dhe pedagogëve dhe psikologu normalisht që dinë të trajtojë më mirë këto raste të ndjeshme. Të bëhet një linjë falas telefonike ku raportohen rastet dhe të gjithë ata të cilët mund ta lajmërojnë policinë apo organet kompetente të kenë një linjë telefonike falas, apo edhe të obligohen të gjitha shkollat që të kenë kutitë e ankesave, që dorëzohen ankesat në ato kuti dhe të jenë të obliguar drejtorët e shkollave të merren më seriozisht me këtë temë.

DKA-të kanë nevojë normalisht edhe për buxhet më të madh, sepse buxheti absolutisht s'ka qenë i mjaftueshëm për DKA-të e komunave ku vesoje shumë që ata duhet ta marrin shumë sinqerisht këtë çështje dhe të organizohen trajnime vetëdijesimi në lidhje me këto çështje dhe të vetëdijesohen të rinjtë tanë, sepse neve si çështje, si shoqëri na duhet një vetëdijesim më i gjerë edhe në pjesët rurale edhe urbane, po sidomos në pjesët rurale dhe besoj që gradualisht me investimin e këtyre trajnimeve dhe me mbajtjen e këtyre trajnimeve, të vetëdijesohen qytetarët tanë. Rekomandimi tjetër i radhës është që në procesin mësimor të shtohet ora e edukatës seksuale, ku këtë orë të edukatës seksuale, një herë një javë d.m.th. fëmijët tanë të kenë edukatë seksuale mund të mbajnë mësimdhënësit e biologjisë, psikologjisë, sociologjisë po pse jo edhe të edukatës qytetare.

Unë besoj që me mbajtjen e këtyre orëve, do të investojmë dhe do të vetëdijesohen më tepër të rinjtë tanë. Të mos skandalizohet dhe të mos merren e nëpërkëmben të gjithë mjekët, të gjithë policët dhe të gjithë mësimdhënësit. Unë jam më se e bindur sepse rastet individuale nuk duhet të përgjithësohen, sepse ne kemi mësimdhënësit jashtëzakonisht të mirë, ku kanë ditur ta mbajnë

mësimin shqip në kushtet më të vështira e lëre më në këto kushtet të cilat sot mbajnë mësimin. Kemi policë jashtëzakonisht të mirë dhe kemi mjekë të shkëlqyeshëm në Republikën tonë, që nuk domethënë që të gjithë të jenë njësoj dhe të jenë të barabartë me raste individuale ku p.sh. është fjala për rastin e kësaj vajzës. Të investohet edhe në qendra për mbrojtjen e personave të abuzuar seksualisht duke ndërtuar objekte të tilla, duke bashkëpunuar edhe me organizatat joqeveritare, profesionale për ofrimin e ndihmës psikologjike të këtyre personave të mbijetuar apo të prekur, apo të abuzuar. Të mos harrojmë se skandalet e abuzimeve seksuale ndodhin kudo dhe kurdo edhe nëpër vendet e tjera. Ne si shoqëri d.m.th. është më pak kjo dukuri e theksuar në Republikën tonë, meqë kaq shumë është bërë debat për këtë vajzë, besoj që ky debat do t'i shërbejë vetëdijesimit të shumë të rinjve dhe edhe te të tjerë të cilët janë të abuzuar dhe nuk i kanë raportuar rastet, i motivoj dhe është një stimulim shtesë që ata të shkojnë dhe të raportojnë raste. Unë i përgëzoj edhe protestat e organizuara të qytetarëve tanë në mbrojtje të këtyre vajzave apo djemve apo të rinjve tanë të cilët abuzohen. Kjo dukuri nuk ka filluar në këtë qeveri dhe nuk mbaron me këtë Qeveri dhe prandaj kjo seancë duhet të na shërbejë dhe të na bëjë bashkë pozitivë e opozitë. Të gjithë bashkërisht të dalim me rekomandime të cilat menjëherë të fillojmë t'i implementojmë rekomandimet e dala nga ky Kuvend dhe të marrin masa konkrete.

Në gjithë këtë proces unë besoj, dua të besoj në Prokurorinë dhe në Gjyqësinë tonë, në sistemin gjyqësor, po i kisha bërë thirrje prej kësaj foltoreje të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të merren sinqerisht me këtë rast dhe të mos kenë anime, sepse ky rast nuk e ka prekur një parti apo tjetrën, po i ka prekur të gjithë qytetarët e Republikës sonë. Të gjithë të rinjtë dhe në veçanti nënat të cilat sigurisht që janë ndjerë keq me këtë rast. Dhe unë bashkërisht me kolegët e mi do të kontribuojmë për rekomandime, dhe si Komision i Arsimit do të bashkëpunojmë edhe më ngushtë me Ministrinë e Arsimit që kjo dukuri të eliminohet apo edhe të zvogëlohet në atë masë sa ne mundemi dhe e ushtrojmë detyrën tonë si deputet që jemi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit kryesuese!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë!

Ministër i pranishëm,

Kur merren fjalën pothuajse kah fundi i debatit, natyrisht që të rasti të dëgjosh lloj-lloj diskutimi po edhe mund të përsëritësh me ndonjërin nga kolegët deputetë. Nuk është e lehtë për asnjërin prej nesh që sot të debatojmë kaq gjatë për një temë që ndoshta më herët ka qenë tabu, e ana pozitive e saj është që kjo temë të mos jetë tabu. Me rastin e aktivizimit të tërë shoqërisë dhe institucioneve. Ajo që dëshiroj që në fillim të them se nuk më pëlqen fryma e disa individëve, e kolegëve të mi deputetë, që ishin shumë pak fatbardhësisht në Kuvendin e Kosovës që mbajtën një pozicionim hipokrit. Hipokrizia nuk të vret, prandaj lirshëm flasim për moralin, për veprimet, madje edhe gjuhën diskriminuese, disa kampione ose kampione të përbuzjes, të abuzimit mendor e fizik ndaj vajzave të reja që i quajmë aktiviste.

Kjo është që është pranuar edhe publikisht nga njëri nga liderët e partisë që sot është në Kuvend. të gjithë e dimë për kë e kemi fjalën.

Prandaj, kolegë dhe kolege të dashur, të mos e përdorim të drejtën dhe këtë foltore të drejtën e fjalës për lojëra të ulëta politike, është më e pakta që na duhet sot në këtë debat.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës që na dëgjoni sot këtu.

Unë sot në cilësinë e deputetes po edhe në cilësinë e një gruaje dhe një nëne shprehi indinjatën time të thellë për rastin në fjalë dhe nuk është rast i vetëm e thanë shumica këtu që anë e këndë Kosovës po jo vetëm të Kosovës kemi kudo edhe në Evropë, edhe në botë.

Trajtimi shumë serioz dhe me përgjegjësi të lartë profesionale nga institucionet kompetente për zbardhje deri në detaje këtë rast dhe që aktorët të marrin dënimin e merituar është detyrë institucionale dhe shoqërore. Në të njëjtën kohë uroj që kur të mos ballafaqohemi me raste të tilla.

Sot pra është thirr kjo seancë e jashtëzakonshme me një temë kaq të ndjeshme që bëri bujë të madhe në Kosovë, ndonëse edhe vetë kam pas dilemën time të përfshihem në këtë debat sot po sidomos të përmbahem nga përkufizimet e këtij fenomeni.

Megjithatë, unë nuk mundem pa e përmend që fatkeqësisht ky nuk është dhe nuk duhet të trajtohet dhe të limitohet si rast abuzimi i një të miture.

U desh që një vajzë e cila mori përsipër barrën e paragjykimeve për ta ngritur ndërgjegjen qytetare dhe më kryesorja atë institucionale nga që të nderuar kolegë të mos bëhemi hipokrit, fenomeni i përuljes ndaj gjinisë femërore, ngacmimeve në shkolla, në punë, institucione dëgjojmë jo pak herë edhe atë çdo ditë.

Kjo jo për ta relativizuar këtë situatë të shëmtuar asnjëherë, mirëpo ky rast vjen si pasoj e injorimit të vazhdueshëm që ne si shoqëri i kemi bërë fenomenit të dukshëm, atij të nënshtimit, përbuzjes dhe mospërkrahjes ndaj vajzave, motrave dhe kolegeve tona.

Vajza në fjalë, rastisi të jetë një zë i gjithë atyre vajzave të reja që përditë ngacmohen, fyhen dhe përulën emocionalisht edhe fizikisht në rrethe të ndryshe por që nuk kanë guximin e duhur ta thonë me zë.

Ndryshimi duhet të nisë në rrënjë që në mentalitetin tonë, natyrisht dhe pakontestueshëm ky ndryshim s'bëhet i mundshëm pa implementimin, pa përgjegjësinë institucionale e institucion është edhe familja po edhe shteti natyrisht. Pa gjykim të keqbërësve të fenomenit, pa mëshirën as më të vogël ndaj tyre.

Reagimi i qytetarëve që ndodhi masivisht këto dy ditë dje në Prishtinë dhe sot në Drenas, natyrisht që e tregon një vetëdije dhe një ndërgjegje të lartë të shoqërisë, mirëpo këtë reagim nuk duhet të lejojmë që ta njollosin disa element duke përbaltosë institucionet tona shumë kredibile siç është Policia e Kosovës duke i gjuajt me vezë, duke i fye e kështu me radhë.

Një njollë e zezë nuk do të lejojmë ta nxijë faqen e bardhë të mësuesit, të policit të ndershëm, nuk është shumë larg që një polic ra në krye të detyrës duke i ndjekë kriminelët dhe hajnat të cilët terrorizuan qytetarë.

Natyrisht nuk duhet të njollos edhe mantelbardhin tonë shumë të ndërgjegjshëm.

Natyrisht që një koleg i im deputet më pëlqej që tha këta shkelës janë pakicë absolute dhe vërtetë janë pakicë absolute.

Dhe, ne duhet t'i izolojmë me përkushtimin tonë të përditshëm kudo që jemi edhe si individ edhe si institucione.

Të nderuar,

Mendoj se secili nga nëpunësit publik pavarësisht institucionit ku punon duhet të ngritë nivelin e përgjegjësisë në punë dhe të mos bie ndesh e ligësive që janë veprime të paligjshme të pandërgjegjshme gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.

Gjithashtu, mendoj se duhet që të kemi vlerësim real të performansës për zyrtarët si në sektorët e policisë, të arsimit, shëndetësisë ashtu edhe në Prokurori e gjykata dhe në të gjitha institucionet tjera publike si dhe në ato private të cilat janë të autorizuara për kryerjen e shërbimeve publike.

Ne si deputetë duhet kërkuar dhe inkurajuar institucionet kompetente që të hetojnë deri në detajet e fundit, jo vetëm rastin në Drenas, po edhe rastet tjera anekënd Kosovës dhe të zbardhet e vërteta.

Veprimet efikase dhe profesionale të drejtësisë duhet të jenë shembulli më i fuqishëm si në parandalimin e rasteve të tilla, ashtu edhe në gjykimin e drejtë dhe të shpejtë të aktorëve. Ne absolutisht nuk duhet të lejojmë që individët apo rastet individuale ta shkatërrojnë imazhin e institucioneve tona dhe të shoqërisë sonë.

Me këtë rast apeloj tek të gjitha familjet që të rrisin përgjegjësinë e vrojtimin dhe bashkëpunimit të ngushtë me fëmijët e tyre, me shkollat dhe institucionet tjera relevante, sepse në këtë mënyrë do të arrijmë të parandalojmë çdo dukuri të dëmshme për fëmijët.

Po ashtu mendoj se ky bashkëpunim duhet të vijë në shprehje në kontinuitet, sepse të rinjtë tanë sot sfidohen shumë, si rezultat i ecjes së teknologjisë dhe rrjeteve sociale.

Të nderuar kolegë,

Ne duhet të kërkojmë më shumë njohuri e informacione profesionale të cilat ushtrohen nga profesionistët e që nëpërmjet programeve edukative në shkolla, aktiviteteve me të rinjtë dhe programeve mediale të ndikojmë në ngritjen e dijes dhe vetëdijes së të rinjve që të mos bien pre e provokimeve eventuale nga çdolloj dukurie negative.

Fuqishëm mbështesë çdo propozim që vjen ngase në shkollat tona është dashur që moti që në fillimet e pasluftës të kenë pedagogë dhe psikologë, edhe ashtu gjithmonë shkollat kanë pasur pedagogë dhe psikologë edhe pse në kohën time psikologët na kanë pyetur se a jemi kundërrevolucionar apo çka veprojmë.

Sidoqoftë, e kanë pasur edhe një efekt pozitiv sepse ka pasur prej tyre që vërtetë e kanë kryer detyrën me nderë në edukimin e brezit të ri.

Në fund, uroj që ky guxim i vajzës nga Drenasi që ka hapur sytë, të na shërbejë për reflektim. Të fillojë një stop i paluajtshëm dhe zero tolerancë që të gjitha ngacmimet e çfarëdo natyre dhe akteve tjera të ulëta për çdo ditë gratë dhe vajzat tona përjetojnë gati në secilin cep të përditshmërisë së tyre në secilin kënd të përditshmërisë sonë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Arbërie Nagavci, urdhëroni!

ARËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesuese!

Është shumë e rëndësishme që ne sot të flasim në mënyrë jo vetëm të sinqertë, por duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijëve, dhe disa prej nesh këtu nuk e bënë këtë gjë.

Rasti i dhunimit seksual të vajzës sonë, sepse ajo është një vajzë e këtij vendi, mund të ishte vajza e cilësdo prej nesh, i cilitdo prej qytetarëve të këtij vendi, thjesht tregon të vërtetën për institucionet që ne i kemi krijuar, për shtetin të cilin kemi dështuar ta krijojmë dhe nuk duhet të shprehemi apo të bëjmë thujse është një rast individual, një rast që është përjashtim prej realitetit të përditshëm.

Ky rast po diskutohet sot, vetëm sepse ky u bë i ditur. Domethënë të gjithë jemi dëshmitarë që diskutimi u bë për shkak se vajza e mori vet guximin përkundër asaj se nuk kishte gjetur përkrahje nga institucionet që do duhej ta mbështesnin.

Personalisht mua, pro besoj që edhe shumë të tjerëve këtu, prej dje deri më sot më kanë ardhur shumë mesazhe private të vajzave e të grave, po edhe të mësimdhënësve nga shkollat të cilët lutën që t'i adresojmë problemet të cilat ata i kanë për çdo ditë.

Unë do të përmend dy mesazhe nga disa që kam marrë. Është një nënë e cila e tregon se e ka pasur rastin e njëjtë me vajzën e saj para tri viteve, diku rreth tri viteve. Është një zonjë me emrin G që më shkroi sot, e cila tregon që përkundër se ka dërguar dëshmi të mjaftueshme në gjykatë dhe e ka raportuar rastin me kohë, i akuzuari është shpallur me 1 vjet dënim.

Sipas saj është shpallur jo plotësisht i fajshëm ngase është dënuar vetëm 1 vjet, ndërkaq pa kaluar 1 muaj të njëjtin e ka parë në qytet.

Pra, është një dështim i institucioneve tona që po ndodhin në mënyrë të përsëritur në plotë raste të tjera.

Po ashtu, dua të përmend sot këtu një rast të cilin e kam të njohur mirë, sepse personalisht atë e kam kuptuar prej kohës sa kam qenë drejtoreshë e Arsimit në Komunën e Prishtinës, kur kemi pranuar ngacmimet, kam kuptuar për ngacmimet që një mësimitdhënës i ka bërë ndaj një nxënëses po ashtu të shkollës fillore.

Ne e kemi suspenduar menjëherë. Nuk e kemi bërë shumë publike këtë çështje, sepse është obligim yni që të kujdesimi për mirëqenien e vajzave, përkatësisht viktimave në këtë rast, dhe e kemi paraqitur rastin te organet kompetente dhe në hetuesi. I kemi ndërprerë marrëdhënien e punës, kontratën e punës të rregullt të këtij mësimitdhënësi, pas gjashtë muajve ashtu siç e parasheh ligji.

Unë në atë kohë kam kuptuar se ky mësimitdhënës e ka një të afërme të veten familjare që punon në polici. Për shkak të ndërhyrjeve që i ka bërë, sot më njoftojnë se ky mësimitdhënës nga Gjykata e Shkallës së Parë është shpallur i pafajshëm me arsyetimin apo me argumentet se vajza nuk ka ofruar prova të mjaftueshme.

Më thoni sot, a ka ndonjë vajzë të mitur apo familje që do ta akuzonte dikë me ndonjë qëllim cili do të ishte ai qëllim që do t'i mundësonte dikujt që të shpifte apo të fliste se kinse ka pasur abuzime seksuale.

Duke filluar prej kolegëve të atij mësimitdhënësi, kërkoj nga ju sot që nëpërmjet fjalës time adresoj shqetësimet e një numri të madh të mësimitdhënësve të cilët punën e tyre e bëjnë me ndërgjegje, por të cilët nuk kanë hapësirë që të shprehin gjithë profesionalizmin e tyre, apo trajtohen të gjithë të barabartë, pikërisht për shkak të mosfunksionimit, gjegjësisht të veprimit kriminal të institucioneve tona.

Në këtë vend, krimi mbi vajzat e mbi gratë në përgjithësi mbi të dobëtit është bërë i zakonshëm. Nuk pajtohem me atë që e thanë disa deputet këtu, se po flasim për raste individuale apo të veçuara. Fatkeqësisht, rastet janë të shumta e të shpeshta. Ndryshe prej vendeve të tjera ku krimi

ndodh nga kriminelët në plotë vende dhe në plotë raste, por janë institucionet ato që do duhej të siguroheshin që kriminelët të marrin dënim e merituar dhe jo që dhuna të vazhdojë në mënyrë institucionale.

Rasti që ka ndodhur, që u raportua dhe për të cilin po diskutojmë, është një situatë krejt tjetër kur ne nuk mund të themi se kemi të bëjmë vetëm me përgjegjësi individuale personale, sepse ata persona e kanë keqpërdorur pozitën e tyre për të abuzuar me një të mitur. Pra, nuk është diçka që ka ndodhur jashtë institucioneve.

Ata pikërisht pse kanë qenë pjesë të institucioneve e kanë keqpërdorur atë pozitë për të abuzuar me një të mitur. Në raste të tilla është shumë e rëndësishme që t'i kushtojmë vëmendje, jo vetëm dënimin të merituar të të gjithë atyre që kryejnë krime, por që t'i kushtojmë kujdes asaj ku tashmë që është e qartë që kemi dështuar; edukimit të mirëfilltë që duhet t'ju japim fëmijëve tanë.

Në shkollat tona, u përmend edhe nga kolegët tjerë, që s'ka pedagogë e psikologë. Mësimdhënësit përkundër dëshirës dhe vullnetit të mirë, mund të ndodhë që të jenë jo kompetentë për t'ju ndihmuar fëmijëve që të kalojnë sfidat apo brengat që ata i kanë, qoftë për shkak të moshës, qoftë për shkak të abuzimit, qoftë për shkak të rasteve edhe më të ndjeshëm se ky, kur mbi ta ushtrohet një dhunë e drejtpërdrejt nga ata që do duhej t'i mbronin faktikisht.

Është shumë e papranueshme që akoma në shkollat nuk i kemi këto shërbime profesionale. Nuk duhet ta harrojmë faktin se ky Kuvend e votoi një ligj të buxhetit i cili e ka në vetvete edhe shumën prej 53 milionë eurove që do t'i falen Bechtel-Enkas, dhe duket se do të falen edhe 60 milionë euro të tjera, por akoma nuk kemi gjetur mjete që të sigurohemi që në secilën shkollë tonë të kemi pedagogë e psikologë të cilët do t'ju ndihmonin nxënësve, do t'ju ndihmonin fëmijëve që të jenë të sigurt dhe ta keni edukimin e duhur. Të dinë të vetëmbrohen dhe të jenë të vëmendshëm për të mirën dhe mirëqenien e tyre.

Këtë fakt e përmendi edhe Avokati i Popullit i cili e ka referuar disa herë në raportet e veta rëndësinë e pasjes së pedagogëve dhe psikologëve në shkolla, dhe kjo nuk është marrë parasysh.

Duhet pasur kujdes se në këtë situatë në të cilën jemi nuk i është kushtuar pothuajse aspak kujdes gjendjes emocionale dhe psikike, jo vetëm të asaj vajze, por madje edhe të familjes së saj, të shokëve dhe shoqeve dhe të gjithë rrethit të cilët mund të jenë të shqetësuar pa të drejtë për shkak të reagimeve të shumta.

Madje, kur po flitet për familjen, duhet pasur parasysh se është vet shteti i cili duhet të plotësojë edhe zbrazëti që familjet mund t'i kenë në edukimin e fëmijëve të tyre.

Jo në të gjitha rastet, secili prind është vetëdijshëm se cila është më e mira për të vepruar në një situatë të ndjeshme sikurse kjo për fëmijën e tij. Andaj, pikërisht në këto raste vjen në shprehje ndikimi, gjegjësisht intervenimi i shtetit ku i ndihmon fëmijët që të jenë të kujdesshëm, të marrin edukimin i cili është i nevojshëm për ta.

Mendoj se ky është momenti i fundit, madje jemi vonë, kjo seancë nuk është thirrur me urgjencë. Kjo seancë është thirru shumë vonë, pasi që ka ndodhur një rast, e do duhej që ne të merreshim para së ndodhte ngjarja.

Mendoj që është shumë e rëndësishme dhe propozoj që më së largu tre muaj prej sot, Qeveria ta aprovojë vet dhe ta sjellë në këtë Kuvend, një plan të detajuar dhe gjithëpërfshirës për angazhimin në fushën e sigurimit të fëmijëve. Pra, të planifikojë të gjitha aktivitetet dhe të harmonizojë strategjitë, planifikimet që i kanë në fuqi, legjislacionin, por le të sjellë një dokument i cili tregon të gjitha aktivitetet konkrete të cilat ata do t'i marrin në raport të ruajtës së sigurisë për secilin fëmijë, meqenëse janë shtresa më e ndjeshme e kësaj shoqërie.

Po ashtu, kërkuj dhe e insistoj që Ministria e Arsimit së paku dy herë në vit të raportojë në Kuvend për çështjen e sigurisë së fëmijëve në shkolla.

Pra, është përgjegjësi e ministrisë që t'i rishikojë edhe njëherë politikat ekzistuese, por po ashtu të planifikojë edhe aktivitete të tjera të cilat kanë të bëjnë me vetëdijesim e fëmijëve për të gjitha çështjet që janë në interes të shëndetit të tyre emocional, fizik, psikik dhe më gjerë.

Në situatën kur sot kemi akoma mësimdhënës të cilët ndodh që nuk e kanë përgatitjen e duhur në këtë drejtim, ministria duhet të gjejë mundësi që këto çështje t'i ofrojë, qoftë edhe në bashkëpunim me organizata apo me partnerë të tjerë.

Pra, është shumë e rëndësishëm edhe fakti që të sigurohemi që në secilën shkollë të kemi pedagogë e psikologë, sepse ne nuk kemi fëmijë për të abuzuar të tjerët me ta.

Po pajtohem, e kemi respektin maksimal për mësimdhënësit. Për mjekët. Për policët. Për të gjithë punëtorët publik të cilët e kryejnë me nderë, përgjegjësi dhe profesionalizëm punën e tyre, por po ashtu kemi reagimet më të ashpra dhe aspak tolerancë për të gjithë zyrtarët të cilët janë të kriminalizua e të korrumpuar dhe shfrytëzojnë pozitat për të keqpërdorur me fëmijët apo me ata për të cilët i kemi dhënë besimin.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Arban Abrashi, urdhëroni!

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesuese!

Rasti i keqtrajtimit të 16-vjeçares tani shpërfaqur në publik, nga ata që do duhej ta edukonin, përgatitnin për jetë, nga ata që do duhej ta mbronin dhe t'i ofronin garanci për një jetë normale, tregon në formën më mizore se sa poshtë kanë rënë vlerat dhe besimi i kësaj shoqërie.

Prandaj, mendoj se duhet të flasim. Ta ngremë zërin. T'i tregojmë edhe viktimës se nuk është vetë dhe se viktima ka mbështetje, në këtë rast të Kuvendit dhe të Kosovës.

Fatkeqësisht, korrupsioni është bërë normë. Korrupsioni është bërë standard, e kur kjo mbizotëron, rastet e tilla janë të pashmangshme, sepse disa nga ata që do duhet të zbatojnë ligjin, nga ta që do duhej të edukojnë, disa nga ata që janë të betuar për ta mbikëqyrur respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, e drejtësisë sociale, kanë shkëlur vet mbi parimet e veta.

Ndërtimi i shoqërisë së shëndoshë e të drejtë, nuk po e merr vëmendjen që i takon. Nuk po e kemi guximin e duhur institucional e shoqëror që ta kthejmë besimin tek të gjithë të prekurit nga korrupsioni dhe nga dhuna e politizimi i secilës hallkë shoqërore.

Guxim ky që po na mungon të ndërtojmë shtet dhe të kthejmë vlerën e dinjitetit si vlerë e pa kompromis e shoqërisë sonë

Sipas të gjitha gjasave, ky edhe mund të mos jetë një rast i vetëm, por vetëm një nga rastet që doli në sipërfaqe e i cili paraqet fatkeqësi për shoqërinë dhe shtetin e ri të Kosovës.

Thënë ndryshe, përderisa si shoqëri kemi arritur që relativisht shpejt të ngrihemi nga shkatërrimet masive të luftës, kur vjen tek ndërtimi i vlerave, dinjitetit e shtetndërtimi jemi duke çaluar, por nuk bën të dorëzohemi.

Secili nga ne, njerëz të mirë të këtij vendi nuk duhet të dorëzohen e në veçanti ata që punojnë në institucione dhe kanë mundësi të bëjnë ndryshimin. E kemi për obligim që të provojmë të bëjmë më shumë sesa kërkojnë ligjet. Më shumë sesa mundësojnë kapacitetet tona.

Gjithashtu, nuk duhet të krijojmë iluzionin për një reagim të shpejtë dhe zgjidhje të menjëhershme, por duhet të punojmë dhe t'i trajtojmë këto tema e sfida deri në themel.

Jo vetëm të prekurit e drejtpërdrejt kanë nevojë për përkrahje. Viktimat e dhunës, por edhe familjarët e tyre kanë nevojë për ndihmë derisa në të njëjtën kohë duhet bërë çmos që secili qytetar i Kosovës të besojë që drejtësia duhet të arrijë deri te secili i përfshirë.

Në këtë kohë e për këtë rast të veçantë duhet të angazhohemi në disa drejtime, por duhet pasur kujdes për viktimën. Viktima në këtë rast nuk ka nevojë për stigmatizim të mëtutjeshëm, duke përfshirë edhe e vet këtë seancë.

Ajo ka nevojë për përkrahje institucionale, për integrim dhe më së paku ka nevojë për stigmatizim.

Sa i përket politikave publike, duhet t'i riorientojmë fondet tona publike. Nga asfalti në ndërtimin të shoqërisë në vlera pozitive universale. Duhet të shtojmë kujdesin familjar. Duhet ta luftojmë shantazhin. Kolegët a atyre që abuzojnë me pozitën e tyre, duhet ta kenë guximin intelektual e institucional që të reagojnë.

Duhet të investojmë në psikologë e pedagogë në shkolla të cilët e njohin punën e tyre. Duhet të investojmë në programe e fushata vetëdijesimi e parandalimi të dhunës. Qendrat për punë sociale dhe strehimoret duhet ta marrin vëmendjen e merituar në qeverisjen lokale.

E gjitha çfarë ka ndodhur paraqet një rast të rëndë të fyerjes të ndërgjegjes sonë kolektive.

Të nderuar deputetë,

Pjesa më e madhe e popullatës së Kosovës është nën moshën 18-vjeçare dhe ky fakt është një potencial i madh për Kosovën. Kjo e bën edhe më të rëndësishëm investimin tonë në rini.

Ne duhet të investojmë në fëmijët tanë, ata duhet të jenë në qendër të zhvillimit tonë. Zhvillimi i fëmijëve duhet të jetë një detyrim e projekt përtej vijave partiake. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Flora Brovina. Nuk është e pranishme. Deputeti Sami Kurteshi, urdhëroni!

SAMI KURTESHI: Faleminderit zonja kryesuese!

Të nderuara kolege e kolegë deputetë,

Ne sot po trajtojmë një rast që dalë dhe është bërë publik, që unë nuk do ta quaja Maja e Ajsbergut, por është njëra prej atyre majave që fatkeqësisht na dalin kohë pas kohe dhe na tregojnë anën e tyre tragjike dhe na e tregojnë të gjithë brishtësinë që e kemi si shtet si institucione, pse jo na i tregojnë edhe mangësitë tona që i kemi.

Ky rast po shihet që i ka prekur të gjithë pa marrë parasysh gjuajtjeve politike andej-politike, pra i ka prekur të gjithë. Unë mendoj se i ka prekur sinqerisht të gjithë pa marrë parasysh se cili qëndrimi politik.

Rasti është amoral në aspektin etik, ngase tregon apo shpërfaqë anën e shëmtuar të shoqërisë. Si do që t'i trajtojmë këta njerëz edhe ai që po i themi se është mësuesi, individi edhe ai që po themi polici edhe ai që po themi mjeku edhe ai prokurori janë pjesë të kësaj shoqërie.

Këta aktorë institucional dëshmojnë për një çështje që është e ndjeshme edhe e rëndon dhe e lëndon shoqërinë tonë.

Rasti është kriminal në aspektin ligjor, sepse përbën veprë të rëndë penale edhe atë në shumë aspekte. Përbën disa vepra penale; keqpërdorim i detyrës zyrtare, keqpërdorim i fëmijës së mitur, keqpërdorim i nxënëse, shantazh, kërcënim, forma të ndryshme të veprave të rënda penale që kanë mbetur një kohë relativisht të gjatë pa u trajtuar. Pa u zbuluar. Pa dalë në publik.

Kjo dalje, në të vërtetë është e rastësishme. Është e rastësishme, jo pse ka vetëm një rast, është e rastësishme në aspektin subjektiv sepse nuk i dimë të gjitha rastet. Ne e dimë se ka edhe shumë raste të tjera, ashtu siç dëgjuam edhe i shpërfaqën, mirëpo ky rast ka dalë rastësisht sepse ne nuk kemi qenë të informuar, por me gjasë dikush ka qenë i informuar.

Rasti është skandaloz në aspektin politik, sepse përbën një degradim të organizmit politik dhe institucional, që dëshmon për një sistem politik të papërgjegjshëm.

Tash, u fol shumë; a guxojmë t'i përgjithësojmë për mësuesit, për mjekët, për policët, për sistemin e drejtësisë? Jo, jo ne i kemi diku rreth 20 mijë mësimitdhënës edhe kjo duke ngjarë çdo ditë, por ne duhet ta pranojmë se kjo ngjanë shumë shpesh, jo 20 mijë mësimitdhënësit, por në mesin e 20 mijë mësimitdhënësve ka një numër relativisht të madh që keqpërdorin pozitën e tyre, dhe sistemi i krijuar i mbulon. Ky është problemi ynë. Por, jo të gjithë e bëjnë këtë.

Çështja e sistemit është që ata t'i mënjanojë. Ata t'i parandalojë dhe t'i pengojë. T'i heq nga sistemi në përgjithësi.

Unë e tash se në aspektin subjektiv kjo është një rastësi, sepse jo të gjithë prej nesh i dimë këto. Por, kjo është një domosdoshmëri objektive, sepse dështon sistemi, pra sistemi shtetëror apo nënsistemi që i kemi; arsimit, drejtësia, policia, shëndetësia etj.

Këto sisteme punojnë dhe veprojnë në atë mënyrë që lejojnë elementë të tillë që të jenë vazhdimisht aty dhe të mos zbulohen nga ne.

Kjo tregon se shoqëria jonë nuk ka mundur të arrijë të krijojë mekanizma përkatës të mjaftueshëm për parandalimin, për mbrojtjen, për rehabilitimin e këtyre viktimave të dhunës që zakonisht i prek shtresat më të dobëta. I prek gratë, fëmijët, pleqtë dhe i prekë ata që nuk kanë

mundësi që të mbrohen asnjë mënyrë. Dhe, fundi i fundit, roli i shtetit, detyra e shtetit që ta mbrojë të dobëtin nga i forti. Pikërisht këtu është duke dështuar kjo.

Ne po themi se është rastësi kjo që ka ndodhur me policin. Jo, unë po them nuk është rastësi kjo që ka ndodhur me këtë polic. Ne i kemi dhjetëra raste të tjera të cilat dëshmojnë se këtu ngjarje ndodhin vazhdimisht në Policinë e Kosovës.

Po, jo vetëm në Policinë e Kosovës, në shumicën e institucioneve. Pse? Sepse institucionet publike edhe tash e shohim edhe në këtë rast, edhe te policia edhe të shkolla edhe te prokuroria apo te mjeku, që nuk ka protokolle të veprimit.

Nëse do që ta hetojë dikush nuk ka me çfarë ta hetojë, sepse nuk ka dokumente të shkruara. Ngase nuk kanë shkruar, nuk kanë lënë gjurmë të shkuara ashtu siç i obligon ligji edhe normat e tjera ligjore. Prandaj, unë mendoj se kjo padrejtësi do të vazhdojë.

Ne mund të gjejmë drejtësi në thonjëza për këtë rast, mirëpo derisa po flasim për këtë rast edhe derisa nuk kemi ndërtuar mekanizma, e mekanizmi në një institucion shtetëror është protokoli i veprimit për çdo veprim që pjesëtari i institucionit të shtetit në raport me qytetarin. Atë nuk e kemi.

Prandaj, po them se drejtësia mund të jetë në thonjëza mund të vijë, por ajo do të jetë edhe e vonuar edhe jo e drejtë.

Unë po kthehem pak te Policia e Kosovës. Pa dashur që të preken të gjithë 9 mijë apo 10 mijë apo 8 mijë policë sa i kemi, megjithatë kjo që ka ngjarë në Policinë e Kosovës nuk është e rastësishme.

Ne kemi me qindra mos të them me mijëra raste të lajmëruar dhe të denoncuara në Policinë e Kosovës, madje edhe në Inspektoratin Policor të Kosovës. E mos të them se kemi raste personale që kurrë nuk janë hapur. Kurrë nuk janë dërguar, as nuk janë trajtuar dhe as nuk janë dërguar në prokurori.

A dini pse ngjanë kjo? Sepse në asnjë stacion policor të Kosovës, qofshin edhe këto qendrat e policisë në Prishtinë nuk ka menaxhment të kontrollit, të kualitetit, të komunikimit, të institucionit shtetëror që quhet Polici e Kosovës me qytetarë.

Polici i Kosovës që është kujdestar e ka shumë lehtë ta fshehë rastin, sepse një, rastet nuk regjistrohen, nuk ka mjete, në vendet e tjera janë mjetet deshi apo nuk deshi polici, ato regjistrohen dhe mbeten të regjistruara, e këtu te ne nuk ka, varet nga mëshira e policit a do ta regjistrojë një rast, si do ta regjistrojë edhe a s' do ta regjistrojë fare. Ky është problemi që ne nuk

kemi menaxhim të kontrollit në Policinë e Kosovës, të komunikimit të qytetarëve me Policinë e Kosovës.

Prandaj, nuk duhet habitur që ka ngjarë ky rast, mund të ngjajnë edhe shumë raste të tjera.

Përveç kësaj, duhet ta themi faktin se në Policinë e Kosovës është një kastë e njerëzve të kriminalizuar që është futur aty tani e disa vjet dhe policët e ndershëm të Kosovës sot janë shërbëtorë në Policinë e Kosovës, në të vërtetë në grada në Policinë e Kosovës sot ngrihen kriminelët, sepse ne e kemi pasur një drejtor të përgjithshëm të Policisë së Kosovës që ka kryer vepra kriminale, penale dhe në vend që të shkarkohet, të mbajë përgjegjësi, ai është graduar, sot e keni shef të AKI-së.

Nuk duhet të habitemi se ai ka mbjellë farën e krimit në Policinë e Kosovës. Unë nuk po dua t'i përmend rastet që u përmendën. Raste të tilla të krimeve, qoftë të bëra nga policët, të kryera nga policët, pjesëtarët e policisë, qoftë të fshehura, janë me qindra. Vetëm është rastësi se kur ato do të dalin në publik, në sipërfaqe, dhe kjo fatkeqësi është duke na përcjellë, sepse nuk ka guxim në këto institucione që të ndërmerren veprime konkrete kundër personave që kanë mbjellë farën e krimit në Policinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Dukagjin Gorani, urdhëroni!

DUKAGJIN GORANI: Faleminderit!

Kolegë të nderuar,

Sot, për fat të keq, unë nuk jam tepër shumë i befasuar me rastin që ka ndodhur, meqenëse rasti i përdhunimit në Drenas është njëri ndër qindra raste që i mbaj në mend që kanë ndodhur vetëm gjatë jetës sime dhe që gjithmonë kanë qenë pjesë e diskutimeve në sferë private dhe kurrë nuk janë bërë publike.

Ajo që në gjithë këtë tragjedi më ka befasua për të mirë është reagimi publik, është reagimi publik, i cili ka nisur së pari prej mediave, mandej është përhapur përgjatë shoqërisë këto dy ditë dhe sot ka mbërritur në Kuvend.

Mirëpo këtë reagim publik ishte dashur ta diskutojmë. Pse është ky reagim kaq i madh në publik dhe pse pikërisht sot? Unë shpresoj që kjo flet për një lloj të vetëdijes kulturore që është duke lindur në vendin tonë, mirëpo jo edhe aq lehtë.

Atë që e dëgjova sot është përpjekja për ta strukturuar fajësinë karshi rastit tragjik që ka ndodhur dhe strukturimi i fajësisë, së paku këtu në Kuvend, pa tjetër që e çon kritikën kah institucionet e pushtetit, kah mekanizmat shtetërorë.

Mirëpo, ajo që unë mendoj që nuk u diskutua deri sot, është që edhe ato institucione, edhe ata mekanizma shtetërorë, e sidomos njerëzit të cilët ato i përfaqësojnë, ata i takojnë një sfondi kulturor, ata janë të ndërtuar brenda një konteksti kulturor dhe shoqëror edhe atë kontekst kulturor dhe shoqëror, ata njerëz, përkundër uniformës ose përkundër mantelit të mjekut, atë kontekst kulturor ata e bartin edhe gjatë profesionit të vet.

Ajo që unë kam frikë që duhet të bëhet fjalë, e të cilën megjithatë duhet ta marrim edhe guximin të flasim, është mbi çfarë vlerash etike, mbi çfarë konceptesh morale qëndron shoqëria jonë dhe çka saktësisht nënkuptohet e rëndësishme që të diskutohet në sferën publike dhe çka assesi nuk guxon të dalë nga sfera private.

Ajo që ka ndodhur këto dy ditë e kaluara është diçka që është konsideruar me vite e me dekada të tëra pjesë e errët e sferës private në këtë shoqëri.

Rasti që ka ndodhur në Drenas shpresoj të jetë i fundit, po gjithsesi nuk është i pari dhe unë personalisht mbaj në mend raste të tilla që janë diskutuar ekskluzivisht si çështje të cilat nuk duhet të shndërrohen në pjesë të diskutimit publik.

Mënyra se si është zhvilluar sot ndarja e përgjegjësisë mes institucioneve publike dhe mekanizmave shtetërorë, mendoj se nuk zhvillon drejtësi në diskutim.

Meqenëse nuk mendoj që jemi duke marrë guximin të shikojmë shoqërinë patriarkale, vlera patriarkale mbi të cilat qëndron një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë sonë, nuk jemi duke dashur t'i shikojmë si një ndër burimet e keqkuptimit të shoqërisë sonë me standardet bashkëkohore, të cilat po përpiqemi t'i vendosim.

Standardet bashkëkohore të një transparence, standarde bashkëkohore të një respekti dhe barasvlefshmërie gjinore, standardet bashkëkohore të lirisë, gradualisht janë duke rënë ndesh. Unë kam frikë që paevitueshëm do të bien ndesh me fundamentet e shoqërisë patriarkale.

Meqenëse sipas standardeve bashkëkohore, të cilat ne po përpiqemi t'i imponojmë në vete dhe në shoqërinë tonë, sipas atyre standardeve shoqëria patriarkale konsiderohet organizata më e madhe kriminale në shoqëri. Sipas po atyre standardeve që po përpiqemi t'i imponojnë, ne duhet ta kemi të qartë që jemi duke shkuar drejt një përplasjeje, e cila do të jetë edhe e paevitueshme, po në të cilën roli ynë do të jetë kapaciteti i menaxhimit të asaj përplasjeje, se si të menaxhohet një mosmarrëveshje ose një konflikt në nisje i dy kulturave konkurrense, i kulturës për të cilën ne pohojmë të jetë bashkëkohore dhe në përshtatshmëri me parimet bashkëkohore të jetesës, me diçka që është kod patriarkal i sjelljes, ku shpeshherë definicioni i femrës nuk ka shkuar më larg se të qenit barrë për familje dhe të qenit një aksident biologjik.

Më shumë se reformat, më shumë se diskutimi për krijimin e mekanizmave shtetërorë, mendoj që këto ditë ka pasur sukses pikërisht eksponimi.

Mendoj që nëse vërtet e kemi sinqerisht përpjekjen për çrrënjosjen e botëkuptimeve të tilla, të cilat dërgojnë deri te përdhunimi i adoleshenteve, atëherë eksponimi publik është i vetmi mekanizëm, i cili aktualisht mund të ketë sukses. Sa më shumë të eksponohen, edhe kryerësit, mirëpo nëpërmjet eksponimit të kryerësve dhe të veprës duhet të eksponohet edhe një defekt i madh shoqëror, i cili ndoshta nuk është konsideruar defekt deri para disa vjetëve, mirëpo tash e tutje duhet ta kemi të qartë, nëse e konsiderojmë shoqërinë patriarkale të defektshme, nëse kodet patriarkale i konsiderojmë si frenues të një zhvillimi të lirshëm shoqëror, atëherë atë duhet ta themi, ta marrim guximin ta themi.

Ajo që nuk mund ta bëjmë është të flirtojmë me dy sisteme të vlerave: me sistemin bashkëkohor të barazisë dhe lirisë, mirëpo në të njëjtën kohë duke e mirëmbajtur dhe duke e kultivuar një koncept patriarkal atavist, me të cilin shpeshherë ne e ndërlihim edhe konceptin tonë identitar, e fatkeqësisht ndonjëherë edhe atë kombëtar.

Mendoj që eksponimi masiv edhe publik duhet të jetë një ndër përgjigjet e duhura dhe mendoj që po ashtu, duke qenë që nuk kemi të bëjmë këtu ekskluzivisht vetëm me shpërdorim të detyrës, mirëpo kemi të bëjmë edhe me një frymë shoqërore, viktimat e ngjarjeve dhe akteve të tilla duhet të kenë trajtim të ngjashëm sikur edhe dëshmitarët e mbrojtur. Strehimi i këtyre viktimave, ndërtimi i institucioneve të specializuara për strehimin e viktimave të rasteve të tilla është imanencë, është diçka e domosdoshme në një shoqëri, e cila ka vendosur të niset drejt një përplasjeje vlerore prej së cilës duhet të krijohet një kualitet i ri shoqëror, e i cili i ndërton konceptet e reja të barazisë, lirisë edhe trajtimit njerëzor të të gjithëve.

Krejt në fund, mendoj që është vështirë të diskutohet çështja e institucioneve shtetërore, duke e anashkaluar përkatësinë kulturore, vlerore, etike të njerëzve, grupeve sociale, të cilat e përfaqësojnë shtetin dhe e përfaqësojnë pushtetin. Kjo është me rëndësi, ashtu që ne të jemi në gjendje ta ndërtojmë një debat të shëndoshë dhe të jemi në gjendje ta adresojmë problemin sado i vështirë që është edhe brenda defekteve tona shoqërore. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Vjosa Osmani-Sadriu, pastaj edhe Flora Brovina nëse është e pranishme, s'ka të tjerë për diskutim.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit!

Unë do tentoj të flas shkurt, meqenëse shumica e çështjeve tashmë janë ngrehur në këtë debat disaorësh, i cili është thirrur për dy arsye themelore së paku, ashtu siç e kuptoj unë. E para, për të

folur për dështimin e institucioneve për ta mbrojtur në këtë rast një të mitur. Dhe, e dyta, që besoj është edhe po aq e rëndësishme, për ta luftuar mentalitetin e fajësimit të viktimës.

20 vjet pasluftës e pas lirisë së vendit tonë, ky rast dhe shumë të tilla sikur ky tregojnë se shteti ynë ka dështuar që t'i mbrojtë të drejtat individuale. Mirëpo, unë mendoj që mund ta kuptojmë se sa i rëndë është rasti në fjalë, vetëm në qoftë se secili prej nesh e paramendojmë që ka mundur t'i ndodhë çdokujt, pavarësisht pozitën që e ka në shoqëri, në institucione, pavarësisht në cilin qytet jeton, ka mundur t'i ndodhë fëmijës të secilit. E kjo për shkak se shumë zyrtarë para këtij polici, e para këtij mësuesi e kanë bërë të njëjtën, janë liruar, nganjëherë janë graduar, prandaj si rezultat sistemi që është ndërtuar e inkurajon dhunën dhe inkurajon abuzimet në vend se t'i luftonte ato. Sepse, sikur të mos ishte kështu ne nuk do të dëgjonim, shoqëria kosovare nuk do të mësonte për këtë rast vetëm pas gati dy vjetësh, kur një avokat, të cilin duhet të gjithë ta falënderojmë publikisht, vendosi që ta thyejë heshtjen dhe ta denoncojë, jo individët në këtë rast, por përtej individëve ta denoncojë një sistem të dështuar e të kalbur në vlera.

Pra, shkollat, në një anë, dhe sistemi i sigurisë dhe ai i drejtësisë, në anën tjetër, fatkeqësisht, në disa raste po shndërrohen në strehë, përdhunues e për pedofilë. Pra, në shtetin ku të gjithë po i rritim fëmijët tanë.

Megjithatë, edhe pse e kuptojmë shumë mirë që përgjegjësia është individuale, mbrojtja e tyre në këtë rast dihet shumë mirë, meqenëse janë fshehur për gati dy vjet, ka qenë institucionale. E kanë bërë këtë sepse e bënë edhe shumë para tyre dhe lëre pra që s'janë dënuar, por në disa raste edhe janë nderuar për "punën e tyre".

Pra, kjo që po e shohim nuk është rast i izoluar, tregon që në Kosovë po ndodhë skllavërimi, skllavërimi në kontekstin modern që e kuptojmë shumë mirë ndodhë edhe në shumë vende të tjera, por për ne është një hallkë ku nuk duhet të dështojmë, hallka ku mbrohet qytetari, e mbi të gjitha aty ku duhet të mbrohet një fëmijë e një i mitur, e që janë institucionet e sigurisë dhe pastaj ato të drejtësisë.

Meqenëse e kemi ministrin e Punëve të Brendshme dhe ministrin e Arsimit këtu, unë mendoj që pas këtij debati disaorësh është detyrë e tyre të dalin dhe të tregojnë, nën një: Në buxhetin që u miratua para disa ditësh, sa është buxheti që është ndarë për trajnim të vazhdueshëm të mësuesve, të policëve, që në punën e tyre të mos lejojnë pabarazi në trajtim. Sa investojnë ata në hetime të mirëfillta, qoftë në shkolla, qoftë në vendin e punës aty ku punojnë Policia dhe sa është investuar, ndoshta mund të flasim edhe në emër të kolegëve të tyre, në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që këto pabarazi, ku jeta e një burri dhe jeta e një gruaje nuk trajtohen njësoj të ndërpriten njëherë e përgjithmonë. Dhe, sidomos tash për rastin në fjalë, çka saktësisht është ndërmarrë? Kush në hallkën zinxhirore komanduese, përveç policit si individ, dhe mësuesit, deri tani ka dhënë përgjegjësi për këtë rast, i cili si duket është mbajtur fshehur për një kohë të gjatë.

Mirëpo, përtej kërkesave tona për funksionim si duhet të institucioneve, ne duhet sot ta ngremë zërin, në mënyrë që të turpërojmë publikisht secilin përdhunues, me emër e me mbiemër. T'i turpërojmë ata çdo ditë dhe jo vetëm sot në këtë Kuvend, por asnjëherë të mos e turpërojmë viktimën, por vetëm t'i mbrojmë ato, që ta turpërojmë secilin, e në veçanti secilën grua, ta turpërojmë secilën nënë, e cila thotë "hajt se ajo e ka lypë, hajt se ajo ka provokuar, hajt se ajo vetë i ka fajet", sepse e kemi për obligim t'i dalim në mbrojtje njëra-tjetrës.

Pra, për fund, përtej thirrjes për institucione që të ndërmerren masa konkrete, jo vetëm për hetimin e këtij rasti, por për investim në arsim të vazhdueshëm, për investim në një shkollim si duhet, ku mbrohet edhe dinjiteti, pra jo vetëm ku mësohen shkronjat e numrat, por edhe mbrohet dinjiteti i fëmijës, unë dua t'u bëj një thirrje përfundimtare prindërve, në veçanti t'u bëj thirrje nënave që t'u besojnë vajzave të tyre, që të mos i paragjykojnë, e të mos i lënë asnjëherë vetëm që ato të vetme të përballen me këto monstra të shoqërisë sonë, sepse asgjë nuk është më me rëndësi se fëmija yt, se fati i fëmijës tënd. As çka thotë shoqëria, as çka thonë fqinjët, madje as çka po flitet sot në këtë Kuvend. Mbrojini vajzat tuaja dhe në veçanti gjithnjë besojuni atyre, sepse asnjëherë të vetme nuk është viktimja që i ka fajet dhe gjithmonë është përdhunuesi që i ka fajet dhe që duhet ta marrë dënimin e merituar. Faleminderit!

KRYETARI: Fisnik Ismajli e ka kërkuar ndërkohë fjalën, në qoftë se ka deputetë ende tjerë.

FISNIK ISMAJLI: Faleminderit!

Tash tri ditë s'e kam thënë asnjë fjalë, mua që s'ma mban barku pa folur të paktën në rrjete sociale, u shtrëngova dhe s'di as vetë qysh u durova pa folur. Kësaj here desha veç ta përcjell euforinë e secilit, prej gazetarit te qytetari aktiv, te deputeti, institucionet, te besimtari, e deri te gjysmanalfabeti që bashkë ia futën flakën Facebook-it rrafsh tri ditë.

Secili pati diçka të thotë, dikush foli mençur, dikush e bëri krejt bërlllok, por pothuajse secili u mundua t'ia lë fajin dikujt tjetër, sepse ne si shoqëri e kemi krijuar një prirje që gjithmonë t'ia lëmë fajin dikujt, ose kur s'mund ta gjejmë fajtorin e vërtetë, arsyetohemi, fajtori është jetim. Kur do ta kuptoni, o ju kolegë këtu, e ju qytetarë që na keni votuar për t'ju përfaqësuar këtu, se rasti i vajzës së mitur është produkt i krejt kësaj shoqërie, që ne vetë e kemi krijuar, një shoqërie që e ka humbur çdo vlerë dhe e cila është zhveshur prej njerëzisë dhe secili prej nesh, pa pikë përjashtimi, kemi faj. Ne e fajësojmë Evropën që s'po na lë të shkelim në të, e s'e shikojmë një herë veten e të kuptojmë që bota e civilizuar me plot të drejtë s'do të na i shohë sytë.

Kjo vajzë është viktimë e një shoqërie të sëmurë, që e kemi krijuar të gjithë ne. Edhe derisa jemi duke folur ne këtu në Kuvend, e të tjerët janë duke i ndrydhur sustat nëpër tastiera, ku të dihet se sa viktimja të tjera janë duke kaluar nëpër tmerrin, prej të cilit vetëm një vajzë është dashur të dalë. E tmerri i saj posa ka filluar, sepse ajo përjetë do të paragjykohet e do të përbuzet po prej kësaj shoqërie.

Pushteti ka faj, të nderuar kolegë e qytetarë, e s'po flas për pushtetin institucional, por për pushtetin si dukuri: pushtetin e babës ndaj familjes, pushtetin e punëdhënësit ndaj punëtorit, pushtetin e mësuesit ndaj nxënësit, pushtetin e policit e politikanit ndaj qytetarit, pushtetin e doktorit ndaj pacientit. Kjo dëshirë e gërditshme për të pasur pushtet në çdo nivel të kësaj shoqërie është duke na vepruar, është duke na qorruar, njerëz.

Abuzimi i pushtetit është bërë normë shoqërore. Prej një roje më të thjeshtë, që mundohet të të tregojë sa i rëndësishëm është aty te rampa e deri te deputeti sot këtu, që po e abuzon pushtetin e vet duke e keqpërdorur këtë rast kaq të ndjeshëm për të përfituar politikisht. E kur abuzimi i pushtetit bëhet normë shoqërore, të cilit duhet nënshtruar gruaja me fëmijë, punëtori në punë, qytetari në rrugë, nxënësi në klasë e pacienti në spital, atëherë duhet të kuptojmë se kjo shoqëri, kolegë, “ka shkuar për lesh”. Asnjëri s'po di të japë zgjidhje të saktë se qysh të ndalet dukuria e poshtër, e cila u bë publike para tri ditësh, e për të cilën të gjithë këtu e dimë se është vetëm një prej shumë rasteve që janë duke ndodhur në këtë moment.

A po kujtoni se po ndryshoi Qeveria do të ndryshojë diçka!? Prej se di për vete, dëgjoj raste e raste të profesorëve që shkëmbejnë nota për favore personale, seksuale, më falni, duke abuzuar pushtetin e tyre. Prej se di për veten burrat i përgjakin gratë e fëmijët në shtëpi, duke e abuzuar pushtetin e tyre, prej se di për veten dëgjoj për shantazhe, ngacmime e përdhunime prej njerëzve që abuzojnë pushtetin e tyre, të cilat çdoherë janë heshtur, sepse për shoqërinë tonë të poshtër këto tema janë tabu, “s'bën me i fol, është marre...”.

Njëzet mijë gra na i kanë përdhunuar para 20 vjetësh, por shoqëria jonë s'flet se është “marre”. Në vend se krejt të ngremë zërin për ta ndalur këtë dukuri, ne i fajësojmë viktimat, i paragjykojmë, i etiketojmë, i legjitimojmë abuzuesit duke heshtur. E abuzuesi, kur e sheh që kurrkush s'po flet, vazhdon të keqpërdorë pushtetin, çdoherë e më shumë, derisa të plasë ndonjë skandal sikur ky, e na përfshinë neve euforia 3-4 ditë, jo më shumë. Mjafton ndonjë këngë e re e Dua Lipës, ndonjë medalje e Majlindës, dhe harrojmë çfarë ka ndodhur.

A po doni zgjidhje? Zgjidhja është me njerëzillëkun e secilit prej nesh, në kokat e secilit prej nesh, në zemrat e secilit prej neve. Burrëri nuk është më pushteti dhe abuzimi me të, burrëri janë veprat e secilit prej nesh për ta ndalur këtë dukuri. Faleminderit!

KRYETARI: Në fund deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet kolegë dhe kolege!

Ngre zërin e revoltës si mjeke e fëmijëve, si nënë dhe e shpreh indinjatën time të thellë për abuzimin e vajzës së mitur të abuzuar seksualisht nga ana e atyre që duhet të ishin prindër të dytë, e që duhet të përkujdeseshin për edukimin dhe të mbronin dinjitetin e saj.

Shpreh keqardhjen për shkak të shqetësimit gjithashtu, të opinionit të gjerë për këtë krim të bërë, e sidomos për fëmijët dhe të rinjtë, për prindërit, të cilët e ndiejnë thellësisht në shpirt këtë abuzim. Megjithatë dua të them edhe diçka, jam krenare për reagimin e opinionit dhe të shoqërisë në përgjithësi në Kosovë, e cila reagoi me kohë dhe ashtu sikur i pati hije. Më vjen mirë që u organizua kjo mbledhje e Kuvendit dhe pres që institucionet gjegjëse, ministritë gjegjëse, të cilave u takon, të reagojnë në mënyrë adekuate duke u distancuar nga kryerësit e krimin dhe krimeve të tjera, sepse dikush tha, dhe është e vërtetë, se nuk është i vetmi krim.

Veprime abuzuese nga ana e individëve njollosin institucionet tona dhe e humbin besueshmërinë në këto institucione, prandaj këta individë duhet dënuar, sepse nuk e kanë të drejtën që të abuzojnë, jo vetëm ndaj të miturës fatkeqe, ose cilitdo fëmijë, por nuk kanë të drejtë as t'i përdhosin këto institucione të ndërtruara me mund. Këto krime ndodhin edhe në shtetet demokratike, atje ku ka sundim të ligjit dhe demokracia është e zhvilluar. Jo të gjithë qytetarët e këtyre shteteve reagojnë si ne, nuk them me eufori, por me një ndjenjë të shtuar, për shkak se ne jemi të lënduar qysh më herët. Pra, e përmendi kolegu para meje, kur ndodhi abuzimi i grave dhe burrave e fëmijëve gjatë luftës, pra abuzimi seksual i tyre, dhe në këtë moment jemi duke u përpjekur që të dëshmojmë këto krime të luftës dhe tani na ndodhin krime të tilla nga njerëzit që do të duhej ta mbronin dhe të kujdeseshin për qytetarët.

Jemi të ndjeshëm si shoqëri edhe për shkak të sakrificës së madhe që bëme për ndërtimin e institucioneve dhe shtetit, andaj kemi të drejtë t'i gjykojmë ashpër këta individë dhe të kërkojmë që gjykata ta thotë fjalën. Sigurisht se jemi edhe më shumë të ndjeshëm për shkak të fëmijëve, rritës dhe edukimit të tyre, zhvillimit të tyre, sepse për ta sakrifikuam në rend të parë.

E keqja e turpshme ndodhi. Tani pajtohem me të gjithë ata që thanë se jo vetëm zëri ynë do të jetë në përkrahje të çdonjërit viktimë, por dhe adresë e besim që viktimat të na drejtohen dhe ne të jemi të zëshëm në mbrojtjen e të drejtave të tyre kundër diskriminimit, në veçanti kundër abuzimeve të grave, vajzave dhe fëmijëve pa dallim, vajza dhe djem. Ata kanë nevojë për zërin tonë më të fuqishëm, kanë nevojë për mbrojtjen tonë institucionale.

Jam menduar gjatë dhe dua t'i përmend të gjithë me rend institucionet të cilat janë përgjegjëse për këtë shfaqje të këtij krimi. Në rend të parë do të përmend institucionin themelor, e që është familja. Ne kemi qenë gjithnjë në histori krenarë për këtë institucion, i cili ka bartur peshën kryesore të shoqërisë, kur nuk kemi pasur institucione të tjera shtetërore dhe për këtë respekt. Mirëpo, institucioni i familjes as në bazë të Ligjit mbi familjen që e kemi nuk është duke kryer detyrën e vet. Shpeshherë prindërit po harrojnë përgjegjësinë e tyre ndaj fëmijëve dhe relacionin që duhet ta ndërtojnë prind-shkollë-rrugë.

E dyta, institucioni shkollë ka për detyrë edukimin, mësimin, përcjelljen e plan-programeve, e këtu hyn edhe edukata seksuale. Prandaj, kujtoj se këtu diçka ka dështuar. Pajtohem me të gjithë

ata, sepse sigurisht u fol sot shumë gjatë tërë ditës, pajtohem me ata që mendojnë, kemi diskutuar edhe në Kuvend edhe herëve të tjera, se është e nevojshme që shkollat tona, sidomos kur kanë numër të madh të nxënësve të kenë mjekun e shkollës që ka specializim Mjekësinë shkollore, e këtu mësohet, edhe edukimi shkollor, edhe edukimi seksual, psikologun dhe pedagogun. Kjo po shihet më se e nevojshme.

Do të flas gjithashtu për etikën mjekësore. Disa ligje janë shkelur kur flasim për etikën dhe Betimin e Hipokratit, sepse dihet që ekziston Ligji për abortin dhe raportimi i rasteve që abortojnë në institucionet private e që nuk po ndodh. Të tjerët folën për këtë çështje dhe unë u bashkohem.

Policia jonë deri dje me fjalët më të bukura për të, por e cila në kohë të fundit ka vërejtje dhe të cilat duhet t'i përmirësojë, në rend të parë disiplina në polici, besimi në polici, etika e policëve dhe marrja e dënimeve atëherë kur ata gabojnë. Pa këtë polici që e kemi dëshiruar dhe jemi përpjekur që ta kemi ashtu si e dëshirojmë, vështirë se do të ecet përpara. Pra, insistoj që t'i kthehet besimi.

Gjyqësori-është diskutuar për abuzimet ndaj grave dhe ka raporte Kuvendi ku është konstatuar se me gjithë karrigen e mbrojtjes së gruas gjyqësori ka qenë më i dobëti, i cili jo rrallëherë nuk ka qenë në anën e të së drejtës, pra të gruas, por ka anuar kah i forti, kah ai që ka më shumë mundësi materiale, e tjera, e tjera. Këtu duhet një debat edhe në kuadër të Grupit të Grave, pse jo edhe të grupeve të tjera që merren me të drejtën e njeriut, komisioneve dhe të bisedojmë në lidhje me gjyqësorin, aq sa na takon.

Politizimi i çështjes nga çështja individuale dhe tërë përcjellja e kësaj në institucione nuk është e drejtë dhe nuk na bën nder, sepse ne kemi ndërtuar institucione që janë të barasvlershme me institucionet e tilla në të gjitha vendet e tjera, madje për institucionet tona, disa nga to, kemi edhe fjalë dhe parametra shumë pozitivë. Kritika me vend dhe kritikën e shumta gjithsesi duhet të ndodhin e të shprehim edhe në konkluzionet që do t'i nxjerrë Kuvendi, megjithatë persona të tillë, ne si persona publikë, duhet ta dimë se fjala jonë ka peshë dhe jo vetëm kaq. Qofshin ato sjellje jo të mira dhe abuzive, ne duhet t'i akuzojmë ato, por me emra konkretë. Për shembull, në qoftë se është fjala për mjekun, mësuesin dhe gjykatat, por jo edhe institucionin e shkollës, e cila ka sakrifikuar gjatë tërë kësaj kohe mjaft, jo edhe për mjekësinë në përgjithësi, jo edhe për gjyqësorin në përgjithësi. Të jemi pak më konkret, që të jemi më efikas.

Megjithatë, duhet të përqendrohemi më shumë në zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve. Kritika e institucioneve tona duhet të jetë e ashpër, e fortë dhe me shumë argumente. Besoj se kemi institucione të besueshme dhe të tilla t'i mbajmë, sepse na duhen dhe duhet ta ndajmë çështjen... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Regjia, ju kisha lutur, mbasi janë edhe dy fjalë janë. A ka edhe dikush tjetër për të diskutuar?

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Pse insistoj në institucionet? Sepse dihet se çfarë kemi thënë për Policinë dhe kam frikë, e di përqindjen e lartë të grave që janë police. Kam frikë se në rekrutimet e ardhshme njerëzit do të hezitojnë. E di sa luftë është bërë për shkollimin e vajzave.

Prej derës në derë në vitet e kaluara, domethënë në dekadat e kaluara kemi insistuar që vajzat të shkojnë në shkollë dhe të punësohen dhe çdo fushatë mund të na çojë në regres. Por, natyrisht se duhet ta mbrojmë individin në këtë rast, vajzat dhe gratë e abuzuara.

Në përfundim më lejoni që them; liria dhe anarkia janë shumë afër njëra-tjetrës. Liria pa rregulla, pa sjellje, pa obligime shoqërore mund të kthehet shumë lehtë në anarki. Mos ta lejojmë këtë dhe të fillojmë nga tash, sepse edhe tani është vonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani jemi në pjesën e përfundimit. Ftoj propozuesit, Lirije Kajtazi dëshiron diçka të shtojë. Pastaj zonja Kollçaku nëse ka mundësi të na e japësh idenë rreth kësaj teme për seancë.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Për fund si bashkë-iniciues të kësaj seance duam ta falënderojmë secilin deputet me kontributet e tyre që kanë ndihmuar sadopak që përpos kërkesës për ndëshkim të këtij rasti, të ndikojnë në vetëdijesim që rastet e tilla të mos përsëriten.

Natyrisht se, secili ka ofruar edhe ndoshta çështje të cilat ne së bashku do t'i përmbledhim në një tekst të veçantë i cili do të nxirret nga përfaqësues të secilit grup, në mënyrë që të jemi unik apo të unifikohet e gjitha ajo që doli nga kjo seancë.

Prandaj, ne propozojmë që krejt këto që ishin si kërkesa për renovim apo të riorientim ta themi të fondeve publike, ndoshta edhe atë të renovimit të krejt sistemit në shumë çështje të cilat u pa se kanë dështuar. Kërkesë që Këshilli Prokurorial, Këshilli Gjyqësor, Inspektorati Policor, institucionet e ndryshme arsimore t'i marrin më seriozisht të gjitha detyrat në kërkim të llogarisë dhe të kryerjes së detyrave të veta të cilat u ngarkohen. Për krejt këto, besoj që përfaqësuesit e grupeve është mirë tani t'i japim emrat të ulen edhe në një seancë tjetër për shkak të një numri të pamjaftueshëm të pranisë së deputetëve këtu, ta ofrojnë tekstin e harmonizuar dhe t'ia ofrojnë seancës për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani fjalën përfundimtare për seancën e ka zonja Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Ne po ashtu jemi në pajtim me atë çfarë tha zonja Lirie.

Kemi përcjellë me vëmendje prononcimet e deputetëve dhe mendojmë që ka pasur rekomandime me vlerë që duhet të përfshihen në rekomandimet përfundimtare.

Në veçanti kërkojmë që këto rekomandime të jenë në harmonizim me konventën që mbron fëmijët kundër abuzimit dhe keqpërdorimit seksual.

Prandaj, edhe ne mendojmë që secili grup parlamentar duhet sot ta propozojë nga një emër për grupin punues, i cili do të merret me hartimin e rekomandimeve përfundimtare të cilat pastaj do t'i sjellim në seancë për miratim.

Mirëpo, ajo çfarë duhet thënë në fund; që nuk mjafton, vërtetë të jemi shumë seriozë. Ne kemi bërë edhe më herët shumë rekomandime dhe rezoluta, siç e ceka në fillim, por kësaj radhe kërkohet që të zotohemi që ato për të cilat ne prononcohemi në fund, për të gjitha rekomandimet që së bashku po i votojmë dhe po i miratojmë këtu edhe t'i zbatojmë, sepse nëse mbesin si shumë prej tyre vetëm fjalë në letër, atëherë me të vërtetë edhe këto seanca e humbin kuptimin.

KRYETARI: A ka mundësi që grupet parlamentare ta japin nga një emër, apo dëshironi në mënyrë vullnetare që pas përfundimit të seancës të bëheni bashkërisht dhe formuloni tekstin të cilin dëshirojnë me propozime dhe pastaj të shkojmë më tutje. Zonja Kollçaku, prapë fjala për ju.

FATMIRE KOLLÇAKU: Kështu, do të ishte mirë që secili grup ta propozojë sot, sepse çdo shtyrje... Pastaj ne nuk mund ta thërrasim një seancë vetëm për këtë çështje. Sot të propozohen emrat dhe pastaj ky grup e vazhdon punën.

Në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje do të jem unë në këtë grup.

KRYETARI: Elmi Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i PDK-së e propozon deputeten Xhevahire Izmaçu.

KRYETARI: Bilall Sherifi, urdhëroni!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Ne e propozojmë deputeten Albulena Balaj-Halimaj.

KRYETARI: Dardan Sejdiu, urdhëroni!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate do të jetë Driton Çausi.

KRYETARI: Urdhëroni, Ahmet Isufi!

AHMET ISUFI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së do të jetë Shkumbin Demalijaj.

KRYETARI: Armend Zemaj, urdhëroni! Kam shkuar në bazë të radhitjes, siç më janë lajmëruar. Kush dëshiron mund, s'prish punë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e propozojmë zonjën Lirije Kajtazi.

KRYETARI: Grupi 6+, Albert Kinolli.

ALEBRT KINOLLI: Faleminderit i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar 6+ e propozon zonjën Duda Balje.

KRYETARI: Ka kërkesë nga seanca edhe pa grup parlamentar që ta propozojnë një anëtar. Zonja Mimosë, fjala për ju.

MIMOZA KUSARI-LILA: Kryetar!

Kam qenë edhe në listë të iniciuesve të kësaj seance, prandaj jo bash krejt pa grup parlamentar, por në emër të Alternativës, Mimoza Kusari-Lila.

KRYETARI: Kërkoj falje nganjëherë, por unë jam i obliguar vetëm në bazë të Rregullores. Kjo çka shkruan, ju pastaj deklarohuni siç dëshironi.

Atëherë, ky është grupi i cili do të na japë propozimet në seancën e radhës.

Ju falënderoj për kontributin. Dashtë Zoti që të mos ndodhin gjëra të tilla kurrë. Të paktën për 48 orë e shohim çfarë efekti në qoftë se lajmërohet edhe ndonjë rast, që mund të jenë inkurajuar nga ju.

I inkurajoj që të lajmërojnë, sepse ka edhe raste të tjera. Mund të ketë. Faleminderit për kontributin!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*